



njëzet e tetë) lekë në muaj.

9. Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të jetë 7 262 (shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

10. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 1 545 000 000 (një miliard e pesëqind e dyzet e pesë milionë) lekë dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018, i cili ndahet:

a) 1 532 000 000 (një miliard e pesëqind e tridhjetë e dy milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a.

11. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit teknik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 350, datë 12.6.2018

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME
NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN,
ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË
SHQIPËRI, BLOKU 4, NDËRMJET
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË, PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE
NATYRORE (AKBN) DHE *SHELL
UPSTREAM ALBANIA B.V.***

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 4, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe *Shell Upstream Albania B.V.*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



KONTRATË ME NDARJE PRODHIMI

Për
**KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË SHQIPËRI**

Bloku "4"

ndërmjet

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË E SHQIPËRISË**

(E përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/AKBN)

dhe

Shell Upstream Albania B.V.

Tiranë, më _____, _____, 2018

**KONTRATË ME NDARJE PRODHIMI****PËR****KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË SHQIPËRI
BLLOKU 4**

ndërmjet

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË E SHQIPËRISË
(E përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)**

dhe

Shell Upstream Albania B.V.

Kjo Kontratë nënshkruhet sot më Datë _____ 2018, nga **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë** (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, këtu e në vijim referuar si “AKBN”), në përputhje me Ligjin nr. 7746, Datë 28.07.1993, “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, e përfaqësuar nga _____, si njëra Palë dhe **Shell Upstream Albania B.V.**, një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Holandës (këtu e në vijim referuar si “Shell”), e përfaqësuar nga _____ si Pala tjetër (këtu e në vijim referuar si “KONTRAKTORI”).

HYRJE NË DËSHMI TË PALËVE KËTU:

NDËRSA, të gjitha burimet natyrore, duke përfshirë mineralet dhe Hidrokarburet që gjenden në Republikën e Shqipërisë janë pronë e Shqipërisë;

NDËRSA, Operacionet Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë rregullohen nga Ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe, nëse nuk përmenden diku tjetër në këtë Kontratë, kryesisht nga ligjet dhe rregulloret si më poshtë: Ligji Nr. 7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 7853, Datë 29.07.1994 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”; dhe i ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 8297, Datë 04.03.1998 “Për një ndryshim në Ligjin Nr.



7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, dhe i ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 10137, Datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar më tej me Aktin Normativ nr. 2, Datë 16.06.2010 “Për një shtesë në Ligjin nr.7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”; dhe i ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 31/2012, Datë 21.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”; dhe i ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 19/2015, Datë 12.03.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7746, Datë 28.07.1993 “Ligji për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)” (bashkërisht “**Ligji për Hidrokarburet**””, dhe

NDËRSA, AKBN është e autorizuar nga Qeveria Shqiptare për të negociuar dhe lidhur Kontrata me Ndarje Prodhimi dhe për të ndjekur zbatimin e planeve të Kërkimit, Zhvillimit dhe Prodhimit.

NDËRSA, Shell Upstream Albania B.V. ka paraqitur një aplikim për Bllokun 4 në tokë në Shqipëri, më Datë 24 maj 2015 dhe i është dhënë e drejta për të negociuar një Kontratë me Ndarje Prodhimi për Bllokun 4 në tokë në Shqipëri, më Datë 4 gusht 2015;

NDËRSA, KONTRAKTORI dëshiron të ndërmarrë të gjitha Operacionet për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në dhe përmes Zonës së Kontratës, të përshkruar në Anekset "A" dhe "B" të kësaj Kontrate, si dhe të përmbushë detyrimet dhe të gëzojë të drejtat e parashikuara në këtë Kontratë, si kontraktor i AKBN-së, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate; dhe

NDËRSA, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka autorizuar AKBN-në për të lidhur këtë Kontratë me KONTRAKTORIN për kryerjen e të gjitha Operacioneve Hidrokarbure të përshkruara në këtë Kontratë.

BAZUAR NË SA MË SIPËR, Palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1 PËRKUFIZIME

- 1.1. “**Procedurë Kontabël**” është procedura e përcaktuar në Aneksin C të kësaj Kontrate, e cila është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Kontrate.
- 1.2. “**Baza e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara**” do të thotë ajo bazë e kontabilitetit nën të cilën kostot dhe të ardhurat konsiderohen si të lidhura me Periudhën në të cilën detyrimi për koston ka ndodhur apo e drejta për të ardhurën ka lindur, pavarësisht se kur është faturuar, paguar apo marrë.
- 1.3. “**Filial i Kompanisë**” është një kompani në varësi, kompani mëmë ose kompani motër e një Pale ose një subjekt që është pjesë e Palës.
Për qëllime të përkufizimit më sipër:
 - 1.3.1. Një kompani në varësi është një kompani e kontrolluar nga një Palë ose nga një subjekt që është pjesë e Palës;
 - 1.3.2. Një kompani mëmë është një kompani që kontrollon një Palë ose një subjekt që është pjesë e Palës;



- 1.3.3. Një kompani motër është një kompani që kontrollohet nga e njëjta kompani që kontrollon Palën ose subjektin që është pjesë e Palës;
për këtë qëllim **“Kontroll”** është zotërimi drejtpërdrejtë ose tërthorazi i pesëdhjetë (50) për qind ose më shumë të të drejtave të votës, që i bashkëngjiten kapitalit aksionar të emtuar (apo ekuivalentit të tij) në një person juridik.
- 1.4. **“Shqipëri”** është Republika e Shqipërisë.
- 1.5. **“Qeveria Shqiptare”** është Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë çdo organ legjislativ, ministri, departament, agjenci, nënndarje politike ose instrumente të tyre, si dhe çdo autoritet tjetër Qeveritar i Shqipërisë.
- 1.6. **“Anekse”** janë të gjitha anekset e kësaj Kontrate.
- 1.7. **“Vlerësim”** janë të gjitha punimet e kryera nga KONTRAKTORI dhe të gjykuara si të nevojshme prej tij në rastin e Zbulimit, për të përcaktuar nëse ky Zbulim është Tregtar dhe/ose për të përcaktuar parametrat e një Zbulimi të mundshëm Tregtar.
- 1.8. **“Periudhë Vlerësimi”** është Periudha që KONTRAKTORI e gjykon si të nevojshme për të përcaktuar nëse Zbulimi është Tregtar dhe pas një Zbulimi Tregtar, kjo Periudhë fillon kur KONTRAKTORI dërgon njoftimin e Zbulimit dhe do të vazhdojë deri në momentin kur fillon Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit. Për përcaktimin e Periudhës së Vlerësimit merren parasysh kushtet specifike të Zbulimit dhe Praktikave e mira Ndërkombëtare në Industrinë e Hidrokarbureve.
- 1.9. **“Program Vlerësimi”** është Programi i paraqitur nga KONTRAKTORI, në përputhje me Nenin 6.3, sipas të cilit KONTRAKTORI do të vlerësojë dhe paraqesë një apo më shumë Zbulim(e).
- 1.10. **“Pus Vlerësimi”** është çdo Pus, qëllimi i të cilit në kohën e fillimit të Shpimit është përcaktimi i shtrirjes ose volumit të rezervave të Hidrokarbureve që ndodhen në një Zbulim.
- 1.11. **“Kosto të Miratuara”** janë Kostot e përcaktuara në përputhje me Paragrafin 3 të Nenit I të Procedurës Kontabël.
- 1.12. **“Hidrokarbure të Disponueshme”** është sasia e Prodhimit Ditor të Hidrokarbureve (minus ndonjë sasi të humbur, të përdorur në Operacione, të djegur ose të riinjektuar) të prodhuara, të ruajtura dhe të matura nga Zona e Kontratës, në Pikën e Matjes. Hidrokarburet e Disponueshme mund të jenë Naftë Bruto e disponueshme dhe/ose Gaz i Disponueshëm, sipas rastit.
- 1.13. **“Prodhim Mesatar Ditor”** është Prodhimi mesatar i Hidrokarbureve të Disponueshme për çdo Ditë gjatë Muajit Kalendarik, e cila llogaritet duke pjesëtuar sasinë e përgjithshme të Hidrokarbureve të Disponueshme, të matura nga Zona e Kontratës në Pikën e Matjes, gjatë atij Muaji Kalendarik, me numrin e Ditëve në atë Muaj Kalendarik. Për Muajin Kalendarik në të cilin ndodhet Data e Prodhimit Fillestar Tregtar, Hidrokarburet e Disponueshme do të pjesëtohen me numrin e Ditëve të atij Muaji Kalendarik, në vijim dhe duke përfshirë Datën e Prodhimit Fillestar Tregtar.



- 1.14. “**Fuçi**” është dyzet e dy (42) gallonë amerikanë (të barasvlershëm me afërsisht 158,984 litra), masë lëngu, e korrektuar në temperaturë gjashtëdhjetë (60) gradë Fahrenheit, me presion në nivelin e detit prej 1.01325 bar.
- 1.15. “**BOE**” janë Fuçi Naftë Bruto Ekuivalent.
- 1.16. “**BOPD**” janë Fuçi Naftë Bruto në Ditë.
- 1.17. “**BPD**” janë Fuçi në Ditë dhe përfshijnë BOPD dhe BOE.
- 1.18. “**BTU**” është një mijë e pesëdhjetë e pesë presje pesëdhjetë e gjashtë (1,055.056) Joule.
- 1.19. “**Buxhet**” është një Vlerësim i Kostove të nevojshme për të kryer Operacionet Hidrokarbure, në vijim të një Programi Pune të miratuar.
- 1.20. “**Muaj Kalendarik**” është secili prej dymbëdhjetë (12) muajve të Vitit Kalendarik.
- 1.21. “**Tremujor Kalendarik**” ose “**Tremujor**” është Periudha prej tre (3) Muajsh të njëpasnjëshëm, që fillon në Datën 1 të muajit janar, prill, korrik ose tetor të çdo Viti Kalendarik.
- 1.22. “**Vit Kalendarik**” është Periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh Kalendarik të njëpasnjëshëm sipas Kalendarit Gregorian, që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor, përfshirë të dyja këto Data.
- 1.23. “**Kontabiliteti mbi bazë monetare**” do të thotë ajo bazë e kontabilitetit sipas të cilës në një periudhë përfshihen vetëm zërat e kostove të cilat janë paguar dhe kanë ndodhur faktikisht dhe të ardhurat që janë arkëtuar faktikisht në atë periudhë.”
- 1.24. “**Zbulim Tregtar**” është Zbulimi i një grumbullimi Hidrokarburesh, që sipas gjykimit të KONTRAKTORIT, mund të shfrytëzohet për përfitime ekonomike, në përputhje me këtë Kontratë.
- 1.25. “**Kontratë**” është kjo Kontratë, duke përfshirë Anekset e saj me ndryshimet e herëpashershme të miratuara bashkërisht nga Palët.
- 1.26. “**Zonë Kontrate**” është, në Datën e Hyrjes në Fuqi, zona e përshkruar në Aneksin A dhe e paraqitur në hartën që gjendet bashkëngjitur si Aneksi B i kësaj Kontrate, e cila mund të ndryshohet nëse KONTRAKTORI heq dorë, sipas kësaj Kontrate.
- 1.27. “**Vit Kontraktual**” është Periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh të njëpasnjëshëm, që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi.
- 1.28. “**KONTRAKTOR**” është Shell ose pasardhësi(t) i(e) tij dhe përfituesit e ndonjë Interesi Pjesëmarrjeje, sipas Nenit 19.
- 1.29. “**Hidrokarbure për Mbulimin e Kostos**” është pjesa e Hidrokarbureve të Disponueshme, e përcaktuar në përputhje me Nenin 7.1 të kësaj Kontrate.



- 1.30. **“Naftë Bruto”** është çdo Hidrokarbur i prodhuar nga Zona e Kontratës dhe që, në grykën e Pusit ose në separator, është në gjendje të lëngshme duke përfshirë, por pa u kufizuar, naftën bruto, lëngjet natyrale të gazit dhe kondensatet që janë të stabilizuara ose janë kthyer dhe trajtuar në mënyra të tjera për t'i bërë ato të përshtatshme për transportim.
- 1.31. **“Detyrime Doganore”**, sipas përdorimit në këtë Kontratë, përfshijnë të gjitha taksat, detyrimet, tatimet, tarifat, të drejtat ose çdo detyrim tjetër financiar, që mund të ngarkohen si rezultat i importit ose i eksportit të zërave të përmendur në Nenin 12 të kësaj Kontrate.
- 1.32. **“Datë e Zbulimit Tregtar”** është Data në të cilën KONTRAKTORI njofton me shkrim AKBN-në për një Zbulim Tregtar, në përputhje me Nenin 6.6 të kësaj Kontrate.
- 1.33. **“Datë e Prodhimit Fillestar Tregtar”** është Data në të cilën bëhet dërgesa e parë e rregullt e Hidrokarbureve nga një Zbulim Tregtar në një Pikë Matjeje, në përputhje me një Plan Zhvillimi, dhe nuk përfshin dërgesën e Prodhimit të Testimit ose të Testimit të Zgjatur.
- 1.34. **“Ditë”** ose **“ditë”** është Periudha prej njëzet e katër (24) orësh, që fillon në orën 00:00 dhe përfundon në orën 24:00 (njëzet e katër), me orën shqiptare.
- 1.35. **“Pikë Lëvrimi”** është çdo pikë, brenda Republikës së Shqipërisë, siç mund të bihet dakord mes Palëve, ku secila Palë merr pjesën e saj përkatëse të Hidrokarbureve për Mbulimin e Kostove dhe të Hidrokarbureve Fitim. Pika e Lëvrimin mund të jetë e njëjtë ose jo me Pikën e Matjes.
- 1.36. **“Zhvillim”** është dhe përfshin, por pa u kufizuar, të gjitha Operacionet dhe aktivitetet në përputhje me Planin e Zhvillimit, Programet e Punës dhe Buxhetet e miratuara sipas kësaj Kontrate, në lidhje me:
- 1.36.1. Shpimin, tamponimin, devijimin, thellimin dhe kompletimin e pajisjen e Pusit për qëllimin e Prodhimit dhe ndryshimin e statusit të një Pusi të tillë; dhe
- 1.36.2. Projektimin, ndërtimin, instalimin dhe operimin (brenda ose jashtë Zonës së Kontratës) të pajisjeve; platformave; tubacioneve; sistemeve të ujit, elektrike dhe sistemeve të tjera; pajisjeve (duke përfshirë pajisjet portuale të magazinimit dhe ngarkimit); impiantet sipas nevojës së Prodhimit nga Pusi për marrjen, ruajtjen, trajtimin, stokimin, djegien, transportimin dhe lëvrimin e Hidrokarbureve për eksport dhe për tregun vendas; dhe për të kryer injektimin ose riinjektimin dhe projektet e tjera dytësore të naftënxjerrjes. Përdorimi i termit “Zhvillim” në këtë Kontratë përfshin edhe Prodhimin, sipas përkufizimit në këtë Kontratë, kur e kërkon konteksti dhe rethanat. Folja “Zhvilloj” nënkupton kryerjen e Zhvillimit.
- 1.37. **“Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi”** është zona e përcaktuar nga KONTRAKTORI, në përputhje me Nenin 1.32, në çdo kohë përpara përfundimit të Periudhës së Kërkimit, për të cilën KONTRAKTORI njofton AKBN-në se ka bërë një Zbulim Tregtar dhe e shoqëron njoftimin për AKBN me hartën që përshkruan zonën ku përfshihet e gjitha



apo një pjesë e Zonës së Zbulimit. Një Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi mund të përfshijë më shumë se një zonë, jo kufitare me njëra-tjetrën.

- 1.38. **“Periudhë Zhvillimi dhe Prodhimi”** ka kuptimin që i jepet në Nenin 6.24 të Kontratës.
- 1.39. **“Shpenzime Zhvillimi”** janë të gjitha kostot dhe shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për Zhvillimin dhe Prodhimin, me përjashtim të Shpenzimeve Operative dhe Shpenzimeve të Kërkimit.
- 1.40. **“Plan Zhvillimi”** është plani i përgatitur në përputhje me Nenin 6.11 të Kontratës.
- 1.41. **“Zbulim”** është Zbulimi i grumbullimeve të Hidrokarbureve, që dalin gjatë Shpimit në një strukturë gjeologjike, e cila, pas Testimit në përputhje me praktikat e njohura dhe të pranura të industrisë ndërkombëtare të Hidrokarbureve, gjykohet nga KONTRAKTORI se është në gjendje të prodhojë Hidrokarbure.
- 1.42. **“Zonë Zbulimi”** është një ose disa zona që KONTRAKTORI mund t’i përcaktojë në çdo kohë përpara përfundimit të Periudhës së Kërkimit, duke i dhënë njoftim me shkrim AKBN-së për këtë Zbulim dhe duke e shoqëruar njoftimin me hartën që tregon vendosjen e kufijve të çdo pjese të Zonës së Kontratës, ku KONTRAKTORI beson se përfshihet Zbulimi. KONTRAKTORI mund ta ndryshojë herë pas here këtë Zonë Zbulimi, pas Zbulimeve të mëtejshme. Pasi përcaktohet në përputhje me Nenin 6, një Zonë Zbulimi do të shtrihet në të gjitha thellësitë brenda kufijve të saj anësorë.
- 1.43. **“Dollarë”, “USD”, “Dollarë Amerikanë”** ose simboli “\$” janë dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- 1.44. **“Datë e Hyrjes në Fuqi”** në këtë Kontratë, do të thotë periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh Kalendarik pas datës në të cilën hyn në Fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që miraton këtë Kontratë.
- 1.45. **“Ekspert”** është një individ, i cili nuk është rezident ose shtetas i Shqipërisë dhe as nuk është i Punësuar i KONTRAKTORIT ose AKBN-së, i cili me anë të trajnimeve dhe eksperiencës së gjerë ka zhvilluar njohuri të thella në fushën teknike në të cilën shtrihet konflikti ose mosmarrëveshja, të cilën ky individ duhet të zgjidhë dhe i cili është emëruar në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.
- 1.46. **“Kërkim”** janë Operacione Hidrokarbure, të cilat kryhen sipas kësaj Kontrate gjatë Periudhës së Kërkimit për ose në lidhje me Kërkimin për Hidrokarbure (brenda ose jashtë Zonës së Kontratës), duke përfshirë, por pa u kufizuar, vrojtime dhe studime gjeologjike, gjeofizike dhe të tjera, shqyrtimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave, Shpimin e Puseve të Kërkimit, planet shoqëruese, operacionet e projektimit, administrative, inxhinierike, të ndërtimit dhe mirëmbajtjes dhe të gjitha operacionet dhe aktivitetet e tjera të lidhura me to, Programi i Vlerësimit që kryhet sipas kësaj Kontrate gjatë Periudhës së Vlerësimit dhe veprimtaritë e përmendura në Aneksin C ose të përcaktuara në ndonjë mënyrë tjetër në dispozitat e kësaj Kontrate.
- 1.47. **“Komiteti Këshillimor i Kërkimit”** është Komiteti Këshillimor i Kërkimit i përkufizuar në Nenin 4.6 të kësaj Kontrate.



- 1.48. **“Shpenzime Kërkimi”** janë të gjitha kostot dhe shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të kërkimit, të kryera përpara ose pas Datës së Hyrjes në Fuqi.
- 1.49. **“Periudhë Kërkimi”** është Periudha e Parë e Kërkimit, Periudha e Dytë e Kërkimit dhe Periudha e Tretë e Kërkimit, të përcaktuara përkatësisht në Nenet 4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3.
- 1.50. **“Pus Kërkimi”** është ose Pus Strukturor ose Pus Vlerësimi i shpuar të paktën deri në thellësinë Minimale dhe/ose në plotësimin e Detyrimit Financiar Minimal të specifikuar në Programin e Punës.
- 1.51. **“Prodhim i Testimit të Zgjatur”** është Periudha e Vlerësimit të Zgjatur, që përfshin Testime të zgjatura të Pusit ose sisteme të Prodhimit pilot të rezervuarit, për të mundësuar mbledhjen e mëtejshme të të dhënave thelbësore mbi rendimentin e rezervuarit, të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar për kryerjen e investimit, i cili përcaktohet në Planin Përfundimtar të Miratuar të Zhvillimit.
- 1.52. **“Vit Fiskal”** është Viti fiskal që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor, përfshirë këto dy Data.
- 1.53. **“Periudha e Parë e Kërkimit”** është Periudha prej tre (3) Vjetësh Kontraktualë, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, si dhe çdo zgjatje e kësaj Periudhe sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 1.54. **“Forca Madhore”** ka kuptimin që i jepet në Nenin 20 të kësaj Kontrate.
- 1.55. **“Gaz”** është gazi natyror, si gazi shoqërues ashtu edhe ai jo-shoqërues, si dhe të gjitha elementet përbërëse të tij, të prodhuara nga çdo Pus në Zonën e Kontratës dhe të gjitha substancat jo-Hidrokarbure që ndodhen aty (duke përfshirë dhe pa kufizim gazin e lëngëzuar të naftës (LPG) dhe sqfurin).
- 1.56. **“Praktika të Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure”** janë ato praktika, metoda, standarde dhe procedura përgjithësisht të pranura dhe të zbatuara në shkallë ndërkombëtare nga operatorë të kujdesshëm, të ndërgjegjshëm, të aftë dhe me përvojë në Operacionet e Kërkimit, Zhvillimit dhe Prodhimit të Hidrokarbureve dhe të cilat në një moment të caktuar kohe, në ushtrim të një gjykimi të arsyeshëm nisur nga faktet e njohura në momentin që është marrë një vendim, pritet që të sjellin rezultatet e dëshiruara dhe arrijen e qëllimeve të përcaktuara, për të cilat janë ndjekur praktikën, metodat, standardet, procedurat dhe rregullat, siç mund të jetë rasti: duke marrë në konsideratë gjithësesi se me “Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure” nuk nënkuptohet kufizimi vetëm në praktika ose metoda optimale, duke përjashtuar të gjitha të tjerat, por konsiston në një spektër të gjerë të praktikave, metodave, standardeve, procedurave dhe rregullave të sigurisë, të arsyeshme dhe të matura.
- 1.57. **“Granti i Qeverisë”** është ajo pjesë e Prodhimit e përcaktuar sipas Nenit 7.7 të kësaj Kontrate.



- 1.58. “**Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**” janë një grup parimesh kontabiliteti të pranuar gjerësisht, të zhvilluara, të mbikëqyrura dhe të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB).
- 1.59. “**Akte Ligjore**” janë të gjitha ligjet, duke përfshirë aktet nënligjore në zbatim të tyre, rregulloret, direktivat, rregullat, kodet e praktikës, qarkoret, udhëzimet e të tjera të ngjashme me to, planet mjedisore të kompanisë, kodet e sjelljes, e drejta zakonore, e drejta civile, njoftimet, vendimet, urdhrat, dekretet dhe interpretimet e çdo akti ligjor nga autoritetet rregullatore, ndërkombëtare, dhe rregulloret që janë në fuqi herë pas here;
- 1.60. “**LIBOR**” është norma e interesit vjetor e barabartë me normën e interesit të ofruar në tregun ndërbankar të Londrës (British Bankers Association London Interbank Offered Rate) për depozita njëmujore në dollarë amerikanë, e publikuar në Londër nga Financial Times, ose në Bloomberg.com, ose nëse nuk është e publikuar prej tyre, atëherë ajo e publikuar nga The Wall Street Journal.
- 1.61. “**Line fill**” janë ato Hidrokarbure të përcaktuara sipas Nenit 7.9 të kësaj Kontrate.
- 1.62. “**Materiale**” janë makineritë, pajisjet dhe furnizimet e marra për Operacionet Hidrokarbure.
- 1.63. “**MCF**” është një mijë (1,000) këmbë kub standard (“SCF”). Një (1) SCF është sasia e Gazit të nevojshëm për të mbushur një këmbë kub hapësirë në presion atmosferik prej 14.65 paundë presion për inch katror absolut në një temperaturë bazë prej 60 (gjashtëdhjetë) gradë Fahrenheit.
- 1.64. “**Pikë Matjeje**” është vendi ose vendet, e miratuara bashkërisht nga AKBN-ja dhe KONTRAKTORI, ku do të vendosen pajisje dhe mjete të përshtatshme me qëllim kryerjen e të gjitha matjeve volumetrike dhe përcaktimeve të tjera, temperaturës dhe rregullimeve të tjera, përcaktimit të përmbajtjes së ujit dhe sedimentit dhe matjeve të tjera të nevojshme për të përcaktuar, për qëllime të ndryshme të kësaj Kontrate, volumet e Hidrokarbureve të Disponueshme. Të gjitha matjet dhe përcaktimet e përmendura më sipër do të konfirmohen me shkrim nga përfaqësuesit e AKBN-së dhe KONTRAKTORI në Pikën e Matjes. Pika e Matjes mund të jetë e njëjtë ose jo me Pikën e Lëvrimit.
- 1.65. “**Standardet Minimale Financiare**” është vlerësimi i besueshmërisë së subjektit në cilësinë e një huamarrësi të ardhshëm me "A-" ose më lart nga agjencia "Standard & Poor's Rating Group" ose me "A-" nga "Fitch Ratings Ltd", ose më lart nga agjencia "A.M Best" ose më lart nga "Moody 's Investor Service Inc. " apo ekuivalenti i tyre nga agjenci të tjera të njohura ndërkombëtarisht të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit në cilësinë e një huamarrësi të ardhshëm, të pranuar nga AKBN, pranim i cili nuk do të mohohet në mënyrë të paarsyeshme. Në rastet kur vlerësimet e lartpërmendura nga agjencitë e vlerësimit janë të ndryshme, duhet të përdoret vlerësimi më i ulët i besueshmërisë së subjektit në cilësinë e një huamarrësi për të përcaktuar vlerësimin e zbatueshëm për çdo subjekt. Nëse të gjitha agjencitë "Standard and Poor 's Rating Group", "Fitch Ratings Ltd" dhe "Moody's Investor



Service Inc. "ndalojnë së publikuari vlerësimet përkatëse, standardet e Pranueshme Financiare do të përcaktohen nga AKBN.

- 1.66. **“Programi Minimal i Punës”** janë detyrimet Minimale të Punës dhe/ose detyrimet për Shpenzime Minimale për Periudhën përkatëse të Kërkimit, sipas përcaktimit në Nenin 4.1.1 për Periudhën e Parë të Kërkimit, në Neni 4.1.2 për Periudhën e Dytë të Kërkimit dhe në Nenin 4.1.3 për Periudhën e Tretë të Kërkimit.
- 1.67. **“MMBTU”** janë një milion (1,000,000) BTU.
- 1.68. **“Muaj”** është Periudha e llogaritur duke filluar nga cilado Ditë e Muajit Kalendarik dhe që përfundon në po të njëjtën Ditë të Muajit vijues Kalendarik, ose në çdo rast tjetër, në Ditën e fundit të Muajit Kalendarik.
- 1.69. **“Shpenzime Operative”** janë të gjitha kostot dhe shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të kryera pas Datës së Fillimit të Prodhimit Tregtar, kosto dhe shpenzime të cilat nuk amortizohen normalisht, duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e të gjitha llojeve të pajisjeve të kërkuara për Operacionet Hidrokarbure, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kostot dhe përputhshmëritë për shëndetin e njerëzve, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpenzimet Operative do të përfshijnë remontin, riparimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, por nuk do të përfshijë ndonjë nga të mëposhtmet: devijimin, rishpimin dhe ndryshimin e statusit të Pusit, zëvendësimin e aseteve ose të një pjese të një asemi, shtesat, përmirësimet ose rinovimet që zgjasin jetën e aseteve.
- 1.70. **“Operator”** është një subjekt i caktuar nga KONTRAKTORI dhe i miratuar nga AKBN-ja, për të qenë përgjegjës për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në Zonën e Kontratës ose në një pjesë të saj, sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 1.71. **“Interes Pjesëmarrjeje”** janë interesat përkatëse të pandashme të zotëruara nga secili prej subjekteve që mund të përbëjnë KONTRAKTORIN në çdo moment të caktuar.
- 1.72. **“Palët”** janë AKBN dhe KONTRAKTORI, dhe **“Palë”** i referohet secilës nga Palët, duke përfshirë pasuesit përkatës të tyre.
- 1.73. **“Hidrokarbure”** janë bashkërisht dhe veçmas, sipas kontekstit, Nafta Bruto dhe Gazi, si dhe ato substanca që prodhohen bashkë me to ose përftohen prej tyre.
- 1.74. **“Operacione Hidrokarbure”** janë të gjitha Operacionet e kryera nga KONTRAKTORI sipas kësaj Kontrate deri në Pikën Lëvrimit në Shqipëri, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me Operacionet e Kërkimit, Vlerësimin, Zhvillimit dhe Prodhimit, duke përfshirë Përpunimin e Hidrokarbureve që do të përdoren në Operacione Hidrokarbure dhe operacionet e braktisjes, si dhe të gjitha operacionet e planifikimit, projektimit, administrative, inxhinierike, të ndërtimit dhe mirëmbajtjes, si dhe çdo operacion dhe veprimtari tjetër të parashikuar sipas dispozitave të kësaj Kontrate, por nuk përfshin Operacionet e Përpunimit të Hidrokarbureve.
- 1.75. **“Prodhim”** është çdo lloj Operacioni për Prodhimin e Hidrokarbureve pas Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar, si dhe marrja, ruajtja, trajtimi, magazinimi, transporti, matja dhe lëvrimi i Hidrokarbureve, injektimi ose riinjektimi dhe çdo lloj tjetër



operacioni për projektet parësore dhe dytësore të nxjerrjes së Hidrokarbureve dhe transporti, ruajtja dhe çdo punë apo veprimtari tjetër e nevojshme dhe ndihmëse për këto operacione.

- 1.76. “**Hidrokarbure Fitim**” është sasia e Hidrokarbureve të Disponueshme, e përcaktuar sipas Nenit 7.6 të kësaj Kontrate.
- 1.77. “**Kosto të Refuzuara**” janë kostot e përcaktuara në përputhje me paragrafin e dytë të Nenit 4.10 të kësaj Kontrate.
- 1.78. “**Rezervuar**” është një shtresë poroze ose me çarje dhe e përshkueshme, në gjendje që të prodhojë Hidrokarbure dhe e cila duhet konsideruar, për shkak të karakterit të substancave që mban (e ngjashme nga karakteristikat fizike, densiteti, koeficienti gaz-naftë, viskoziteti dhe një lidhje presioni) si një njësi në lidhje me shfrytëzimin e tij natyral.
- 1.79. “**Renta minerare**” është taksa e përcaktuar sipas Ligjit Nr. 9975, Datë 28.7.2008 “*Për taksat kombëtare*” i ndryshuar.
- 1.80. “**Periudha e Dytë e Kërkimit**” është Periudha prej dy (2) Vjetësh Kontraktuale, që fillon pas Periudhës së Parë të Kërkimit, si dhe çdo zgjatje e kësaj Periudhe sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 1.81. “**Personeli i Lartë Mbikëqyrës**” është, në lidhje me një Palë, çdo drejtor ose zyrtar i lartë asaj dhe çdo person që te kjo Palë ose te çdo Filial i saj, mban një detyrë në të njëjtin nivel drejtues me ose edhe më superior se drejtori i përgjithshëm për Shqipërinë i asaj Pale, i cili është rezident në Shqipëri dhe është përgjegjës për drejtimin e Operacioneve dhe të aktivitetit të asaj Pale në Shqipëri, por duke përjashtuar të gjithë personat që kanë funksione nën nivelin e drejtorit të përgjithshëm për Shqipërinë.
- 1.82. “Situacioni i Kostove dhe të Ardhurave të Përlllogaritura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara” (ose shkurt, “**Situacioni i Kostove dhe të Ardhurave të Përlllogaritura**”) do të thotë një seksion i Situacionit të Mbulimit të Kostove që përmban zërat që njihen në debi dhe kredi mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për çdo Tremujor Kalendarik të caktuar.
- 1.83. “**Situacioni i Mbulimit të Kostove**” është situacioni i përmendur në paragrafin 1 të Nenit III të Procedurës Kontabël.
- 1.84. “**Situacioni i Veprimtarisë së Zhvillimit**” është situacioni i përmendur në Nenin 6.22 të Kontratës.
- 1.85. “**Situacioni i Veprimtarisë së Kërkimit**” është situacioni i përmendur në Nenin 4.8 të Kontratës.
- 1.86. “**Kosto të Pezulluara**” janë Kostot e përcaktuara në përputhje me paragrafin e parë të Nenit 4.10 të kësaj Kontrate.



- 1.87. “**Vit Tatimor**” është Periudha dymbëdhjetë (12) mujore sipas Kalendarit Gregorian, që fillon më Datë 1 janar dhe përfundon më Datë 31 dhjetor, përfshirë të dyja këto Data, për të cilat kërkohen raporte dhe pasqyra tatimore, sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme Shqiptare, në lidhje me të ardhurat, fitimet dhe taksa të tjera.
- 1.88. “**Zgjidhja e Kontratës**” është përfundimi i kësaj Kontrate në mbarim të afatit të zbatueshëm kontraktual, ose në zbatim të dispozitave të Nenit 24, ose me marrëveshje të përbashkët me shkrim mes Palëve.
- 1.89. “**Periudha e Tretë e Kërkimit**” është Periudha prej dy (2) Vjetësh Kontraktualë, që fillon pas Periudhës së Dytë të Kërkimit, si dhe çdo zgjatje e kësaj Periudhe sipas kushteve të kësaj Kontrate.
- 1.90. “**Skema e Zhvillimit të Njesisë**” është skema e përmendur në Nenin 6.30 të Kontratës.
- 1.91. “**Pus Kërkimor**” (Wildcat Well) është një Pus që gjendet në një strukturë gjeologjike, nga i cili nuk janë zbuluar Hidrokarbure Tregtare.
- 1.92. “**Program Pune**” është Programi i parashikuar në Nenin 4 dhe nga dispozita të tjera të kësaj Kontrate dhe, nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, përfshin edhe shtesat dhe ndryshimet e tij.

NENI 2 ANEKSET E KONTRATËS

- 2.1 Aneksi A është një përshkrim i Zonës së Kontratës në Datën e Hyrjes në Fuqi.
- 2.2 Aneksi B është një hartë treguese e Zonës së Kontratës në Datën e Hyrjes në Fuqi.
- 2.3 Aneksi C është Procedura Kontabël.
- 2.4 Aneksi D është procedura për përcaktimin e BOE të Gazit dhe për vendosjen e çmimit të gazit.
- 2.5 Aneksi E është Modeli i Garancisë Bankare.
- 2.6 Anekset A, B, C, D dhe E të kësaj Kontrate janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate dhe konsiderohen se kanë të njëjtin efekt ligjor me dispozitat e Kontratës. Megjithatë në rast mospërputhjeje midis përmbajtjes së Anekseve dhe përmbajtjes së Kontratës, përmbajtja e Kontratës ka përparësi.



Gjatë Periudhës së Parë të Kërkimit, përveç përmbushjes së Programit Minimal të Punës të përcaktuar në këtë Nen 4.1.1, KONTRAKTORI mund të zgjedhë të kryejë Punime Kërkimi shtesë, duke përfshirë, por jo kufizuar në, Shpimin e një Pusi/Puseve shtesë, Punime dhe përpunime, Punime fushore gjeologjike dhe studime mekanike të shkëmbinjve.

Punimet shtesë të Kërkimit duhet të dërgohen te AKBN për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

Nëse Programi Minimal i Punës për një Periudhë Kërkimi realizohet me kosto më të ulët sesa Angazhimi Financiar Minimal i parashikuar, atëherë KONTRAKTORI konsiderohet se ka përmbushur Programin Minimal të Punës dhe Angazhimin Financiar Minimal.

4.1.2 Periudha e Dytë e Kërkimit

Periudha e Dytë e Kërkimit është një Periudhë prej dy (2) Vitesh Kontraktuale nga përfundimi i Periudhës së Parë të Kërkimit dhe mund të shtyhet në përputhje me Nenin 4.3.

Me kusht që të ketë përfunduar Programin Minimal të Punës për Periudhën e Parë të Kërkimit apo që t'i ketë paguar AKBN-së shumën përkatëse (në USD) sipas Nenit 4.1.5 të kësaj Kontrate, KONTRAKTORI do të ketë alternativën e shtyrjes së Periudhës së Kërkimit me një Periudhë shtesë prej dy (2) Vitesh, për Periudhën e Dytë të Kërkimit. Kjo alternativë mund të ushtrohet nga KONTRAKTORI, duke njoftuar me shkrim AKBN-në, jo më pak se tridhjetë (30) Ditë përpara përfundimit të Periudhës së Parë të Kërkimit, për: (i) zgjedhjen e tij për të hyrë në Periudhën e Dytë të Kërkimit, dhe (ii) angazhimin e tij për të zbatuar Programin e mëposhtëm Minimal të Punës gjatë Periudhës së Dytë të Kërkimit:

Periudha e Kërkimit	Kohëzgjatja (Vite)	Programi Minimal i Punës	Angazhimi financiar Minimal
Periudha e Dytë e Kërkimit	2	- Studim gjeologjik dhe gjeofizik (G&G)	3 000 000 USD
		- Ripërpunim i të dhënave sizmike 2D për 200 km	170 000 USD
		- Punime sizmike, përpunim dhe interpretim i të dhënave sizmike 2D për 300 km	17 000 000 USD
		- Shpimi i një Pusi Kërkimi me thellësi 3000 m (opsional - jo Pus angazhimi)	10 000 000 USD
			20 170 000 USD

Vlerësimi G&G do të përfshijë interpretimin e të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të Pusit dhe studimet rajonale gjeologjike dhe strukturore (hartografime, balancimi i profileve tërthore) lidhur me Zonën e Kontratës.



Gjatë Periudhës së Dytë të Kërkimit, përveç përmbushjes së Programit Minimal të Punës të përcaktuar në këtë Nen, KONTRAKTORI mund të zgjedhë të kryejë Punime Kërkimi shtesë, duke përfshirë, por jo kufizuar në, Shpimin e Puseve shtesë, Punime dhe përpunime sizmike, Punime fushore gjeologjike dhe studime mekanike të shkëmbinjve.

Punimet shtesë të Kërkimit duhet të dërgohen te AKBN për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

Nëse Programi Minimal i Punës për një Periudhë Kërkimi realizohet me Kosto më të ulët sesa Angazhimi Financiar Minimal i parashikuar, atëherë KONTRAKTORI konsiderohet se ka përmbushur Programin Minimal të Punës dhe Angazhimin Financiar Minimal.

4.1.3 Periudha e Tretë e Kërkimit

Periudha e Tretë e Kërkimit është një Periudhë prej dy (2) Vitesh Kontraktuale nga përfundimi i Periudhës së Dytë të Kërkimit dhe mund të shtyhet në përputhje me Nenin 4.3.

Me kusht që të ketë përfunduar Programin Minimal të Punës për Periudhën e Dytë të Kërkimit apo që t'i ketë paguar AKBN-së shumën përkatëse (në USD) sipas Nenit 4.1.5 të kësaj Kontrate, KONTRAKTORI do të ketë alternativën e shtyrjes së Periudhës së Kërkimit me një Periudhë shtesë prej dy (2) Vitesh, për Periudhën e Tretë të Kërkimit. Kjo alternativë mund të ushtrohet nga KONTRAKTORI, duke njoftuar me shkrim AKBN-në, jo më pak se tridhjetë (30) Ditë përpara përfundimit të Periudhës së Dytë të Kërkimit, për: (i) zgjedhjen e tij për të hyrë në Periudhën e Tretë të Kërkimit, dhe (ii) angazhimin e tij për të zbatuar Programin e mëposhtëm Minimal të Punës gjatë Periudhës së Tretë të Kërkimit:

Periudha e Kërkimit	Kohëzgjatja (Vite)	Programi Minimal i Punës	Angazhimi financiar Minimal
Periudha e Tretë e Kërkimit	2	- Studim gjeologjik dhe gjeofizik (G&G)	4 000 000 USD
		- Shpimi i një Pusi Kërkimi me thellësi Minimale 3000 m	10 000 000 USD
			14 000 000 USD

Vlerësimi G&G do të përfshijë interpretimin e të dhënave gjeologjike, gjeofizike dhe të Pusit dhe studimet rajonale gjeologjike dhe strukturale (hartografime, balancimi i profileve tërthore) lidhur me Zonën e Kontratës.

Angazhimi për Pusin: Një Pus që do të arrijë një thellësi Minimale vertikale prej 3000 metrash ose derisa ai të arrijë në shtresat Karborantike të Eocenit ose Kretakut, cilado të ndodhë e para.

Gjatë Periudhës së Tretë të Kërkimit, përveç përmbushjes së Programit Minimal të Punës të përcaktuar në këtë Nen, KONTRAKTORI mund të zgjedhë të kryejë Punime Kërkimi shtesë, duke përfshirë, por jo vetëm,



Shpimin e Puseve shtesë, punime dhe përpunime sizmike, punime fushore gjeologjike dhe studime mekanike të shkëmbit.

Punimet shtesë të Kërkimit duhet të dërgohen te AKBN për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

Nëse Programi Minimal i Punës për një Periudhë Kërkimi realizohet me kosto më të ulët sesa Angazhimi Financiar Minimal i parashikuar, atëherë KONTRAKTORI konsiderohet se ka përmbushur Programin Minimal të Punës dhe Angazhimin Financiar Minimal.

- 4.1.4 Periudha e Kërkimit, duke përfshirë çdo zgjatje, do të jetë një Periudhë prej shtatë (7) vjetësh.
- 4.1.5 Nëse KONTRAKTORI nuk arrin të përfundojë në kohë një detyrim të përcaktuar për kryerjen e Punimeve sizmike 2D, KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së një vlerë prej 64 000 USD për çdo kilometër linear të paregjistruar në Periudhën e Parë të Kërkimit dhe një vlerë prej 56 667 USD për çdo kilometër linear të paregjistruar në Periudhën e Dytë të Kërkimit, por megjithatë me kushtin që, me miratimin e AKBN-së, KONTRAKTORI çlirohet nga këto detyrime financiare për moskryerjen e Punimeve sizmike 2D, kur AKBN e konsideron këtë çlirim si të mbështetur në arsye teknike ose të tjera.
- 4.1.6 Nëse KONTRAKTORI nuk arrin të nisë në kohë Shpimin e një Pusi Kërkimi të detyrueshëm ose kur KONTRAKTORI, pas nisjes së Shpimit të një Pusi Kërkimi të detyrueshëm, e braktis Pusin pa e kompletuar atë ose pa përmbushur Shpenzimet Minimale për atë Pus, KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së vlerën e Shpenzimeve Minimale, në rastin kur nuk ka nisur Shpimi i Pusit, ose diferencën nga Shpenzimet Minimale, kur Pusi braktiset sipas parashikimit në Nenin 4.1.3.
- 4.2 KONTRAKTORI gëzon të drejtën e mbulimit të çdo shpenzimi të kryer për të përmbushur Programin e Punës, duke u konsideruar si Shpenzime Kërkimi, sipas mënyrës së parashikuar në Nenin 7.
- 4.3 Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontrate, nëse në përfundim të kohëzgjatjes së Periudhës së Parë, të Periudhës së Dytë apo të Periudhës së Tretë të Kërkimit janë duke u zhvilluar Operacione Shpimi, duke përfshirë edhe Testimin, kjo Periudhë shtyhet automatikisht edhe me njëqind e tetëdhjetë (180) Ditë të tjera pas përfundimit të këtyre Operacioneve të Shpimit ose Testimit.

Nëse KONTRAKTORI vendos të mos hyjë në Periudhën e Dytë ose të Tretë të Kërkimit, në përputhje me dispozitat e Nenit 4.1.2 ose 4.1.3, KONTRAKTORI çlirohet nga detyrimi për Punimet ose shpenzimet për Periudhën për të cilën ai vendos që të mos hyjë, por ai do të ketë të drejtë të vazhdojë me fazën e Vlerësimit të çdo Zbulimi të mundshëm Tregtar që vjen nga një Pus i shpuar gjatë Periudhës së Kërkimit dhe Periudha e Kërkimit shtyhet automatikisht në përputhje me sa më lart.



- 4.4 Të gjithë Puset e realizuar nga KONTRAKTORI në zbatim të këtij Neni 4 do të Programohen drejt një objekti në mirëbesim dhe do të shpohen në mënyrë profesionale në përputhje me Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.
- 4.5 Të paktën tre (3) Muaj përpara fillimit të çdo Viti Kalendarik, apo në kohën kur mund të bihet dakord ndryshe midis AKBN-së dhe KONTRAKTORIT, KONTRAKTORI do të përgatisë një Program Pune dhe buxhetin përkatës për zonën e Kontratës, duke specifikuar Operacionet e Kërkimit që KONTRAKTORI planifikon të realizojë gjatë Vitit Kalendarik pasardhës.

Gjatë çdo Periudhe që përbën Periudhën e Kërkimit, ky Program Pune dhe Buxhet duhet të jenë të paktën të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e KONTRAKTORIT për Punimet Minimale, për Periudhën që mbulojnë.

- 4.6 Programi i Punës dhe Buxheti i Kërkimit, çdo Program Vlerësimi dhe çdo Plan Zhvillimi do të shqyrtohen nga një komitet i përbashkët që do të ngrihet së bashku nga AKBN dhe KONTRAKTORI, pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës. Ky komitet, këtu e në vijim i referuar si "Komiteti Këshillimor i Kërkimit" përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë, tre (3) nga të cilët caktohen nga AKBN-ja dhe tre (3) nga KONTRAKTORI. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të ngrihet brenda tridhjetë (30) Ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi e Kontratës.

Kryetari i Komitetit Këshillimor të Kërkimit emërohet nga AKBN-ja midis anëtarëve të propozuar prej saj.

Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të mbledhet të paktën dy herë në çdo Vit Kalendarik, nëse nuk bihet dakord ndryshe midis operatorit dhe AKBN-së dhe, në zbatim të kësaj Kontrate, ka detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) siguron mundësinë dhe nxit shkëmbimin e informacionit, të pikëpamjeve, ideve dhe të sugjerimeve për Programin e propozuar të Punës së Kërkimit dhe buxhetin përkatës, për Programin e Vlerësimit dhe buxhetin e tij, për planin e Zhvillimit dhe Programin e Punës së Zhvillimit dhe buxhetet përkatëse të tyre, si dhe për rezultatet e Operacioneve Hidrokarbure;
- b) në rastin e një Zbulimi, shqyrton dhe mbështet propozimet e KONTRAKTORIT për Vlerësimin dhe Zhvillimin e mundshëm të këtij Zbulimi; dhe
- c) nxit bashkëpunimin midis AKBN-së dhe KONTRAKTORIT në drejtim të realizimit të kësaj Kontrate në përputhje me kushtet e saj.

KONTRAKTORI do të jetë përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme për realizimin e mbledhjeve të Komitetit Këshillimor të Kërkimit. Kostoja e arsyeshme dhe e nevojshme për realizimin e mbledhjeve të Komitetit Këshillimor të Kërkimit (duke përfshirë, por jo vetëm, kostot e arsyeshme e të nevojshme për pjesëmarrjen në këto mbledhje të përfaqësuesve të autorizuar dhe ekspertëve përkatës të AKBN-së dhe KONTRAKTORIT [deri në 3 këshilltarë nga AKBN dhe KONTRAKTORI]), do të mbulohet dhe paguhet nga KONTRAKTORI në emër të AKBN-së si pjesë e Kostos së Mbulueshme të shpenzimeve të Kërkimit të KONTRAKTORIT, sipas kësaj Kontrate.

Pas shqyrtimit nga Komiteti Këshillimor i Kërkimit, KONTRAKTORI mund të bëjë rregullimet e nevojshme dhe të dorëzojë në AKBN për miratim përfundimtar



Programin e Punës së Kërkimit dhe buxhetin përkatës në formën e rishikuar, miratim i cili nuk do të refuzohet ose vonohet pa arsye.

Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të monitorojë gjithashtu të gjitha Operacionet Hidrokarbure.

AKBN do të miratojë brenda dyzet e pesë (45) Ditëve çdo kërkesë të paraqitur për miratim nga Komiteti Këshillimor i Kërkimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kontratë dhe, nëse ky afat nuk respektohet, këto kërkesa konsiderohen si të miratuara në përfundim të Periudhës së caktuar prej dyzet e pesë (45) Ditësh.

4.7 Më tej bihet dakord që:

4.7.1 Palët pranojnë se detajet e Programit të Punës mund të kërkojnë ndryshime në varësi të rrethanave ekzistuese dhe, për rrjedhojë, KONTRAKTORI mund t'i bëjë këto ndryshime, me kusht që ato të mos ndryshojnë objektivin e përgjithshëm të Programit të Punës.

4.7.2 KONTRAKTORI mund të rishikojë ose modifikojë Programin e Punës dhe buxhetin në fjalë, gjë e cila mund të kërkojë për arsye operationale ose si rezultat i veprimtarisë së Kërkimit ose Vlerësimit. Këto rishikime i nënshtrohen procedurës së përcaktuar në Nenin 4.6.

4.7.3 Në rastin e ngjarjeve emergjente që përfshijnë vënien në rrezik ose humbjen e jetëve, të pronës apo dëmtimin e mjedisit, KONTRAKTORI mund të shpenzojë vlera monetare shtesë të paparashikuara në buxhet, të cilat nevojiten për zbutjen e rrezikut, dhe do të informojë AKBN për rrethanat. Këto shpenzime, objekt i miratimit nga AKBN që nuk do të refuzohet pa arsye, do të konsiderohen si shpenzime Kërkimi dhe do të mbulohen në përputhje me Nenin 7 të kësaj Kontrate.

4.7.4. Nëse AKBN ka dhënë miratimin që KONTRAKTORI të kryejë punime lidhur me zonën e Kontratës para Datës së Hyrjes në Fuqi, shpenzimet e kryera në këtë fazë do të trajtohen si Kosto Operacionesh Hidrokarbure, dhe puna vlen për përmbushjen (e pjeshme) të detyrimeve të KONTRAKTORIT të parashikuara në Nenin 4.1.1

4.7.5 Nëse KONTRAKTORI kryen Punë (duke përfshirë përpunim ose Punime sizmike 3D ose Shpim Pusesh) që është në shtesë të Programit Minimal të Punës të Periudhës përkatëse të Kërkimit, atëherë kjo Punë shtesë i kreditohet detyrimit përkatës të Punës së Periudhës pasardhëse të Kërkimit.

4.8 KONTRAKTORI do të dorëzojë në AKBN sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë nga përfundimi i çdo tremujori Kalendarik, një situacion të veprimtarisë së Kërkimit ku pasqyrohen shpenzimet e Kërkimit të bëra dhe të realizuara nga KONTRAKTORI gjatë tremujorit Kalendarik përkatës (“**Situacioni i Veprimtarisë së Kërkimit**”). Me shpenzime Kërkimi të bëra dhe të realizuara konsiderohet marrja e faturave të rregullta dhe të pakundërshtuara nga ofruesit e shërbimeve ose pajisjeve. KONTRAKTORI rezervon gjithmonë të drejtën që të dërgojë në çdo kohë gjatë Kontratës shpenzimet e kryera lidhur me Operacionet



Hidrokarbure, për mbulimin e Kostove. Regjistrat dhe dokumentet mbështetëse të KONTRAKTORIT duhet të disponueshëm për inspektim në çdo kohë nga AKBN gjatë orarit të rregullt të Punës, për dymbëdhjetë (12) muaj nga Data e marrjes së çdo situacioni.

Brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga Data e marrjes së çdo situacioni, AKBN njofton me shkrim KONTRAKTORIN duke dhënë arsyet mbështetëse të nevojshme, nëse ajo konstaton se:

- 4.8.1 Regjistri i Kostove nuk është i saktë;
- 4.8.2 Kostot e mallrave ose shërbimeve të ofruara nuk janë në përputhje me çmimet ndërkombëtare të tregut për mallra ose shërbime me cilësi të ngjashme, të ofruara me kushte të ngjashme që kanë mbizotëruar në kohën që janë porositur këto mallra ose shërbime;
- 4.8.3 Gjendja e materialeve të furnizuara nga KONTRAKTORI nuk përputhet me çmimin e këtyre materialeve.

KONTRAKTORI do të ketë të drejtën të rishikojë dhe ndryshojë zëra të caktuar të situacionit të veprimtarisë së Kërkimit, kur në gjykimin e tij këto rishikime dhe ndryshime janë të nevojshme për shkak të të dhënave shtesë përkatëse apo të informacionit që mund të ketë marrë KONTRAKTORI dhe këto modifikime nuk ndryshojnë objektivin e përgjithshëm të situacionit fillestar të veprimtarisë së Kërkimit. Kur këto ndryshime ndikojnë në shpenzime të miratuara më parë të përfshira në një situacion të miratuar të veprimtarisë së Kërkimit, KONTRAKTORI gëzon të drejtën t'i bëjë këto ndryshime, me kusht që ato të mos ndryshojnë objektivin e përgjithshëm të situacionit të miratuar më parë të veprimtarisë së Kërkimit dhe që të mos rrisin totalin e këtyre shpenzimeve me më shumë se dhjetë (10) për qind. Brenda tridhjetë (30) Ditësh nga rishikimi i çdo situacioni të veprimtarisë së Kërkimit, KONTRAKTORI do të njoftojë me shkrim AKBN për këto ndryshime, duke cituar natyrën e ndryshimeve dhe arsyet për kryerjen e ndryshimeve. Pas dërgimit të këtij njoftimi, KONTRAKTORI gëzon të drejtën të zbatojë ato ndryshime që KONTRAKTORI lejohet të bëjë në zbatim të dispozitave të sipërpërmendura të këtij Neni.

Ky situacion do të konsiderohet si i miratuar nëse AKBN nuk kundërshton ndonjë zë të situacionit brenda Periudhës dymbëdhjetë (12) mujore të specifikuar më lart. Çdo zë i situacionit i cili nuk kundërshtohet brenda Periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë do të konsiderohet si i miratuar.

- 4.9 AKBN ka në dispozicion një periudhë dymbëdhjetë (12) mujore nga marrja e çdo situacioni për mbulimin e Kostove sipas procedurës kontabël, për të kontrolluar atë dhe për të parashtruar kundërshtimet e saj, sipas parashikimit në Nenin 4.8, për këtë situacion për mbulimin e kostove, i cili përmban kostot për veprimtaritë e Kërkimit. AKBN dhe KONTRAKTORI do të bien dakord për çdo rregullim të nevojshëm. Dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të jenë në dispozicion të AKBN-së gjatë Periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë.



- 4.10 Kostot që AKBN i ka kundërshtuar sipas parashikimit në Nenin 4.8 (“**Kostot e Pezulluara**”) do të përfshihen në pasqyrën e mbulimit të kostove dhe do të jenë Kosto të Mbulueshme, në pritje të gjetjes së një zgjidhjeje miqësore ose derisa çështja të zgjidhet në përputhje me dispozitat për arbitrazhin në Nenin 21 të kësaj Kontrate.

Kostot e pezulluara për të cilat më pas midis AKBN dhe KONTRAKTORIT bihet dakord (ose përcaktohen nga eksperti apo vendosen nga vendimi i arbitrazhit sipas Nenit 21 të kësaj Kontrate) se duhen përjashtuar nga mbulimi i kostove sipas kësaj Kontrate (“**Kostot e Refuzuara**”) mbulohen dhe paguhen plotësisht nga KONTRAKTORI dhe nuk janë Kosto të Mbulueshme.

Çdo rimbursim në favor të AKBN-së nga Hidrokarburet për mbulimin e kostos, si rezultat i një vendimi të marrë nga gjyqtarët e arbitrazhit ose zgjidhjes së mosmarrëveshjes pas auditimit, do të bëhet në para (cash) pranë AKBN brenda tridhjetë (30) Ditësh nga Data e vendimit ose zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- 4.11 Në Datën e Hyrjes në Fuqi ose sa më shpejt të jetë e mundur pas saj, AKBN do të vendosë në dispozicion për përdorim nga KONTRAKTORI, pa pagesë, kopje të të gjitha të dhënave sizmike dhe të Kërkimeve të tjera që AKBN disponon për zonën e Kontratës, duke përjashtuar Kostot nominale për mbledhjen, përgatitjen dhe shumëfishimin e materialeve dhe më pas do t'i japë KONTRAKTORIT në kohë çdo të dhënë tjetër pasi AKBN e merr në posedim. Këto të dhëna do të jenë objekt i kufizimeve të ruajtjes së konfidencialitetit nga KONTRAKTORI siç përcaktohet në Nenin 15.5.

4.12 Operatori

4.12.1 KONTRAKTORI do të zgjedhë një nga subjektet që përbëjnë KONTRAKTORIN për të vepruar në cilësinë e Operatorit, i cili do të kryejë Operacionet Hidrokarbure në zonën e Kontratës në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate dhe me Praktikat e Mira Ndërkombëtare në Industrinë e Hidrokarbureve.

4.12.2 Shell caktohet nëpërmjet Kontrate si Operator, nga Data e Hyrjes në Fuqi.

4.12.3 Emërimi i një Operatori pasardhës i nënshtrohet miratimit paraprak nga AKBN-ja, përveç rasteve kur nuk kërkohet një miratim i tillë dhe mjafton të bëhet vetëm njoftimi me shkrim kur Operatori pasardhës është Filial i Kompanisë.

NENI 5 HEQJA DORË

5.1 Heqja dorë e detyrueshme:

5.1.1 Nëse KONTRAKTORI futet në Periudhën e dytë të Kërkimit ose në Periudhën e tretë të Kërkimit brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas përfundimit të Periudhës së mëparshme të Kërkimit, KONTRAKTORI do t'i dorëzojë AKBN-së njëzet e pesë për qind (25%) të zonës së Kontratës.



- 5.1.2 Me përfundimin e Periudhës së Kërkimit, KONTRAKTORI do t'i dorëzojë AKBN-së të gjithë sipërfaqen e mbetur të zonës së Kërkimit, nëse në këtë kohë ajo nuk është objekt i një zone Zbulimi ose i një zone Zhvillimi dhe Prodhimi.
- 5.1.3 Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër në këtë Kontratë, KONTRAKTORIT nuk i kërkohet të heqë dorë nga sipërfaqet që përfshihen në një zonë Zbulimi ose në një zonë Zhvillimi dhe Prodhimi.
- 5.2 KONTRAKTORI mundet që në çdo kohë të heqë dorë vullnetarisht të gjithë zonën e Kontratës ose pjesë të saj, me kusht që në kohën e kësaj heqje dorë të vullnetshme ai të ketë përmbushur detyrimet e tij për Kërkimin për atë Periudhë aktuale.
- Çdo heqje dorë e tillë në mënyrë të vullnetshme, sipas gjykimit të KONTRAKTORIT, i kreditohet heqjes dorë të detyrueshme të mëvonshme.
- 5.3 Zonat nga të cilat KONTRAKTORI ka hequr dorë sipas këtij Neni 5 i kalojnë automatikisht AKBN-së dhe mund të përdoren apo të jepen lirisht nga AKBN-ja. Megjithatë, KONTRAKTORI mund të vazhdojë të shfrytëzojë instalimet dhe objektet e Punës që ai ka ndërtuar ose po ndërtonte në këto zona për qëllime të kësaj Kontrate dhe kjo e drejtë nuk cënon autoritetin e AKBN-së për t'i përdorur lirisht këto zona.
- 5.4 Zonat nga të cilat KONTRAKTORI ka hequr dorë sipas këtij Neni 5 do të jenë të përmasave dhe formave të mjaftueshme që mundësojnë realizimin e Operacioneve Hidrokarbure në këto zona nga AKBN ose të tretë, me kusht që kjo të mos ndërhyjë në Operacionet e KONTRAKTORIT sipas kësaj Kontrate.
- 5.5 Çdo heqje dorë sipas këtij Neni 5 do të jetë i lirë nga detyrimet, taksat apo tatimet që rrjedhin mbi të ardhurat, nga transferimi apo të lidhura me to.
- 5.6 Përpara se të heqë dorë nga një pjesë e zonës së Kontratës në të cilën janë kryer Operacione Hidrokarbure, KONTRAKTORI do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të rehabilituar çdo ndikim negativ të konsiderueshëm mbi mjedisin të shkaktuar nga Operacionet Hidrokarbure, minimalisht deri në masën e kërkuar nga kuadri ligjor dhe mjedisor në Fuqi në Shqipëri në Datën e Hyrjes e në Fuqi të Kontratës dhe të braktisë zonën e Kontratës në përputhje me planin e braktisjes të dorëzuar dhe miratuar zyrtarisht nga AKBN, miratim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet pa arsye. KONTRAKTORI nuk mban përgjegjësi për asnjë ndikim negativ mbi mjedisin që ka ndodhur përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës.
- 5.7 Nga Data në cilën duhet të bëhet dorëzimi apo në të cilën merr efekt dorëzimi ose nga Data e zgjidhjes së kësaj Kontrate, KONTRAKTORI nuk do të ketë asnjë të drejtë apo detyrim tjetër lidhur me zonën nga e cila ka hequr dorë; megjithatë, çdo përgjegjësi e ngarkuar mbi KONTRAKTORIN përpara Datës në fjalë do të vazhdojë të mbetet e vlefshme edhe pas Datës së zgjidhjes së Kontratës, derisa AKBN të nxjerrë një dokument me shkrim që çliron KONTRAKTORIN nga përgjegjësia, çlirim i cili nuk do të vonohet apo refuzohet pa arsye.



- 5.8 Asnjë heqje dorë nuk e çliron KONTRAKTORIN nga përbushja e angazhimeve minimale sipas Nenit 4 dhe/ose nga ndonjë detyrim tjetër i akumuluar përpara se të hiqte dorë.

NENI 6

ZBULIMI, VLERËSIMI, ZHVILLIMI DHE NJEHSIMI I VENDBURIMIT

Zbulimi dhe Vlerësimi

- 6.1 KONTRAKTORI do të njoftojë AKBN-në brenda tridhjetë (30) Ditësh nga Zbulimi i Hidrokarbureve në zonën e Kontratës. Ky njoftim duhet të përmbledhë të gjitha detajet e disponueshme dhe, nëse është me vend, veçoritë e çdo Programi Testimi që duhet kryer. Çdo Hidrokarbur i prodhuar nga Testimi do të jetë në dispozicion të KONTRAKTORIT, duke iu nënshtruar Nenit 7.1, 7.2, 7.3, 7.6 dhe 7.7.
- 6.2 Nëse KONTRAKTORI gjykon se një Zbulim ka nevojë për Vlerësim, KONTRAKTORI do të dërgojë për miratim në AKBN sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të Pusit të Kërkimit në fjalë, një Program të detajuar Vlerësimi dhe buxhetin përkatës për të vlerësuar nëse Zbulimi është një Zbulim Tregtar.
- 6.3 Programi i Vlerësimit duhet të përshkruajë zonën e Zbulimit dhe vendndodhjen, shtrirjen dhe madhësinë e përllogaritur të Zbulimit dhe duhet të përfshijë gjithashtu planin për Vlerësimin e Zbulimit dhe Periudhën e nevojshme të Vlerësimit për të përfunduar Programin e Vlerësimit.
- Nëse Shell (ose ndonjë kompani në varisë) apo një kompani me standarde dhe reputacion të krahasueshëm me Shell, pushon së ekzistuari si operator përpara Datës së nisjes së Programit të Vlerësimit, gjen zbatim Ligji nr. 6/2017, Datë 2.2.2017.
- 6.4 Nëse AKBN nuk kërkon me shkrim ndonjë ndryshim në Programin e Vlerësimit dhe buxhetin e tij, brenda dyzet e pesë (45) Ditësh nga marrja e tyre, Programi i Vlerësimit dhe buxheti konsiderohen si të miratuar nga AKBN, dhe KONTRAKTORI do të vazhdojë me kujdes me Vlerësimin e Zbulimit në përputhje me Programin përkatës.

Nëse KONTRAKTORI kërkon një shtyrje të Programit të Vlerësimit, KONTRAKTORI duhet të dorëzojë:

- i. Raportin përmbledhës të rezultateve teknike aktuale dhe interpretimit të këtyre të dhënave, krahasuar me objektivat fillestare të vlerësimit.
- ii. Raportin teknik të pasigurive të mbetura të pazgjithura, të cilat nevojiten për të marrë një vendim për realizueshmërinë teknike të projektit.
- iii. Planin në lidhje me afatet dhe veprimtaritë, për Programin shtesë të Punës që nevojitet për të demonstruar realizueshmërinë teknike të projektit.



- 6.5 Brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh nga përfundimi i Vlerësimit, KONTRAKTORI do të dorëzojë një raport te Komiteti Këshillimor i Kërkimit për rezultatet e Programit e Vlerësimit. Ky raport duhet të përfshijë të gjitha të dhënat përkatëse teknike dhe ekonomike të tij. Gjithashtu, KONTRAKTORI njofton AKBN-në nëse ai deklaron një Zbulim si Zbulim Tregtar.
- 6.6 Nëse KONTRAKTORI njofton AKBN-në për deklarimin e një Zbulimi Tregtar, ky deklarim bëhet mbi bazën që Zbulimi mund të shfrytëzohet ekonomikisht, pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave përkatëse operative, teknike dhe financiare të mbledhura gjatë zbatimit të Programit të Vlerësimit dhe ndryshe, duke përfshirë por jo vetëm, rezervat e shfrytëzueshme të natës bruto dhe/ose gazit natyror, nivelet e Prodhimit të qëndrueshëm dhe faktorët e tjerë teknikë e ekonomikë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare në industrinë e Hidrokarbureve.
- 6.7 Nëse KONTRAKTORI ka hequr dorë nga një zonë Zbulimi në përputhje me Nenin 5.1, ai gëzon të drejtën e refuzimit të parë lidhur me dhënien e Zbulimit një pale të tretë nga AKBN, e drejtë e cila do të ushtrohet në mënyrën e mëposhtme:
Nëse AKBN merr një ose më shumë oferta për Zhvillimin e këtij Zbulimi dhe AKBN në mirëbesim ka vullnetin për t'ia dhënë këtë Zhvillim ofertuesit më të mirë, atëherë AKBN do të njoftojë KONTRAKTORIN për kushtet e kësaj oferte. KONTRAKTORI do të ketë në dispozicion nëntëdhjetë (90) Ditë, nga marrja e tyre, për t'i pranuar këto kushte dhe, pas pranimin të tyre, AKBN dhe KONTRAKTORI do të negociojnë në mirëbesim ato kushte shtesë që zakonisht përmban një Kontratë me Ndarje Prodhimi, me kusht që ato kushte të pasqyrojnë kushtet e kësaj Kontrate.
- 6.8 Çdo Zbulim Tregtar mund të përbëhet nga një (1) rezervuar ose një grup rezervuarësh, i cili pas Vlerësimit konsiderohet nga KONTRAKTORI se mund të shfrytëzohet ekonomikisht.
- 6.9 Nëse KONTRAKTORI ka bërë një Zbulim gjatë Periudhës së Parë të Kërkimit, Periudhës së Dytë të Kërkimit ose Periudhës së Tretë të Kërkimit, Periudha në fjalë zgjatet automatikisht për zonën e Zbulimit të përcaktuar sipas Nenit 6 për një Periudhë Vlerësimi. Periudha për realizimin e Programit të Vlerësimit mund të zgjatet nga KONTRAKTORI, nëse aspektet operacionale e kërkojnë diçka të tillë, në mënyrën e përshkruar në Nenin 6.4.

Zhvillimi dhe Prodhimi

- 6.10 Nëse KONTRAKTORI raporton se një Zbulim është një Zbulim Tregtar sipas Nenit 6.6, KONTRAKTORI do të përgatisë një plan Zhvillimi dhe do ta dorëzojë atë për miratim në AKBN sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas deklarimit të Zbulimit Tregtar. Kjo Periudhë mund të zgjatet me kërkesë të KONTRAKTORIT, nëse ekzistojnë rrethana që sipas mendimit të arsyeshëm të Palëve garantojnë këtë zgjatje të afatit.
- 6.11 Plani i Zhvillimit duhet të përgatitet në përputhje me Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.
- 6.12 Plani i Zhvillimit duhet të përmbajë:



- (a) detajet e të gjitha veprimtarive të Kërkimit të kryera në lidhje me Zbulimin përkatës, si dhe të gjithë informacionin e përdorur për Vlerësimin e Zbulimit, detajet e strukturës gjeologjike, të pranisë së Hidrokarbureve dhe stratigrafisë dhe detajet e çdo Vlerësimi tjetër të nevojshëm që mund të kërkohet nga KONTRAKTORI;
 - (b) vëllimet e përllogaritura të naftës dhe/ose gazit që gjenden fillimisht në shtresë dhe sasinë e përllogaritur si të rikuperueshme, mënyrën e parashikuar të operimit dhe efikasitetin e rikuperueshmërisë, hapësirën e drenimit, politikën e parashikuar për shfrytëzimin e rezervuarit dhe objektin e rikuperimit dytësor;
 - (c) detajet e objekteve ose strukturave që KONTRAKTORI propozon të ndërtojë ose çdo Punimi tjetër që ai propozon të realizojë gjatë Periudhës së Zhvillimit dhe prodhimit për zbulimin përkatës, për qëllimet e Prodhimit të naftës dhe/ose gazit nga ky zbulim dhe për minimizimin e djegies së gazit në faket dhe për parandalimin e ndotjes së ambientit;
 - (d) vendndodhjen dhe qëllimet për të cilat do të përdoren objektet, strukturat dhe punimet, dhe afatet në të cilat parashikohet nisja dhe përfundimi i çdo objekti, strukture dhe Punimi;
 - (e) Vlerësimin e KONTRAKTORIT për tregtueshmërinë e Hidrokarbureve, sasitë maksimale dhe minimale të Hidrokarbureve që KONTRAKTORI parashikon të rikuperojë nga zbulimi përkatës në çdo Vit të Periudhës së prodhimit të lidhur me të, prodhim në nivelin e pritshëm të rikuperimit dhe detajet e çdo problemi të pritshëm në lidhje me prodhimin dhe shitjen dhe që duhet rishikuar çdo Vit;
 - (f) detajet e shpenzimeve të pritshme vjetore dhe fluksin e parasë të shpenzimeve kapitale dhe operative dhe që duhen rishikuar çdo Vit; dhe
 - (g) një vlerësim të arsyeshëm të kohës që nevojitet për zbatimin e Planit të Zhvillimit;
 - (h) Pikat e parashikuara të Matjes dhe Pikat e Lëvrimit;
 - (i) detajet e zonës së Zhvillimit dhe Prodhimit dhe shtrirjen e zonës së propozuar të Zhvillimit dhe Prodhimit lidhur me Zbulimin Tregtar, zonë e cila duhet të përkojë me projeksionin sipërfaqësor të shtrirjes gjeologjike të Zbulimit Komercial në zona që lidhen në mënyrë të arsyeshme me të dhe që duhet të përcaktohet si zonë Zhvillimi dhe Prodhimi për Zbulimin Tregtar në fjalë.
- 6.13 AKBN mund t'i kërkojë KONTRAKTORIT që të japë çdo informacion tjetër që ai mund të ketë në dispozicion dhe që mund t'i nevojitet AKBN-së në mënyrë të arsyeshme për të vlerësuar Planin e Zhvillimit për çdo zonë Zhvillimi dhe Prodhimi. Kjo kërkesë për informacion duhet bërë brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh nga marrja e planit të Zhvillimit dhe KONTRAKTORI do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të kthyer përgjigje brenda tridhjetë (30) Ditësh.



- 6.14 Nëse AKBN nuk kërkon me shkrim ndonjë ndryshim në planin e Zhvillimit brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh nga marrja e tij, plani do të konsiderohet si i miratuar nga AKBN.
- 6.15 Nëse AKBN kërkon ndonjë ndryshim në planin e Zhvillimit, KONTRAKTORI dhe AKBN do të takohen brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh nga Data që KONTRAKTORI merr njoftimin me shkrim të AKBN-së për ndryshimet që kërkohen, ndryshime të cilat nuk do të jenë të paarsyeshme, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për planin e Zhvillimit. Rishikimet në Planin e Zhvillimit të rëna dakord brenda një Periudhe shtesë prej nëntëdhjetë (90) Ditësh do të integrohen në një plan të rishikuar, i cili do të konsiderohet si i miratuar nga AKBN.
- 6.16 Pas miratimit të Planit të Zhvillimit, KONTRAKTORI do të dorëzojë në AKBN gjashtëdhjetë (60) Ditë përpara përfundimit të çdo Viti Kalendarik një situacion të detajuar të Punimeve të Zhvillimit dhe të buxhetit për Vitin Kalendarik pasardhës. Për rrjedhojë, për Vitin e parë e të plotë Kalendarik dhe për pjesën e Vitit Kalendarik që paraprin Vitin e parë e të plotë Kalendarik do të dorëzohet një situacion i detajuar i Programit të Punës së Zhvillimit dhe buxhetit brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga Data e miratimit të planit të Zhvillimit sipas Nenit 6.14 ose 6.15. Për rrjedhojë, çdo situacion i tillë vjetor i detajuar i Programit të Punës së Zhvillimit dhe buxhetit duhet të jetë në përputhje me Planin e Zhvillimit të miratuar sipas Nenit 6.14 ose me planin e rishikuar në zbatim të Nenit 6.15 dhe 6.17.
- 6.17 KONTRAKTORI mund të dorëzojë në çdo kohë në AKBN, sipas rastit, rishikime të një Plani Zhvillimi ose të Programit të Punës së Zhvillimit dhe Buxhetit. Këto rishikime duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Nenit 6.11 dhe, në rastin e rishikimeve në Planin e Zhvillimit, ato i nënshtrohen procedurës së miratimit të përcaktuar në Nenin 6.14 dhe 6.15 dhe, në rastin e rishikimeve në Punën e Zhvillimit dhe të Buxhetit, ato i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit të përcaktuar në Nenin 4.6.
- 6.18 Kur AKBN dhe KONTRAKTORI bien dakord se mund të arrihet një përfitim ekonomik reciprok duke ndërtuar dhe shfrytëzuar objekte të përbashkëta (duke përfshirë, por jo vetëm, rrugë, tubacione dhe objekte të tjera transportimi, komunikimi dhe magazinimi), AKBN dhe KONTRAKTORI do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të arritur një marrëveshje me prodhuesit e tjerë dhe për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtyre objekteve të përbashkëta, për mbulimin e investimit dhe për detyrimet që duhen paguar.
- 6.19 Nëse pas përcaktimit të një zone Zhvillimi dhe Prodhimi, shtrirja e zonës që përfshin Zbulimin Tregtar në mënyrë të arsyeshme besohet se është më e madhe sesa përcaktimi në Planin e Zhvillimit sipas Nenit 6.12 dhe mbivendoset mbi një zonë mbi të cilën ka juridiksion Qeveria Shqiptare, me kërkesë të KONTRAKTORIT, Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit do të zgjerohet në përputhje me konstatimin e ri dhe pa asnjë kosto për KONTRAKTORIN, me kusht që për zonën që mbulohet të mos jetë lidhur asnjë Kontratë me Ndarje Prodhimi për Kërkimin ose Prodhimin e Hidrokarbureve. Si pjesë e kësaj Kontrate, KONTRAKTORI mund të lejohet të studiojë të gjitha të dhënat gjeologjike dhe gjeofizike që AKBN disponon ose mund të lejohet të kryejë një Program Vlerësimi shtesë që mund të kërkohet për të konturuar zonën e zgjeruar.



- 6.20 Kur sipas mendimit të KONTRAKTORIT një Zbulim nuk konsiderohet Tregtar për shkak të parametrave ekonomikë të Kontratës, por ku KONTRAKTORI sheh gjithsesi mundësi teknike për të zhvilluar Zbulimin, Palët do të takohen dhe diskutojnë dhe, nëse është e mundur, të bien dakord për ato ndryshime të Kontratës që do t'i mundësonin KONTRAKTORIT të deklaronte një Zbulim Tregtar. Në rast se Palët nuk arrijnë në një marrëveshje reciproke, gjen zbatim Neni 6.7, *mutatis mutandis*.
- 6.21 KONTRAKTORI do të mbajë shënim të dhënat lidhur me sasitë e Hidrokarbureve të disponueshme dhe të ujit të prodhuar çdo muaj Kalendarik sipas kësaj Kontrate, ku tregohet pjesa korresponduese e Hidrokarbureve Fitim për secilën Palë sipas kësaj Kontrate. Këto të dhëna do të dorëzohen çdo muaj pranë AKBN-së dhe tek autoritetet tatimore përkatëse shqiptare. Statistikat ditore ose javore lidhur me prodhimin nga Zona e Kontratës duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë të arsyeshme për ekzaminim nga përfaqësuesit e autorizuar të AKBN-së.
- 6.22 KONTRAKTORI do të dorëzojë në AKBN, brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga përfundimi i çdo tremujori Kalendarik, një situacion të veprimtarisë së zhvillimit ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë tremujor Kalendarik (“**Shpenzimet e Zhvillimit**” dhe “**Shpenzimet operative**”), të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre (“**Situacioni i veprimtarisë së Zhvillimit**”). Ky situacion do të jetë objekt i kontrollit nga AKBN, sipas parashikimit në pikën 3.2 të Nenit I të procedurës kontabël.
- 6.23 Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit fillon, në lidhje me çdo Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi, në datën që miratohet një Plan Zhvillimi për një Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi dhe vazhdon deri në përfundimin e Periudhës njëzet e pesë (25) vjeçare nga Data e Prodhimit të parë Tregtar nga kjo Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi.
- 6.24 Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit mund të shtyhet përtej përfundimit të saj, sipas zgjedhjes së KONTRAKTORIT, me periudha pasuese pesë (5) vjeçare dhe me të njëjtat kushte të parashikuara në këtë Kontratë, ku këto shtyrje do të jenë objekt i miratimit nga AKBN, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye, nëse KONTRAKTORI mund t'i demonstrojë AKBN-së se zona e Kontratës ka ende kapacitete për Prodhimin e Hidrokarbureve.
- 6.25 KONTRAKTORI mund të përdorë lirisht pa asnjë detyrim për Operacionet Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, Hidrokarbure të prodhuara nga zona e Kontratës, në përputhje me Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.
- 6.26 Gazi natyror që del nga zona e Kontratës e që nuk përdoret nga KONTRAKTORI për Operacionet Hidrokarbure dhe që nuk është objekt i Nenit 8 të kësaj Kontrate, mund të digjet në faket ose të riinjektohet, sipas zgjedhjes së KONTRAKTORIT, me përjashtim të rastit kur AKBN i kërkon KONTRAKTORIT me shkrim që t'ia lëvrojë AKBN-së gazin natyror në fjalë në ndarësit e gazit. Ky lëvrim për AKBN nuk do të ndikojë në Operacionet Hidrokarbure normale të KONTRAKTORIT dhe në grafikonin për Zhvillimin. Çdo kosto lidhur me përmbushjen nga KONTRAKTORI të kërkesës së AKBN-së do të mbulohet dhe paguhet nga AKBN.



- 6.27 KONTRAKTORI ruan të drejtën e aksesit në të gjitha tregjet e disponueshme të naftës dhe gazit (në tregjet e brendshme dhe në ato ndërkombëtare) për të garantuar sigurimin e vlerës maksimale për KONTRAKTORIN dhe Republikën e Shqipërisë.

Njehsimi i vendburimit

- 6.28 Nëse nga shqyrtimi i të dhënave teknike duket e arsyeshme që një Zonë Zbulimi ose një Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi të shtrihet përtej Zonës së Kontratës, Palët do të takohen për të diskutuar bashkëpunimin midis tyre dhe/ose me një palë të tretë që mund të përfshihet, për shtrirjen e Kërkimit, Zhvillimit ose Prodhimit jashtë Zonës së Kontratës, por këto diskutime nuk duhet të kenë asnjë ndikim në vazhdimin nga KONTRAKTORI të Vlerësimit, Zhvillimit dhe Prodhimit të Hidrokarbureve nga pjesa e Rezervuarit që ndodhet në zonën e Kontratës.
- 6.29 Nëse në çdo moment gjatë kohës në të cilën Kontrata është në fuqi, shtresa naftëmbajtëse në zonën e Kontratës ka mbivendosje me një zonë apo zona të tjera për të cilat ekziston në fuqi një Kontratë e lidhur nga AKBN-ja apo një licencë e dhënë prej saj, KONTRAKTORI do të përpiqet të bashkëpunojë me mbajtësit e licencës për blloqet afër saj, për të arritur zgjidhjen më të mirë teknike dhe ekonomike për Zhvillimin e të gjithë vendburimit dhe kjo zgjidhje e Zhvillimit mund të jetë individuale ose e përbashkët. Megjithatë, nëse AKBN vlerëson se Plani i propozuar i Zhvillimit nuk është në interesin kombëtar, AKBN mund të vendosë që të gjitha Operacionet të kryhen në përputhje me një Skemë të Zhvillimit të Njesisë.
- 6.30 Skema e Zhvillimit të Njesisë do të miratohet bashkërisht nga KONTRAKTORI dhe pala e tretë që ka një Kontratë apo një licencë të dhënë nga AKBN, të cilët do të dorëzojnë bashkërisht skemën për miratim nga AKBN. Nëse nuk arrihet një marrëveshje midis KONTRAKTORIT dhe palës së tretë për Skemën e Zhvillimit të Njesisë ose kur AKBN nuk e miraton skemën, Skema e Zhvillimit të Njesisë do të jetë një skemë e përgatitur nga një ekspert. Nëse KONTRAKTORI konstaton se skema e përgatitur nga eksperti është e papranueshme, KONTRAKTORI gëzon të drejtën të kërkojë modifikime të saj ose mund të zgjedhë që të tërhiqet nga vendburimi.
- 6.31 KONTRAKTORI do të zbatojë dhe respektojë të gjitha kushtet e skemës së zhvillimit të njesisë të përcaktuar sipas Nenit 6.29.
- 6.32 Nëse shtresa naftëmbajtëse e përmendur në Nenin 6.28 shtrihet në një zonë që nuk është pjesë e Zonës së Kontratës dhe mbi të cilën Republika e Shqipërisë nuk ka asnjë juridiksion, Operacionet Hidrokarbure të KONTRAKTORIT do të kryhen në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë që mund të jenë të zbatueshme në këtë rast dhe AKBN do të ndërmarrë përsipër negociimin me agjencinë kompetente të Qeverisë së huaj që ka juridiksion mbi zonën, për të rënë dakord për një Skemë të Zhvillimit të Njesisë, duke pasur si konsideratë interesat e KONTRAKTORIT. KONTRAKTORI do të sigurojë ndihmën eksperte për AKBN-në për arritjen e marrëveshjes së sipërcituar. Kjo Kontratë do të ndryshohet më pas për të pasqyruar marrëveshjen e arritur midis dy shteteve. Nëse ndryshimi është i papranueshëm për KONTRAKTORIN, atëherë ai mund të heqë dorë nga Zona e Zbulimit në të cilën ndodhet shtresa naftëmbajtëse.

**NENI 7****MBULIMI I KOSTOVE DHE SHPENZIMEVE, NDARJA E PRODHIMIT DHE HIDROKARBURET FITIM, DHE KOSTOT E PAMBULUESHME****Hidrokarburet për mbulimin e kostos**

- 7.1 KONTRAKTORI do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet sipas kësaj Kontrate nga pjesa e Hidrokarbureve të Disponueshme, që në vijim referohen sipas rastit “Hidrokarbure për mbulimin e kostos, nafta bruto për mbulimin e kostos, gazi për mbulimin e kostos”. Pjesa e Hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si Hidrokarbure për mbulim kostoje, është nëntëdhjetë për qind (90%) pas heqjes së Rentës Minerare dhe Grantit për Qeverinë, siç përshkruhet më poshtë në Nenin 7.7. KONTRAKTORI ka të drejtë t’i marrë Hidrokarburet për mbulimin e kostos në natyrë, t’i eksportojë lirisht dhe t’i përdorë ato.

Kostot dhe shpenzimet e rikuperueshme në çdo muaj Kalendarik do të rikuperohen së pari nga nafta bruto për mbulimin e kostos, në qoftë se ka të tillë dhe së dyti nga gazi për mbulimin e kostos, në qoftë se ka të tillë.

- 7.2 Kostot dhe shpenzimet sipas kësaj Kontrate do të mbulohen nga Hidrokarburet për mbulim kostoje në mënyrën e mëposhtme:
- 7.2.1 Shpenzimet e Kërkimit dhe të Vlerësimit, duke përfshirë totalin e atyre të akumuluarra përpara Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar, do të mbulohen plotësisht, pa amortizim, duke filluar nga: (i) Muaji Kalendarik në të cilin janë kryer këto shpenzime ose (ii) Muaji Kalendarik në të cilin bie Data e Prodhimit Fillestar Tregtar ose e Prodhimit të Testit ose e Prodhimit të Testimit të zgjatur, cilido muaj vjen më pas.
- 7.2.2 Shpenzimet e Zhvillimit, duke përfshirë ato të akumuluarra përpara Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar, do të mbulohen plotësisht, pa amortizim, duke filluar nga: (i) Muaji Kalendarik në të cilin janë kryer këto shpenzime ose (ii) Muaji Kalendarik në të cilin bie Data e Prodhimit Fillestar Tregtar, cilido muaj vjen më pas. Shpenzimet e Zhvillimit duhet të jenë të arsyeshme, domethënë, në përputhje me Praktikën e Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve dhe çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e të njëjtit lloj dhe cilësie, që janë të disponueshme në kohën kur këto shërbime, pajisje dhe materiale kërkohen sipas kësaj Kontrate.
- 7.2.3 Të gjitha shpenzimet operative të kryera pas Datës së Zbulimit Tregtar, do të mbulohen plotësisht, pa amortizim, duke filluar nga muaji më i fundit ndërmjet këtyre të dyve: (i) Muaji Kalendarik në të cilin janë kryer ose (ii) Muaji Kalendarik në të cilin bie Data e Prodhimit Fillestar Tregtar. Shpenzimet operative duhet të jenë të arsyeshme, domethënë, në përputhje me Praktikën e Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve dhe çmimet e tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e të njëjtit lloj dhe cilësie, që janë të disponueshme në kohën kur këto shërbime, pajisje dhe materiale kërkohen sipas kësaj Kontrate.



- 7.3 Në atë masë që, për çdo tremujor kalendarik, pasqyra e mbulimit të kostos tregon kosto dhe shpenzime të pambuluara, këto sasi të pambuluara do të mbarten në pasqyrat e mbulimit në tremujorin apo tremujorët e tjerë kalendarikë pasardhës derisa të mbulohen plotësisht.
- 7.4 Njëkohësisht me miratimin e Planit të Zhvillimit, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të bien dakord nëse pjesa e Hidrokarbureve Fitim e AKBN-së dhe Granti i Qeverisë do të merret nga AKBN-ja në Hidrokarbure apo do të merret dhe shitet nga KONTRAKTORI në emër të AKBN-së dhe në vazhdim, pasi të merren të ardhurat nga një shitje e tillë, t'i paguhen AKBN-së në para (cash), bazuar në Vlerësimin e Hidrokarbureve sipas Nenit 7.

Në rast se Palët bien dakord që Granti i Qeverisë dhe/ose pjesa e Hidrokarbureve Fitim e AKBN-së do të merret nga AKBN-ja në natyrë, marrëveshja të përmbajë, ndër të tjera, parashikime në lidhje me alokimin e sasive të ndryshme të Hidrokarbureve dhe procedurat për marrjen, duke përfshirë marrjen e tepërt ose të mangët të pjesës së AKBN-së.

- 7.5 Çdo muaj Kalendarik, KONTRAKTORI do të marrë në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponojë Hidrokarburet për mbulim kostoje, plus pjesën e vet të Hidrokarbureve Fitim, në përputhje me paragrafin 7.6. Me dorëzimin tek AKBN-ja të çdo pasqyre tremujore të mbulimit të kostos, Palët do të bëjnë rregullimet e duhura në përputhje me paragrafët 7.3 dhe 7.4.

Ndarja e Hidrokarbureve Fitim - Faktori "R"

- 7.6 Për çdo muaj kalendarik, të gjitha Hidrokarburet e disponueshme të mbetura pasi zbritet renta minerare, Granti për Qeverinë dhe të gjitha shpenzimet dhe Kostot e Mbulueshme, sipas kësaj Kontrate për atë muaj Kalendarik, do të jenë Hidrokarbure Fitim dhe në përputhje me Nenin 7.5 më sipër, do të merren në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponohen lirisht dhe individualisht, nëpërmjet eksportit apo në mënyra të tjera, me riskun, koston dhe shpenzimet përkatëse të AKBN-së dhe KONTRAKTORIT, sipas rastit. Pjesa përkatëse apo përqindja e Hidrokarbureve Fitim që i takon AKBN-së dhe KONTRAKTORIT përkatësisht, gjatë një muaji Kalendarik, përcaktohet siç parashikohet në këtë Nen 7.6

- 7.6.1 Faktori "R" do të përdoret me qëllim përcaktimin e të drejtës përkatëse të Palëve në Hidrokarburet Fitim dhe Grantin për Qeverinë në çdo muaj Kalendarik. Faktori "R" është dhe llogaritet si raporti i të ardhurave kumulative të KONTRAKTORIT që nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në fund të Vitit Kalendarik pararendës, ndaj shpenzimeve kumulative të KONTRAKTORIT të realizuara që nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në fund të Vitit Kalendarik pararendës.

Të ardhurat kumulative do të jenë vlera totale e sa më poshtë, përcaktuar në përputhje me Neni 7 dhe Aneksin D: (a) Pjesa e Hidrokarbureve Fitim të KONTRAKTORIT plus (b) Hidrokarburet për Mbulimin e Kostos, minus Tatim Fitimin e KONTRAKTORIT, të paguar sipas Nenit 9.



Shpenzimet kumulative do të jenë vlera totale e të gjitha kostove, shpenzimeve dhe harxhimeve të realizuara më parë nga KONTRAKTORI sipas Kontratës, si Shpenzime Zhvillimi, Shpenzime Kërkimi apo Shpenzime Operative.

- 7.6.2 Në varësi të dispozitave të tjera të kësaj Kontrate, përqindja e Hidrokarbureve Fitim, që përbën pjesët përkatëse të AKBN-së dhe KONTRAKTORIT përcaktohet për çdo Muaj Kalendarik duke përdorur faktorin "R" të aplikueshëm për atë Vit Kalendarik (i llogaritur siç parashikohet në paragrafin 7.6.1). Pjesët përkatëse të KONTRAKTORIT dhe AKBN-së në Hidrokarburet Fitim, për Naftën Bruto dhe Gazin, tregohen në tabelën e mëposhtme

Faktori "R"	Nafta		Gazi	
	Pjesa e KONTRAKTORIT	Pjesa e AKBN	Pjesa e KONTRAKTORIT	Pjesa e AKBN
$0 < R \leq 1.50$	99%	1%	100%	0%
$1.50 < R \leq 2.00$	95%	5%	100%	0%
$2.00 < R \leq 2.50$	90%	10%	100%	0%
$2.50 < R$	85%	15%	100%	0%

Përqindjet e Hidrokarbureve Fitim që i takojnë AKBN-së dhe KONTRAKTORIT, përkatësisht, zbatohen edhe për pjesën e fitimit për Naftën Bruto dhe për pjesën e fitimit për gazin.

Pranohet që pjesa e KONTRAKTORIT në Hidrokarburet Fitim, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, do t'i nënshtrohet, një tatimi mbi fitimin sipas Ligjit shqiptar nr. 7811, "Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim), të ndryshuar", datë 12.4.1994 për t'u paguar në përputhje me Nenin 9 të kësaj Kontrate. Në rast se Zhvillimi i një Zbulimi përcaktohet të jetë marginal nga pikëpamja ekonomike ose është bërë marginal si pasojë e shfrytëzimit të tij dhe KONTRAKTORI kërkon lehtësira të tjera tatimore për të vazhduar me Zhvillimin, KONTRAKTORI dhe AKBN-ja do të bëjnë përpjekjet më të mira për të siguruar lehtësitat tatimore sipas Nenit 1, nënseksioni 3 i Ligjit nr. 7811, "Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim), të ndryshuar", datë 12.4.1994, që i nevojiten KONTRAKTORIT për të vazhduar me Zhvillimin.

- 7.7 Nga Granti për Qeverinë në Prodhimin e Hidrokarbureve, AKBN-së i takon një pjesë e barabartë me:

Faktori "R"	Granti për Qeverinë
$0 < R \leq 1.50$	0%
$1.50 < R \leq 2.00$	2,5%
$2.00 < R$	5%

- 7.8 Pavarësisht nëse parashikohet ndryshe nga ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate, Prodhimi mesatar Ditor nuk do të përcaktohet derisa të gjitha tubacionet apo pjesët e



tyre, që kërkohen për marrjen e Hidrokarbureve para apo pas Pikës së Matjes të jenë mbushur dhe presuar me sasinë e duhur të Hidrokarbureve (“Line Fill”). AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të bien dakord me shkrim për kohën kur Line Fill mund të disponohet dhe të përfshihet në Prodhimin Mesatar Ditor.

- 7.9 Sipas kësaj Kontrate, shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të mbulueshme dhe për këtë arsye nuk do të pasqyrohen në pasqyrën e mbulimit të kostove, që është objekt auditimi nga AKBN, me përjashtim të rasteve kur AKBN-ja ka dhënë miratimin për rastin (a) ose (c) më poshtë:
- a) Kostot e realizuara përpara Datës së Hyrjes në Fuqi, që lidhen me përmbushjen e një detyrimi pune, të pamiratuara nga AKBN-ja;
 - b) Kostot e realizuara përtej Pikës së Lëvrimit;
 - c) Dhuratat, kontributet ose sponsorizimet e pamiratuara nga AKBN-ja;
 - d) Çdo bonus dhe tarifë paguar AKBN-së në përputhje me Nenin 27;
 - e) Gjobat dhe interesat e tyre përkatëse, të vëna në mënyrë të rregullt nga një agjenci e Qeverisë Shqiptare dhe të paguara nga KONTRAKTORI;
 - f) Shpenzimet për interesat të kryera nga KONTRAKTORI në lidhje me huatë bankare të marra për të financuar Operacionet Hidrokarbure;
 - g) Detyrime ose kreditime të dublikuara, sipas Aneksit C, Neni II, paragrafi 15;
 - h) Pagesa ose kompensimi për dëme, në kuadër të Kontratës, sipas Aneksit C, Neni II, paragrafi 7;
 - i) Kostot për mbajtjen e Garancisë Bankare, sipas Nenit 29.4;
 - j) Pagesat që i janë bërë AKBN-së, sipas Nenit 4.1.5 dhe 4.1.6

7.10 **Cmimi i Naftës Bruto**

Vlera e Naftës Bruto e marrë në natyrë dhe e disponuar nga KONTRAKTORI sipas kësaj Kontrate gjatë çdo Muaji Kalendarik, për të gjitha qëllimet sipas kësaj Kontrate, do të llogaritet mbi bazën e çmimit mesatar të ponderuar të marrë realisht në dollarë në pikën FOB të shitjes së eksportit të Naftës Bruto nga Shqipëria, sipas kësaj Kontrate, të ndërmarra nga KONTRAKTORI. Për këtë qëllim, të gjitha kontratat e shitjes së naftës bruto me Filialet e Kompanisë, të cilat janë në fuqi, do të merren në konsideratë, duke përjashtuar kontratat me klering, dhe çdo shitje të çastit që nuk është në mënyrë të arsyeshme konsistente me çmimet predominuese të tregut për naftë bruto. Kuptohet që, në rast të shitjeve CIF, do të bëhen zbritjet e duhura për pagesat e transportit dhe sigurimit, faktike apo të deklaruara, cilado që të jetë më e ulët, për të llogaritur çmimin FOB në pikën e eksportit. Në asnjë rast nuk do të zbritet ndonjë komision apo shpërblim për marketimin.

- 7.11 Në rastin kur, gjatë një Muaji Kalendarik, nuk ka shitje për eksport nga KONTRAKTORI, sipas Kontratave të shitjes së Naftës Bruto në fuqi, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI, përpara Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar, do të bien dakord për një shportë me të paktën dy (2) dhe jo më shumë se katër (4) nafta bruto, të kuotuar për qëllime të vendosjes së çmimit dhe të disponueshme për eksport në portet e Mesdheut, që janë të krahasueshme me naftën bruto të disponueshme dhe që tregtohen lirshëm në tregjet ndërkombëtare (“Shporta”). Vlera e Naftës Bruto për Mbulim të



Kostos do të jetë çmimi mesatar i Shportës për çdo Muaj Kalendarik në të cilin nuk janë bërë shitje për eksport, siç përcaktohet nga çmimet e naftës bruto në Shportë, të botuara nga "Platt's Oilgram Price Report" për Çmimet e Naftës Bruto në Nivel Global "Kontratë afatshkurtër/shitje të çastit (Spot)" për transaksionet e përfunduara në atë Muaj Kalendarik. Kuptohet që në lidhje me Shportën do të zbatohen parimet e mëposhtme:

- 7.11.1 Nafta bruto që do të përfshihet në Shportë si e krahasueshme me Naftën Bruto të Disponueshme do të jetë ajo që nuk ndryshon me më shumë ose më pak se katër (4) gradë API me këtë Naftë Bruto dhe e cila ka një përmbajtje sqfuri jo më shumë një për qind (1%) mbi përmbajtjen e tij në këtë Naftë Bruto.
- 7.11.2 Çmimi i Shportës do të rregullohet si më poshtë: (i) me zero presje zero dyzetë e pesë dollarë amerikanë (0,045 USD) për Fuçi, për çdo një-të dhjetë të plotë (1/10) të gradës API me të cilën nafta bruto është mbi ose nën mesataren aritmetike të gravitetit API të Shportës; ii) me pesë cent amerikanë (0,05 USD) për Fuçi, për çdo një-të dhjetë të plotë të një për qind (0,1%) me të cilin përqindja e sqfurit në Naftën Bruto është mbi ose nën mesataren aritmetike të përmbajtjes së sqfurit të Shportës; dhe (iii) me diferencën ndërmjet tarifës së transportit për transportimin e Naftës Bruto nga pika e eksportit në Lavera, Francë, dhe mesatares aritmetike të tarifës së transportit për Shportën, për transportin e Naftës Bruto në Shportë nga pika e zakonshme FOB e origjinës në Lavera, Francë. Nëse mesatarja aritmetike e tarifës së transportit të Shportës është më e lartë, kjo diferencë t'i shtohet çmimit të Shportës. Nëse mesatarja aritmetike e tarifës së transportit të Shportës është më e ulët, kjo diferencë do t'i zbritet çmimit të Shportës. Për këtë qëllim, "tarifa e transportit" do të përcaktohet si kuotim i tarifës "Vlerësimi Mesatar i Tarifës së Transportit" (AFRA) për anijet e përmasave LR1, i publikuar për atë muaj Kalendarik, shumëzuar me: (a) tarifën fikse të zbatueshme në shkallë botërore për transportin e Naftës Bruto nga pika e eksportit në Lavera, Francë dhe (b) mesataren aritmetike të tarifës së zbatueshme në shkallë botërore për Naftën Bruto në Shportë nga pika e zakonshme e eksportit të tyre FOB në Lavera, Francë.
- 7.11.3 Nëse botimi në fjalë apo ndonjë botim i përshtatshëm i mëvonshëm nuk do të botohet më, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI duhet të bien dakord me shkrim për një botim zëvendësues. Në rast se nuk ka asnjë botim që mund të përdoret si bazë referimi, Palët bien dakord me shkrim për procedurën që do të ndiqet për të rregulluar Shportën.
- 7.11.4 Në rast se, në të ardhmen, çmimi i një apo më shumë naftave bruto në përbërje të Shportës kuotohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, çmimi në fjalë do të konvertohet në dollarë me kursin mesatar të blerjes të të gjitha kurseve të këmbimit për atë monedhë të cituar nga Citibank, Londër, në momentin e mbylljes së veprimtarisë në çdo ditë përkatëse.
- 7.11.5 Shporta mund të rishikohet në mënyrë periodike, nëse kërkohet, me marrëveshje me shkrim ndërmjet AKBN-së dhe KONTRAKTORIT, për të



reflektuar çdo ndryshim në cilësinë e Naftës Bruto të prodhuar nga Zona e Kontratës.

- 7.11.6 Në mungesë të një citimi të një (1) ose më shumë naftave bruto të rëna dakord në Shportë, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të takohen për të rënë dakord mbi zëvendësimin e naftës bruto.
- 7.11.7 Shporta duhet të përmbajë vetëm referenca të çmimeve ekuivalente me FOB.
- 7.12 Në rastin kur AKBN dhe KONTRAKTORI nuk kanë mundur të përcaktojnë Shportën për qëllimet e Nenit 7.11 brenda tridhjetë (30) Ditëve pas përfundimit të Muajit Kalendarik përkatës, secili prej tyre, brenda tridhjetë (30) Ditëve në vijim, do të emërojnë nga një Ekspert për vendosjen e çmimit të naftës bruto. Këta dy (2) ekspertë, brenda një afati tjetër prej tridhjetë (30) Ditësh bien dakord për një Ekspert të tretë për vendosjen e çmimit të naftës bruto, dhe më pas që të tre (3) Ekspertët do të përpiqen të përcaktojnë Shportën sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në Nenin 7.11 më sipër. Në rast se AKBN apo KONTRAKTORI nuk arrin të emërojë Ekspertin e sipërpërmendur, Pala tjetër ka të drejtën t'i drejtohet Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë, për të emëruar një Ekspert që të veprojë për llogari të Palës që nuk ka arritur të emërojë Ekspertin.
- Nëse këta dy (2) Ekspertë nuk arrijnë të bien dakord për Ekspertin e tretë, do të emërohet edhe një ekspert i paanshëm nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Paris, Francë. Përcaktimi i Shportës duhet të bëhet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë pas emërimit të Ekspertit të tretë. Përcaktimi nga të tre (3) Ekspertët e emëruar do të bëhet me shumicë votash dhe do të jetë detyrues dhe përfundimtar për AKBN-në dhe KONTRAKTORIN. Kostot dhe shpenzimet e Ekspertëve do t'i ngarkohen në mënyrë të barabartë AKBN-së dhe KONTRAKTORIT.
- 7.13 Në pritje të marrëveshjes së përbashkët sipas Nenit 7.11, ose të përcaktimit nga Ekspertët sipas Nenit 7.12, Shporta e përdorur do të jetë Shporta e fundit e përcaktuar në përputhje me Nenin 7.11 ose 7.12, cilado të jetë më i fundit, dhe pas arritjes së marrëveshjes sipas Nenit 7.11 apo përcaktimit nga Ekspertët sipas Nenit 7.12, do të bëhen përshtatjet e duhura (dhe çdo pagesë e duhur do të bëhet në përputhje me vendimin) brenda tridhjetë (30) Ditësh pas datës së marrëveshjes në fjalë apo vendimit të Ekspertit, për të vendosur Palët në të njëjtin pozicion që do të kishin qenë nëse do të kishin rënë dakord për Shportën ose nëse Shporta e përcaktuar nga Ekspertët do të kishte qenë në fuqi gjatë periudhës në fjalë.
- 7.14 Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë para Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar dhe më pas në fillim të çdo tremujori kalendarik, KONTRAKTORI do të përgatitë dhe do t'i dërgojë AKBN-së një parashikim të prodhimit, ku të përcaktohet sasia totale e Hidrokarbureve të disponueshme që parashikohet se mund të prodhohet nga zona e Kontratës në secilin prej katër (4) Tremujorëve Kalendarikë vijues, bazuar në koeficientin e nxjerrjes të projektuar për të maksimizuar nxjerrjen përfundimtare të Hidrokarbureve (Koeficienti Efikas Maksimal) nga Zona e Kontratës, në përputhje me praktikën e pranuar përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të Hidrokarbureve. KONTRAKTORI do të shqyrtojë siç duhet çdo koment apo rekomandim të bërë nga



përfaqësuesit e AKBN-së në lidhje me këtë parashikim. KONTRAKTORI do të përpiqet të prodhojë sasinë e parashikuar çdo Tremujor Kalendarik.

- 7.15 KONTRAKTORI ka të drejtën të marrë veçmas në natyrë dhe të eksportojë të gjitha Hidrokarburet për mbulimin e Kostos dhe Hidrokarburet Fitim, mbi të cilat ka të drejta sipas kësaj Kontrate. KONTRAKTORI ka të drejtën të transferojë lirshëm apo të mbajë jashtë Shqipërisë të gjitha të ardhurat e siguruara nga Hidrokarburet, duke përfshirë të ardhurat nga shitja e pjesës së vet të Hidrokarbureve për mbulim të Kostos dhe Hidrokarbureve Fitim, pavarësisht nëse këto shitje bëhen në Shqipëri apo nga Hidrokarburet e eksportuara nga KONTRAKTORI.
- 7.16 Në një kohë të arsyeshme përpara Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar dhe herë pas here, siç mund të kërkohet më pas, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të takohen dhe do të bien dakord për një procedurë për planifikimin e marrjes së Hidrokarbureve në Pikën e Matjes. Asnjë nga Palët nuk do të fitojë apo humbasë si rezultat i marrjeve sipas këtij plani. Nxjerrjet e Hidrokarbureve nga KONTRAKTORI konsiderohen se konsistojnë në radhë të parë në të drejtën e plotë të KONTRAKTORIT ndaj Hidrokarbureve për Mbulimin e Kostos, me qëllim që mbulimi i kostos të mund të vazhdojë në përputhje me këtë Kontratë, dhe pjesa e mbetur e tyre konsiderohet se konsiston në Hidrokarbure Fitim.

NENI 8 GAZI

- 8.1 Nëse gazi (sipas përkufizimit në Nenin 1.55) prodhohet apo bëhet i prodhueshëm për shitje nga Zona e Kontratës, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të konsiderojnë të gjitha alternativat e mundshme ekonomike për përdorimin e tij dhe do të vendosin bashkërisht për alternativën më të mirë për AKBN-në dhe KONTRAKTORIN. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e këtij Neni 8, Aneksi D, dhe Ligji Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
- 8.2 Nëse KONTRAKTORI bën një Zbulim të Gazit, do të zbatohen dhe do të ndiqen procedurat e Nenit 6, në zbatim të sa më poshtë. Nëse ka ndonjë Zbulim Gazi që KONTRAKTORI e konsideron se mund të jetë Zbulim Tregtar dhe ka mungesë apo papërshtatshmëri të një tregu të disponueshëm për tregtimin e rezervave të gazit nga ai Zbulim, kjo Kontratë do të pezullohet në lidhje me një Zbulim të tillë Gazi gjatë periudhës në të cilën nuk ka filluar ende Zhvillimi i rezervave të Gazit, me kusht që një periudhë e tillë të mund të mos i kalojë 5 (pesë) vjet nga data e Zbulimit përkatës të Gazit (“Periudha e Pezullimit të Gazit”). Gjatë Periudhës së Pezullimit të Gazit për një Zbulim të tillë, Palët do të bëjnë përpjekjet e arsyeshme në mirëbesim për të hetuar dhe shqyrtuar tregjet që mund të zhvillohen për tregtimin e atyre rezervave Gazi dhe të shqyrtojë, gjithashtu, nëse mund të bien dakord bashkërisht për të kryer veprime apo modifikime për ta bërë atë Zbulim një Zbulim Tregtar. Gjatë çdo periudhe të Pezullimit të Gazit sipas këtij Neni 8.2, pjesa e Zonës së Kontratës që përbën prospektin gjeologjik që përmban rezervat e Gazit të Zbulimit (“Zona e Gazit e Pezulluar”) do të përcaktohet nga KONTRAKTORI, në varësi të miratimit nga AKBN-ja, dhe nuk do t’i nënshtrohet detyrimit për të hequr dorë, sipas Nenit 5 të kësaj Kontrate dhe as ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontrate, duke përfshirë pa kufizim, mbarimin e Periudhës së Kërkimit. Me të filluar Zhvillimi i Zonës së Gazit të



- Pezulluar, periudha e pezullimit të gazit do të mbarojë dhe do të zbatohen dispozitat përkatëse të Nenit 6. Kuptohet që, në rast se zhvillimi i Zonës së Gazit të Pezulluar nuk ka filluar gjatë periudhës së pezullimit të gazit, KONTRAKTORI do të heqë dorë nga zona e gazit e pezulluar.
- 8.3 Nëse botimet e çmimeve të përmendura në Nenin 7 dhe në Aneksin D nuk publikojnë ose nuk pasqyrojnë kushtet dhe/ose çmimet reale të tregut, kuotimet e Naftës Bruto dhe të produkteve do të merren nga tabelat e botuara në një botim tjetër që vazhdon të botohet, i përshtatur me marrëveshje mes Palëve, në mënyrë që t'u afrohet sa më afër rezultateve që do të ishin arritur, nëse nuk do të kishte ndodhur një mungesë e tillë publikimi apo pasqyrimi. Nëse botime të tilla ndalojnë së botuari, Palët do të bien dakord për burime të tjera reference për çmime.
- 8.4 Nëse ndonjë burim reference për çmime, siç përmendet në Nenin 7 apo në Aneksin D, do të botonte një ndryshim me fuqi prapavepruese, në rritje apo në zbritje, për çmime të Naftës Bruto apo të produkteve, që përmendet në Nenin 7 ose në Aneksin D, efekti i një ndryshimi të tillë në llogaritjen e çmimeve për çdo muaj kalendarik do të kufizohet vetëm te ai muaj që i paraprin muajit të botimit të ndryshimit me fuqi prapavepruese.

NENI 9 **TATIMET DHE TAKSAT SHOIPTARE**

- Për këtë Kontratë zbatohet ligji nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim)”, i ndryshuar me ligjin nr. 8345, Datë 13.5.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim)”; i ndryshuar më tej me ligjin nr. 10049, Datë 24.12.2008 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim-Prodhim)”; i ndryshuar më tej me ligjin nr. 32/2012, Datë 21.03.2012 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim – Prodhim)”, i ndryshuar më tej me ligjin nr. 183/2013, Datë 28.12.2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, Datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim – Prodhim)”” (bashkërisht referuar si “Legjislacioni Fiskal për Hidrokarburet”), që është në Fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate.
- 9.1 KONTRAKTORI paguan Rentën Minerare në masën 10 % të Hidrokarbureve të Disponueshme në përputhje me Ligjin Nr. 9975, Datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”.
- 9.2 Secili prej subjekteve që përbën KONTRAKTORIN, siç mund të rezultojë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, i nënshtrohet pagesës së tatimit shqiptar mbi fitimin, në përputhje me Ligjin Nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim dhe Prodhim)” dhe me dispozitat e këtij Neni 9. Tatimi mbi fitimin, në Fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate, është në normën pesëdhjetë për qind (50%) të zbatueshme në pjesën e tij të Hidrokarbureve Fitim.



- 9.3 Përqindjet e ndarjes së fitimit të rëna dakord, sipas Nenit 7.6 të kësaj Kontrate, janë përcaktuar duke marrë parasysh që subjektet që përbëjnë KONTRAKTORIN do t'i nënshtrohen tatimit mbi fitimin të zbatueshëm në Shqipëri në Datën e Hyrjes në Fuqi të Kontratës sipas Legjislacionit Fiskal për Hidrokarburet. Për këtë qëllim, Palët bien dakord që norma e tatimit mbi fitimin të jetë fikse për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate, me përjashtim të rastit kur mund të reduktohet sipas Nenit 1, nënseksioni 3, i Ligjit Nr. 7811, Datë 12.4.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim dhe Prodhim)” ose sipas ndonjë ligji tjetër Shqiptar.
- 9.4 Nëse në ndonjë rast, gjë që nuk ka të ngjarë të ndodhë, përqindja e tatimit mbi fitimin, e përmendur në Nenin 9.2, rritet pavarësisht Ligjit Nr. 7811, Datë 12.04.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve (Kërkim dhe Prodhim)”, dhe dispozitave të tij, Hidrokarburet për Mbulimin e Kostos dhe/ose përqindjet e ndarjes së fitimit të përcaktuara sipas Nenit 7.1, 7.2, 7.3, 7.4, 7.6, 7.6.1, 7.6.2 dhe 7.7 dhe/ose sipas çdo dispozite tjetër të kësaj Kontrate do të konsiderohen si të ndryshuara automatikisht, për të ruajtur ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate, në mënyrë që KONTRAKTORI të marrë të njëjtën pjesë të Hidrokarbureve Fitim, sikur përqindja e tatimit mbi fitimin të kishte mbetur pesëdhjetë për qind (50%) (ashtu si edhe në rastin e reduktimit të saj, në përputhje me Nenin 9.2 më sipër).
- 9.5 Nëse gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, KONTRAKTORI mund të përbëhet nga më shumë se një subjekt, Operatori mund të vendosë që tatimin shqiptar mbi fitimin e secilit prej enteve që përbëjnë KONTRAKTORIN ta paguajë në para (cash) tek autoriteti përkatës i Qeverisë Shqiptare, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme shqiptare, brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga depozitimi në AKBN i Pasqyrës për Mbulimin e Kostove për Vitin përkatës Kalendarik, siç kërkohet nga Neni III i Procedurës Kontabël. PAGESA e Rentës Minerare do të bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9975, Datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”.
- 9.6 KONTRAKTORI do të paguajë vetëm Rentën Minerare dhe tatimin shqiptar mbi fitimin, siç përshkruhet më sipër, sipas Legjislacionit Fiskal për Hidrokarburet, në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate. Secili prej subjekteve që përbëjnë KONTRAKTORIN dhe nënkontraktorët e tyre do të përjashtohen nga taksat, tarifat, tatimet, detyrimet dhe pagesat shqiptare të çfarëdolloj natyre, duke përfshirë pa kufizim, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat e pagueshme në Shqipëri, në përputhje me Ligjin nr. 92/2014, Datë 24.7.2014 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, i cili parashikon përkatësisht në germën "k" të Nenit 53 dhe në paragrafin 39 të Nenit 56, se furnizimi i shërbimeve dhe importi i mallrave dhe shërbimeve për Operacionet Hidrokarbure gjatë fazës së Kërkimit përjashtohen nga TVSH-ja. Ky përjashtim nuk përfshin pagesat normale portuale, të magazinimit dhe postare, si dhe detyrime të ngjashme të zakonshme që zbatohen përgjithësisht për shërbimet e kryera realisht. TVSH-ja Shqiptare e paguar nga KONTRAKTORI për furnizimin dhe importin e atyre mallrave dhe shërbimeve që nuk mbulohen nga objekti i përjashtimit nga TVSH-ja, siç parashikohet në këtë Nen, rimbursohen brenda 60 Ditësh, sipas parashikimeve në fuqi të Ligjit nr. 92/2014, Datë 24.7.2014 “Për TVSH-në”, i ndryshuar.
- 9.7 KONTRAKTORI do të përmbushë kërkesat e ligjit Shqiptar në lidhje me depozitimin e deklaratave tatimore, vlerësimin tatimor dhe mbajtjen e librave dhe regjistrave kontabël për t'u kontrolluar nga personat e autorizuar.



NENI 10
ZYRAT DHE BËRJA E NJOFTIMIT

- 10.1 Operatori do të mbajë një zyrë në Shqipëri, në përputhje me ligjin shqiptar, dhe njoftimet e dërguara në adresën e asaj zyre do të konsiderohen si të dërguara në mënyrë të vlefshme.
- 10.2 Njoftimet dhe çdo komunikim tjetër që kërkohet ose lejohet nga kjo Kontratë, do të konsiderohet se janë dhënë kur bëhen me shkrim dhe dërgohen ose dorazi, ose me postë, ose email, në adresat përkatëse si më poshtë:

Për AKBN:

(i) dorazi, me postë ose email:

AKBN

Në vëmendje të: Drejtorit Ekzekutiv

Adresa: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto"

(ii) me email:

[●]

Për KONTRAKTORIN:

(i) dorazi ose me postë:

Shell Upstream Albania B.V.

Në vëmendje të: [Drejtori i Përgjithshëm]

Adresa: Carel van Bylandtlaan 30, 2596 HR The Hague, the Netherlands.

(ii) me email:

[●]

AKBN dhe KONTRAKTORI mund të ndryshojnë adresat, duke njoftuar njëri-tjetrin për ndryshimin.

NENI 11
RUAJTJA E HIDROKARBUREVE DHE PARANDALIMI I HUMBJEVE

- 11.1 KONTRAKTORI do të marrë të gjitha masat e duhura, sipas metodave përgjithësisht të pranueshme në përdorim në industrinë ndërkombëtare të Hidrokarbureve, për të parandaluar humbjet apo shpërdorimin e Hidrokarbureve mbi ose nën tokë gjatë Operacioneve të Shpimit, Prodhimit, Grumbullimit dhe Shpërndarjes apo Magazinimit.
- 11.2 Me përfundimin e Shpimit të një Pusi Prodhimi, KONTRAKTORI do të informojë AKBN-në për kohën kur do të testohet Pusi dhe ritmet e prodhimit, pasi të jenë përcaktuar rezultatet.

NENI 12
PËRJASHTIMI NGA DETYRIMET DOGANORE

- 12.1 KONTRAKTORI dhe nënkontraktorët e tij të angazhuar në kryerjen e Operacioneve sipas kësaj Kontrate, lejohen të importojnë dhe përjashtohen nga detyrimet doganore (me përjashtim të pagesave normale portuale dhe të magazinimit që zbatohen



përgjithësisht në Shqipëri për shërbimet reale që i ofrohen KONTRAKTORIT) në lidhje me importimin e makinerive, pajisjeve, materialeve, duke përfshirë por pa u kufizuar në, artikujt e konsumit, pasuritë e luajtshme dhe pjesë këmbimi për secilën nga sa më sipër, për t'u përdorur në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure për realizimin e kësaj Kontrate, sipas Legjislacionit Fiskal për Hidrokarburet. KONTRAKTORI do të ndjekë hapat e procedurës ligjore, siç përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Shqiptare, që janë të nevojshme të ndërmerren për të bërë të zbatueshme lejet e importit dhe përjashtimet nga detyrimet doganore që i jepen KONTRAKTORIT sipas këtij paragrafi 12.1.

- 12.2 Secili punonjës i huaj i KONTRAKTORIT dhe nënkontraktorëve të tij lejohet të importojë dhe përjashtohet nga të gjitha detyrimet doganore (me përjashtim të pagesave normale portuale dhe të magazinimit që zbatohen përgjithësisht në Shqipëri për shërbimet reale që u ofrohen atyre) në lidhje me sendeve të përdorimit vetjak, me kusht që këto sende të importohen vetëm për përdorim nga punonjësit dhe familjet e tyre, sipas Legjislacionit Fiskal për Hidrokarburet
- 12.3 Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 12.1 nuk zbatohet për asnjë artikull importi kur artikujt të njëjtit lloj apo kryesisht të njëjtit lloj dhe cilësi prodhohen në vend dhe janë të disponueshëm për blerje dhe lëvrim në kohë në Shqipëri, me një çmim jo më të lartë se kostoja e njësisë të importuara para detyrimeve doganore, por pasi janë shtuar kostot e sigurimit dhe transportit.
- 12.4 Në vartësi të miratimit nga AKBN për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i koston, secili prej artikujve të importuar në Shqipëri, i përjashtuar apo jo nga detyrimet doganore sipas këtij Neni, që nuk u është shitur palëve të treta në Shqipëri në përputhje me paragrafin 12.5, mund të eksportohet nga pala importuese në çdo moment pas njoftimit në zyrën e doganave, pa pagesë të ndonjë takse, tarife eksporti apo pagese.
- 12.5 Në vartësi të miratimit nga AKBN-ja për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i koston, të rinj apo të përdorur, por në gjendje pune, materiale, pajisje dhe mallra të përdorur në operacionet sipas kësaj Kontrate nga KONTRAKTORI dhe objektet shtëpiake dhe artikujt vetjakë që i përkasin personelit të KONTRAKTORIT, mund të shiten brenda Shqipërisë, me kusht që blerësit t'i paguajnë zyrës doganore detyrime e zbatueshme doganore, nëse ka, me përjashtim të rasteve kur i shiten një subjekti tjetër që gëzon të njëjtat të drejta përjashtimi si KONTRAKTORI.
- 12.6 Në vartësi të miratimit nga AKBN-ja për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i koston, ato materiale, pajisje dhe mallra të dëmtuar apo të përdorur që nuk janë në gjendje pune dhe që klasifikohen nga KONTRAKTORI si mbeturinë apo si hedhurinë, mund të shiten si mbeturina apo hedhurina pa pagesë të detyrimeve doganore nga KONTRAKTORI.
- 12.7 Në rast të një shitje të tillë sipas paragrafit 12.5 (përveç objekteve shtëpiake, sendeve personale në pronësi të punonjësit të KONTRAKTORIT dhe nënkontraktorëve të tij) dhe 12.6 më sipër, të ardhurat nga një shitje e tillë do të ndahen në mënyrën e mëposhtme: KONTRAKTORI gëzon të drejtën të marrë të ardhurat, të cilat (pa detyrimet doganore) kur merren do të reduktojnë Koston e Pambuluar, nëse ka, të cilën KONTRAKTORI ka të drejtë ta mbulojë në përputhje me Nenin 7 të kësaj



Kontrate. Nëse nuk mbetet kosto për t'u mbuluar nga KONTRAKTORI, atëherë të gjithë të ardhurat (pa detyrimet doganore) të këtyre shitjeve, nëse ka, do t'i paguhen AKBN-së.

- 12.8 KONTRAKTORI përjashtohet nga detyrimi për licencim për eksport të naftës bruto nga Shqipëria, në përputhje me Ligjin Nr. 8450 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”, datë 24.2.1999. Për sa i përket eksportit të gazit, zbatohen rast pas rasti dispozitat e Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. KONTRAKTORI gjatë eksportit të Naftës Bruto nga Shqipëria do të paguajë Rentën Minerare në përputhje me Ligjin Nr. 9975, “Për Taksat Kombëtare”, datë 28.7.2008.
- 12.9 AKBN-ja do të bashkëpunojë me KONTRAKTORIN me qëllim që të lehtësojë operacionet e importit dhe eksportit, duke përfshirë procedurat përkatëse të zhdoganimit sipas kësaj Kontrate.

ENI 13

LIBRAT KONTABËL, KONTABILITETI DHE PAGESAT

- 13.1 KONTRAKTORI do të mbajë në zyrat e tij të biznesit në Shqipëri, librat kontabël, në përputhje me praktikat kontabël të kërkuara nga ligji shqiptar, procedura kontabël, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe praktikat e kontabilitetit të përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të Hidrokarbureve, si dhe në përputhje me aktet ligjore dhe dispozitat e kësaj Kontrate, dhe libra e regjistra të tjerë që mund të jenë të nevojshëm për të treguar punën e kryer sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë sasinë e të gjitha Hidrokarbureve të disponueshme. KONTRAKTORI do t'i mbajë librat dhe regjistrat kontabël në dollarë amerikanë dhe në lekë.

Në rast të ndonjë procesi arbitrazhi sipas Nenit 21 të kësaj Kontrate, ku përfshihen librat kontabël në shqip të KONTRAKTORIT, të mbajtura në përputhje me procedurën kontabël, do të kenë përparësi IFRS dhe praktikat e industrisë ndërkombëtare të Hidrokarbureve ndaj atyre pjesëve të librave që janë hartuar në përputhje me ligjin shqiptar, në rastet kur ka mospërputhje mes tyre.

- 13.2 Të gjitha shpenzimet në dollarë regjistrohen në librat kontabël të KONTRAKTORIT në shumën e shpenzuar. Të gjitha shpenzimet në lekë konvertohen në dollarë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur është bërë pagesa e shpenzimit përkatës. Të gjitha shpenzimet në valuta të tjera, konvertohen në dollarë sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Reuters në orën 11:00 C.E.T. të Ditës së faturimit. Në rast se faqja zyrtare e Reuters nuk është e disponueshme, Palët do të bien dakord bashkërisht për një burim alternativ të kurseve të këmbimit valutor. Mbahen shënime të gjitha kurset e këmbimit që janë përdorur për konvertimin e valutës shqiptare dhe të valutave të tjera në dollarë, për të gjitha shpenzimet. KONTRAKTORIT i lejohet të mbajë dhe të përdorë lirisht llogari bankare në dollarë, jashtë Shqipërisë dhe në Shqipëri, për qëllime të operacioneve të tij sipas kësaj Kontrate. Për qëllime të kësaj Kontrate, KONTRAKTORI ka liri të plotë për të marrë dhe për të mbajtur jashtë Shqipërisë dhe për të përdorur lirisht valutat e huaja të marra prej tij jashtë Shqipërisë, duke përfshirë të ardhurat nga shitjet e Hidrokarbureve sipas kësaj Kontrate, dhe nuk ka detyrimin për t'i sjellë këto të ardhura në Shqipëri, me



përrjashtim të atyre të ardhurave që mund t'i nevojiten, sipas gjykimit të tij, për të mbuluar shpenzimet në Shqipëri.

- 13.3 Librat dhe regjistrat kontabël të përmendur më sipër, do të mbahen në Shqip dhe në anglisht, dhe do të jenë të disponueshme në çdo moment të arsyeshëm për inspektim nga përfaqësuesit e autorizuar të AKBN-së dhe të autoriteteve tatimore shqiptare.

NENI 14 **PËRGJEGJËSIA PËR DËMET**

- 14.1 KONTRAKTORI do të ushtrojë aftësi profesionale, kujdes dhe gatishmëri të arsyeshme në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. KONTRAKTORI mban përgjegjësi ndaj AKBN-së për veprime apo mosveprime të tij, vetëm për ato raste kur provohet se veprimet apo mosveprimet e KONTRAKTORIT kanë ardhur si rezultat i pakujdesisë së tij.
- 14.2 Në rast të ndonjë dëmi për të cilët KONTRAKTORI është përgjegjës sipas këtij Neni 14, KONTRAKTORI do të përpiqet për të marrë menjëherë dhe me kujdes masat e nevojshme, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe Praktikat e Mira të Industrisë Ndërkombëtare të Hidrokarbureve, për të zbutur dëmin dhe për të rikthyer Operacionet në gjendje normale. KONTRAKTORI do të shlyejë dëmet përkatëse deri në shumën 10 000 000 dollarë amerikanë, për të cilat është shpallur përgjegjës me vendim të prerë.
- 14.3 KONTRAKTORI në asnjë rast nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmet shkakësore, që do të thotë, për dëmet që nuk janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e veprimeve apo mosveprimeve të KONTRAKTORIT, duke përfshirë prodhimin e munguar ose fitimin e munguar.
- 14.4 KONTRAKTORI, si pjesë e Operacioneve Hidrokarbure, do të mbajë ato sigurime që do të mbante çdo operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm në industrinë e Hidrokarbureve, në lidhje me operacionet e tij. Megjithatë, KONTRAKTORI nuk do të ketë detyrim që të sigurojë pasuri që nuk përdoren më nga KONTRAKTORI në Operacionet Hidrokarbure.
- 14.5 KONTRAKTORI mban përgjegjësi ndaj AKBN-së vetëm për ato raste kur Personeli i Lartë Drejtues i KONTRAKTORIT ka treguar pakujdesi të rëndë në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure.
- 14.6 Të gjitha sigurimet sipas kësaj Kontrate duhet të blihen te ato kompani sigurimi që përmbushin Standardet Minimale Financiare (me përjashtim të sigurimit të makinës dhe sigurimi për përgjegjësinë e punëdhënësit dhe për kompensimin e punëtorëve, të cilat duhet të jenë të paktën në përputhje me ligjet vendase). Kjo normativë minimale zbatohet edhe për Filialet e kompanive të sigurimit të KONTRAKTORIT dhe/ose për kërkesat për vetësigurim.
- 14.7 Në masën e lejuar me ligj, Filialet e kompanive të sigurimit të KONTRAKTORIT mund të marrin pjesë në sigurimet e blera nga KONTRAKTORI, me kusht që këto Filiale të përmbushin Standardet Minimale Financiare, të përmendura më sipër.



NENI 15
DOKUMENTACIONI, RAPORTET DHE INSPEKTIMI

- 15.1 KONTRAKTORI do të përgatitë dhe do të mbajë në çdo kohë gjatë së cilës kjo Kontratë është në Fuqi, dokumentacion të saktë dhe të përditësuar të Operacioneve të tij Hidrokarbure sipas kësaj Kontrate. KONTRAKTORI do t'i japë AKBN-së apo përfaqësuesve të saj të gjithë informacionin dhe të dhënat në lidhje me Operacionet të Hidrokarbure në Shqipëri, në kuadrin e kësaj Kontrate.
- 15.2 Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga AKBN-ja, në rast të eksportimit të ndonjë kampioni shkëmbor jashtë Shqipërisë për analiza, kampione ekuivalente në përmasa dhe cilësi do të mbahen nga KONTRAKTORI në Shqipëri.
- 15.3 Regjistrimet origjinale të të dhënave teknike mund të eksportohet nga KONTRAKTORI për analiza jashtë; megjithatë, me kusht që shiritat manjetikë dhe çdo e dhënë tjetër që duhet të përpunohet apo analizohet jashtë Shqipërisë mund të eksportohet nëse një monitor apo një regjistrim i ngjashëm mbahet në Shqipëri nga KONTRAKTORI.
- 15.4 KONTRAKTORI do t'i lejojë AKBN-së, nëpërmjet përfaqësuesve apo punonjësve të vet të autorizuar në mënyrë të rregullt, të kenë të drejtë të plotë hyrjeje në Zonën e Kontratës, në çdo kohë të arsyeshme, me të drejtën të vëzhgojnë operacionet që po kryhen dhe të inspektojnë dokumentacionin dhe të dhënat e mbajtura nga KONTRAKTORI. Përfaqësuesit e AKBN-së, në ushtrimin e kësaj të drejte, në kuadër të fjalisë së mësipërme të këtij Neni 15.4, do të kujdesen që të mos krijojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure.
- 15.5 KONTRAKTORI do t'i japë AKBN-së kopje të përditësuara të dokumentacionit teknik (duke përfshirë pa kufizim, shiritat fushorë sizmik, raportet gjeologjike e gjeofizike, karrotazhet dhe rilevimet e puseve, si dhe informacione e interpretime të tyre), që KONTRAKTORI ka në dispozicion, duke përfshirë testet e kampioneve, që lidhen me Operacionet Hidrokarbure në kuadër të kësaj Kontrate. Të gjitha këto të dhëna konsiderohen rreptësishtë konfidenciale dhe nuk do të nxirren as nga AKBN-ja, përveçse tek autoritetet e tjera Qeveritare, pa miratimin e KONTRAKTORIT, dhe as nga KONTRAKTORI, përveçse te Filialet e Kompanisë së tij, konsulentët profesionistë, te bankat apo institucionet financiare nga të cilët KONTRAKTORI apo çdo subjekt që përbën KONTRAKTORIN, kërkojnë apo marrin financim dhe te palët e treta që mund të jenë të interesuara për të blerë pjesëmarrje në këtë Kontratë (me kusht, gjithmonë, që këto Filiale të Kompanisë, këta konsulentë, banka, institucione financiare dhe palë të treta t'i nënshtrohen detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit) ose te çdo bursë, nëse kërkohet, në të cilën kuotohen aksionet e KONTRAKTORIT, të çdo subjekti që përbën KONTRAKTORIN apo të ndonjë Filiali të Kompanisë të KONTRAKTORIT, duke njoftuar paraprakisht AKBN-në, gjatë gjithë kohës që kjo Kontratë është në fuqi. Nëse kjo Kontratë zgjidhet gjatë Periudhës së Parë të Kërkimit apo gjatë çdo Periudhe Kërkimi në vijim, KONTRAKTORI është i detyruar që të gjitha informacionet dhe të dhënat që disponon të mos i nxjerrë, përveçse te Filialet e tij, dhe t'i ruajë për të paktën 5 (pesë) vjet nga zgjidhja e kësaj Kontrate. Detyrimi i konfidencialitetit i AKBN-së nuk përfshin të dhënat për zonat nga të cilat KONTRAKTORI ka hequr dorë, të dhënat të cilat mund t'u jepen palëve të treta, me kusht që marrësit e këtyre të dhënave të bien dakord t'i përdorin ato vetëm për të



vlerësuar mundësinë e lidhjes së Kontratës për ato zona me AKBN-në, dhe të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave.

NENI 16

TË DREJTAT E PUNËSIMIT DHE TRAJNIMI I PERSONELIT SHQIPTAR

- 16.1 Është dëshirë e Palëve që Operacionet Hidrokarbure, në kuadër të kësaj Kontrate, të kryhen me profesionalizëm dhe efikasitet; për këtë qëllim, AKBN ofron mbështetjen e saj, në mënyrë që:
- 16.1.1 Personeli i huaj administrativ, profesionist dhe teknik i punësuar nga KONTRAKTORI, si dhe personeli i nënkontraktorëve të tij të angazhuar në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kësaj Kontratë, të pajiset me leje qëndrimi dhe leje pune për të punuar në Shqipëri.
- 16.1.2 Personeli i huaj administrativ, profesionist dhe teknik i punësuar nga KONTRAKTORI, do të paguhet për shërbimet e tij në përputhje me politikat e KONTRAKTORIT të zbatueshme për personelin në fjalë, që do të jenë në përputhje me Praktikat Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure, si dhe me kriteret ligjore të kuadrit ligjor shqiptar.
- 16.2 KONTRAKTORI është i lirë të zgjedhë punonjësit e tij dhe të përcaktojë numrin e tyre, për t'i përdorur në Operacionet Hidrokarbure në kuadër të kësaj Kontrate, në përputhje me Praktikat Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure. Pa cenuar sa më sipër, bihet dakord që:
- 16.2.1 Duke marrë parasysh kërkesat operacionale të KONTRAKTORIT sipas kësaj Kontrate, KONTRAKTORI të punësojë personel shqiptar nëse aftësitë e tyre profesionale, ekspertiza dhe përvoja përmbushin kërkesat e tij. KONTRAKTORI do të sigurojë në mënyrë të arsyeshme që nënkontraktorët e tij të ndjekin këtë procedurë.
- 16.2.2 Gjatë Prodhimit, KONTRAKTORI do të zëvendësojë gradualisht personelin e huaj jo ekzekutiv, me personel të kualifikuar shqiptar, sipas disponueshmërisë.
- 16.2.3 Në qoftë se, në përputhje me ligjin e zbatueshëm shqiptar, KONTRAKTORIT i kërkohet që të mbajë pagesën e tatimeve, të sigurimeve shoqërore, dhe/ose të sigurimeve shëndetësore nga pagat e punonjësve shqiptarë ose nënkontraktorëve ose të kryejë të gjitha ose disa nga pagesat e sigurimeve shoqërore apo shëndetësore për punonjësit e tij shqiptarë, KONTRAKTORI do t'i plotësojë këto kërkesa dhe, sipas rastit, do t'i derdhë këto taksa dhe pagesa tek autoritetet përkatëse të Qeverisë Shqiptare.
- 16.3 KONTRAKTORI do të përgatisë dhe realizojë programe trajnimi për punonjësit e tij shqiptarë të angazhuar në Operacionet Hidrokarbure në kuadër të kësaj Kontrate, lidhur me aspekte të caktuara të industrisë Hidrokarbure.



- 16.4 Të gjitha kostot dhe shpenzimet që i shkaktohen KONTRAKTORIT në lidhje me programet e trajnimit të punonjësve shqiptarë, do të mbulohen nga KONTRAKTORI në përputhje me Nenin 7 të kësaj Kontrate, si Shpenzime Kërkimi.

NENI 17
KONTRAKTIMI, KONTRAKTORËT VENDAS DHE MATERIALET E
PRODHUARA NË VEND

KONTRAKTORI dhe nënkontraktorët e tij:

- 17.1 Do t'u japin përparësi kontraktorëve vendas, për sa kohë që çmimet, cilësia dhe disponueshmëria e shërbimeve të tyre janë të krahasueshme me çmimet dhe shërbimet ndërkombëtare.
- 17.2 Do t'u japin përparësi materialeve, pajisjeve, makinerive dhe mallrave të konsumit të prodhuara në vend, për sa kohë që çmimi, cilësia dhe koha e lëvrimit të tyre janë të krahasueshme me materialet, pajisjet, makineritë dhe mallrat e konsumit të disponueshme në tregun ndërkombëtar. Për qëllime të krahasimit të çmimeve, kostoja e artikujve të importuar do të përjashtojë detyrimet doganore, por do të përfshijë kostot e transportit dhe të sigurimit.
- 17.3 Do të hapë procedura përzgjedhëse të prokurimit për çdo Kontratë për mallra që mund të prodhohen në vend dhe me vlerë të parashikuar mbi dy milion dollarë amerikanë (2 000 000 USD). Për të gjitha rastet e tjera zbatohen politikat e prokurimit të Operatorit.

NENI 18
LIGJET DHE RREGULLORET

- 18.1 Kjo Kontratë rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret shqiptare (veçanërisht nga Legjislacioni për Hidrokarburet dhe Legjislacioni Fiskal për Hidrokarburet). KONTRAKTORI u nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme dhe që janë në fuqi në Shqipëri, të përcaktuara në këtë Nen 18.
- 18.2 Të drejtat dhe detyrimet e AKBN-së dhe KONTRAKTORIT sipas kësaj Kontrate dhe për kohën që kjo Kontratë është në fuqi, do të rregullohen nga dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe mund të ndryshohen apo amendohen vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim mes Palëve.
- 18.3 Nënkontraktorët e KONTRAKTORIT u nënshtrohen dispozitave të kësaj Kontrate të zbatueshme për ta, si dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme dhe në fuqi, me ndryshimet e tyre të herë pas hershme.
- 18.4 Në rast se ndonjë dispozitë, ndryshim apo amendament i ri i ligjeve apo rregulloreve shqiptare apo ndonjë ndryshim në interpretimin e tyre, i vendos KONTRAKTORIT detyrime, tatime, të drejta, pagesa apo detyrime të tjera të reja, për sa u përket atyre që shprehimisht konsiderohen të zbatueshme për KONTRAKTORIN ose nënkontraktorët e tij sipas kushteve të kësaj Kontrate, dhe që sipas gjykimit të KONTRAKTORIT kanë ndikim negativ për të, duke përfshirë përfitimin e pritshëm ekonomik sipas kësaj Kontrate prej Datës së Hyrjes së saj në Fuqi, Palët do të ndryshojnë këtë Kontratë me kërkesë të KONTRAKTORIT dhe do të ndërmarrin çdo veprim tjetër të përshtatshëm



ose të nevojshëm për të ruajtur përfitimin e përgjithshëm ekonomik të KONTRAKTORIT.

- 18.5 Nëse natyra e dispozitave, ndryshimeve, amendamenteve të reja apo interpretimi i përmendur më sipër, e bëjnë të pamundur praktikisht modifikimin e përqindjeve të ndarjes së fitimit, të përmendura në Nenin 7.6, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të bien dakord për ndonjë metodë tjetër për të kompensuar KONTRAKTORIN për barrën shtesë të ngarkuar mbi KONTRAKTORIN, me kusht që kjo metodë alternative të ruajë ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate, sikur të mos kishin ndodhur këto ndryshime apo amendamente.
- 18.6 Për të vendosur mbi rregullimin e përqindjes së ndarjes së fitimit apo metodën alternative për të kompensuar KONTRAKTORIN, siç përmendet më sipër, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të takohen brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data në të cilën janë bërë ndryshimet apo amendamentet dhe çdo përshtatje e përqindjes së ndarjes së fitimit, të përcaktuar në Nenin 7.6 apo metoda alternative e kompensimit të KONTRAKTORIT do të ketë fuqi prapavepruese duke filluar nga data e ngjarjes që ka sjellë përshtatjen.

NENI 19

TRANSFERIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE

- 19.1 KONTRAKTORI ose subjektet që përbëjnë KONTRAKTORIN nuk mund të shesin, kalojnë apo t'i transferojnë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë personi, firmë apo kompanie që nuk është Palë në këtë Kontratë, as tërësisht dhe as pjesërisht, interesin e vet të pjesëmarrjes apo të drejta, privilegje, detyra apo detyrime tjera sipas kësaj Kontrate, pa miratimin me shkrim të AKBN-së, përveçse të një Filial i Kompanisë. Nëse AKBN nuk përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kërkesës për sa më sipër, do të konsiderohet se ka dhënë miratimin e heshtur.
- 19.2 KONTRAKTORI ose ndonjë subjekt që përbën KONTRAKTORIN është i lirë të shesë, kalojë apo transferojë në ndonjë mënyrë tjetër qoftë të gjithin apo një pjesë të interesit të tij sipas kësaj Kontrate, të një Filial i Kompanisë dhe të njoftojë AKBN-në për këtë.
- 19.3 Në çdo transferim të tillë, Pala transferuese duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të mbrojtur interesat e Palëve të tjera.
- 19.4 Në raste të ndryshme nga sa më sipër ku nuk nevojitet miratim, kur KONTRAKTORI ose çdo subjekt që përbën KONTRAKTORIN, dëshirojnë të shesin, kalojnë apo përndryshe të transferojnë tërësisht apo pjesërisht interesin e vet sipas kësaj Kontrate, miratimi me shkrim i Palës tjetër nuk do të bllokohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo shitje, kalim apo transferim tjetër i supozuar, për të cilin nuk jepet miratimi si më sipër, do të konsiderohet e pavlefshme.
- 19.5 Çdo transferim sipas dispozitave të këtij Neni përjashtohet nga tatimet mbi të ardhurat, transferimin apo nga detyrime dhe pagesa lidhur me to. Instrumenti i transferimit duhet të përmbajë dispozita që përcaktojnë saktësisht që përfituesi i transferimit t'u nënshtrohet të gjitha kushteve që përmban kjo Kontratë dhe çdo modifikim apo shtesë e saj që është bërë deri në atë moment. Në ato raste kur kërkohet miratimi i AKBN-së,



kësaj të fundit i paraqitet një draft i instrumenteve të transferimit për shqyrtim dhe miratim, përpara nënshkrimit zyrtar të tyre. Nëse AKBN nuk përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e instrumenteve të transferimit, do të konsiderohet se ka dhënë miratimin e saj të heshtur.

NENI 20 FORCA MADHORE

- 20.1 “**Forca Madhore**” është një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur, që njëkohësisht pengon dhe vonon këtë Palë të prekur të përmbushë të gjitha apo një pjesë të detyrimeve të saj që burojnë nga kjo Kontratë (me përjashtim të pagesave me para në dorë). Ngjarja e Forcës Madhore është një ngjarje absolutisht dhe objektivisht e pamundur për t'u parandaluar apo për t'u shmangur nga Pala e prekur;

Ngjarja e Forcës Madhore është një ngjarje që nuk ka ardhur si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Pala e prekur.

- 20.2. Për qëllime të kësaj Kontrate, Forca Madhore përfshin pa kufizim ngjarjet e mëposhtme:

- i. rrethanat e shkaktuara nga kushte jashtëzakonisht të këqija të motit dhe fatkeqësi natyrore, duke përfshirë epidemitë, stuhitë e fuqishme, tërmetet, përmytjet, zjarrin, ciklonet/uraganet/tajfunet/tornadot/stuhitë e emërtuara, bllokimet nga bora, bora, breshërin, ngrirjen e detit, kanaleve, porteve, rrufetë, thatësitrat, rrëshqitjet e tokës, baticat, shpërthimet dhe/ose fatkeqësi të tjera natyrore;
- ii. lufta (e shpallur ose jo), kërcënime lufte, konflikti i armatosur ose kanosje serioze për një konflikt të tillë, sulmet armiqësore, bllokadat, embargot ushtarake, mobilizimi i përgjithshëm ushtarak, veprime ushtarake, akte të armiqve publikë, trazira, sabotazhi, pirateria, rebelimet, kryengritjet, grevat, lufta, Pushtimet, aktet e terrorizmit, lufta civile, revolucionet, kryengritjet ushtarake ose uzurpimi i Pushtetit;
- iii. grevat në nivel kombëtar apo rajonal, ose mosmarrëveshjet industriale në nivel kombëtar apo rajonal, ose grevat apo mosmarrëveshjet industriale të forcës punëtore që nuk është e punësuar nga Pala e prekur, nga nënkontraktorët apo nga furnizuesit e saj dhe që ndikojnë në realizimin e Kontratës, shpronësimi, shpërngulja me forcë, pushtimi, rekuizicioni, demonstratat publike;
- iv. fatkeqësitë detare ose ajrore, akte të paligjshme të palëve të treta, zjarret, shpërthimet, ndërprerja e tejzgjatur e shërbimit të transportit publik, e rregulluar nga vendimet dhe rezolutat e autoriteteve publike, mbyllja e rrugëve detare, embargot, ndalimi (kufizimi) i transaksioneve të eksportit/importit, etj.;
- v. Urdhrat ose ligjet e një organi shtetëror që ka juridiksion për të ndaluar, për të vonuar dhe/ose për të penguar realizimin e Kontratës;
- vi. Mohimi, revokimi ose mosmarrja e licencave, lejeve ose miratimeve të nevojshme, me kusht që kjo pamundësi të mos jetë për faj (ose pakujdesi) të Palës që kërkon lehtësim nga realizimi i Kontratës.

- 20.3. Në rrethana të Forcës Madhore, Pala e prekur duhet të njoftojë Palën tjetër brenda tridhjetë (30) ditësh për arsyet e vonesës së përmbushjes së detyrimeve, për të gjetur një mënyrë për të zbutur efektet e forcës madhore dhe për të vazhduar Kontratën.



Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të përdoren si shkak për pretendime për dëmshpërblim ose për përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Kufijtë për përmbushjen e detyrimeve do të vendosen me marrëveshje mes Palëve.

20.4 Pasojat e Forcës Madhore në Kontratë

Me fillimin e ngjarjes së Forcës Madhore, detyrimet e Palës së prekur pezullohen për të gjithë kohëzgjatjen e ngjarjes së Forcës Madhore. Kjo periudhë kohe i shtohet Periudhës së Parë të Kërkimit, Periudhës së Dytë të Kërkimit, Periudhës së Tretë të Kërkimit, Periudhës së Vlerësimit (sipas rastit) dhe çdo Periudhe Zhvillimi dhe Prodhimi, bashkë me Periudhën kohore të nevojshme për rikthimin e Operacioneve Hidrokarbure në gjendjen që ishin në momentin që filloi ngjarja e Forcës Madhore.

KONTRAKTORI i prekur nga Forca Madhore ka të drejtë të zgjidhë Kontratën:

- i. Në rast se pas zbatimit të pikës 20.2 të këtij Neni, nuk është gjetur një zgjidhje në favor të projektit.
- ii. Kur Forca Madhore zgjat më shumë se 6 muaj.

KONTRAKTORI gëzon të drejtën të zgjidhë këtë Kontratë duke i dhënë AKBN-së njoftim me shkrim tridhjetë (30) Ditë para, dhe kështu ai shkarkohet nga të gjitha detyrimet që ka sipas kësaj Kontrate.

20.5. Pasojat e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës Madhore

Në rastin e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës Madhore, Palët nuk kanë asnjë detyrim apo përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit, dhe secila nga Palët mbulon Kostot e veta.

NENI 21

MOSMARRËVESHJET DHE ARBITRAZHI

21.1 Zgjidhja me mirëkuptim

21.1.1 Çdo ankesë, kundërshti apo mosmarrëveshje (në vijim referuar si “mosmarrëveshja”) midis Republikës së Shqipërisë dhe KONTRAKTORIT, që lind ose ka lidhje me këtë Kontratë ose me Operacionet apo aktivitetet e kryera sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me formulimin, vlefshmërinë, interpretimin, zbatueshmërinë, shkeljen, zgjidhjen ose zbatimin e dispozitave të kësaj Kontrate, Palët fillimisht do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim, përmes negociatave, që nuk do të zgjasin më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë pasi njëra nga Palët të ketë marrë njoftimin me shkrim të Palës tjetër lidhur me këtë mosmarrëveshje.

21.1.2 Nëse ndonjë mosmarrëveshje që i nënshtrohet negociatave, sipas këtij Neni, nuk arrin të zgjidhet brenda Periudhës së përcaktuar, atëherë secila prej Palëve mund të propozojë, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër, që mosmarrëveshja t'i paraqitet ose një ekspertit, në përputhje me Nenin 21.2, ose arbitrazhit, në përputhje me Nenin 21.3.

21.2 Vendimi i Ekspertit



Përveç nga sa parashikohet në Nenin 7.13, çdo çështje në mosmarrëveshje mes AKBN-së dhe KONTRAKTORIT, që në kuadër të kësaj Kontrate duhet t'i paraqitet një Eksperti, do t'i kalohet për vendim një eksperti të vetëm. Ekspertit do t'i jepen termat e referencës, për të cilat do të bihet dakord bashkërisht mes Palëve. Eksperti caktohet me marrëveshje të përbashkët mes AKBN-së dhe KONTRAKTORIT. Nëse AKBN-ja dhe KONTRAKTORI nuk arrijnë të caktojnë një ekspert brenda tridhjetë (30) Ditëve pasi është arritur marrëveshja për termat e referencës, secila nga Palët mund të depozitojë kërkesë në Qendrën e Ekspertizës Teknike të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në Paris, Francë, për caktimin e një eksperti në përputhje me rregullat e saj. Eksperti e jep vendimin e tij në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe në bazë të provave më të mira shkresore që ka në dispozicion. Përfaqësuesit e AKBN-së dhe të KONTRAKTORIT kanë të drejtën të konsultohen me Ekspertin dhe t'i vënë atij në dispozicion të dhëna dhe informacione, duke mbajtur parasysh që Eksperti mund të vendosë kufizime të arsyeshme për këtë të drejtë. Këto të dhëna dhe informacione duhet t'i jepen njëkohësisht edhe Palës tjetër në mosmarrëveshje. Eksperti është i lirë të vlerësojë se sa thelbësore apo e rëndësishme është çdo e dhënë, informacion apo provë tjetër. Tarifa dhe shpenzimet e Ekspertit dhe Kostot për emërimin e tij, në qoftë se ka, të bëra nga Qendra e Ekspertizës Teknike e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, do të mbulohen në masë të barabartë nga AKBN-ja dhe KONTRAKTORI. Vendimi i Ekspertit do të jetë detyrues për Palët dhe i formës së prerë, me përjashtim të rastit kur ka gabime në vendim.

21.3 Arbitrazhi

- 21.3.1 Çdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim që lind ose ka lidhje me këtë Kontratë ose me Operacionet e kryera në kuadër të saj, duke përfshirë pa kufizim çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, formulimin, zbatueshmërinë, interpretimin, shkeljen ose zgjidhjen e kësaj Kontrate, dhe që nuk arrin të zgjidhet me mirëkuptim mes Palëve brenda Periudhës së përcaktuar në Nenin 21.1 më sipër, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht nga arbitrazhi, sipas Rregullave të LCIA, të cilat konsiderohen si të përfshira përmes referencës në këtë klauzolë.
- 21.3.2 Numri i arbitrave do të jetë tre (3). Pala që hap procesin e arbitrazhit emëron një arbitër dhe Pala mbrojtëse emëron arbitrin tjetër, dhe në rast se kjo Palë nuk e emëron arbitrin brenda tridhjetë (30) Ditësh, Pala që ka hapur procesin e arbitrazhit mund t'i kërkojë autoritetit emërues të emërojë arbitrin e dytë në përputhje me rregullat. Më pas, dy (2) arbitrat zgjedhin arbitrin e tretë, i cili do të veprojë si arbitri kryesues i trupit gjykues.
- 21.3.3 Arbitrazhi do të zhvillohet në Zyrih (Zvicër). Gjuha e përdorur për procesin e arbitrazhit është gjuha angleze.
- 21.3.4 Vendimi i arbitrazhit është i formës së prerë dhe detyrues për Palët dhe hyn në Fuqi menjëherë.
- 21.3.5 Me anë të një kërkesë drejtuar arbitrazhit, secilës nga Palët i lind e drejta të aplikojë për pezullimin e dispozitave të Kontratës që kanë lidhje me objektin e



mosmarrëveshjes, por pa u pezulluar gjithë pjesa tjetër e të drejtave dhe detyrimeve të Palëve.

- 21.3.6 Për çdo mosmarrëveshje që lind mes Palëve, AKBN, duke vepruar në emër të Qeverisë Shqiptare, heq dorë shprehimisht dhe në mënyrë të pakthyeshme nga e drejta për të pretenduar imunitetin e sovranit, qoftë në lidhje me veten apo me asetet e saj, duke përfshirë pa asnjë lloj kufizimi, të drejtën e imunitetit sovran për hapje procesi gjyqësor, juridiksion, padi, vendim, pretendim për kompensim, kundërpadi, sekuestro, ekzekutim qoftë si rezultat i një arbitrazhi, procesi gjyqësor, vendimi ekspertit apo ndërmjetësimi, apo si rezultat i çdo mënyre tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Asetet janë pasuri të çfarëdolloj natyre, të trupëzuara ose të patrupëzuara, dhe kudo që ndodhen, pavarësisht përdorimit apo përdorimit të synuar të tyre, duke përfshirë pa kufizim pasurinë që nuk përdoret vetëm për qëllime tregtare. Për të shmangur dyshimet, heqja dorë në mënyrë të pakthyeshme, e përmendur në këtë Nen, përfshin pa kufizim heqjen dorë nga e drejta e imunitetit sovran qoftë në lidhje me vendimet e ndërmjetme, ashtu edhe në lidhje me ekzekutimin e çdo vendimi gjykate apo vendimi arbitrazhi. AKBN-ja pranon shprehimisht se të drejtat dhe detyrimet e saj në kuadër të kësaj Kontrate janë me natyrë tregtare dhe jo shtetërore.

NENI 22

TUBACIONET DHE OBJEKTET E TJERA

- 22.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo zgjatje të saj, KONTRAKTORI gëzon të drejtën të shfrytëzojë plotësisht Zonën e Kontratës dhe çdo zonë tjetër të miratuar nga AKBN-ja, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të siguruara apo të marra nga KONTRAKTORI për Operacionet Hidrokarbure.
- 22.2 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo zgjatje të saj, KONTRAKTORI do të ketë të drejtën, për qëllimin e transportit të Hidrokarbureve brenda Zonës së Kontratës apo nga Zona e Kontratës në pikën e eksportit apo ndonjë pikë tjetër lëvrimi të rënë dakord nga AKBN-ja dhe KONTRAKTORI, të ndërtojë dhe përdorë çdo tubacion dhe objekt në lidhje me to, si dhe ambiente të tjera të transportit dhe/ose terminalit brenda apo jashtë Zonës së Kontratës, në përputhje me një Program Pune dhe Buxhet Zhvillimi të miratuar. Ndërtimi i çdo objekti jashtë Zonës së Kontratës nuk do duhet të ndërhyjë në mënyrë të paarsyeshme në Operacionet e AKBN-së apo të palëve të treta, duhet të bëhet në koordinim me AKBN-në dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me politikën e zhvillimit të miratuar nga Qeveria Shqiptare apo autoritete të tjera kompetente Shqiptare.
- 22.3 Nëse KONTRAKTORI dëshiron të përdorë ndonjë tubacion, objekte transporti e terminali që janë në dispozicion të AKBN-së dhe që nuk nevojiten për Operacione të tjera Hidrokarbure, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI takohen dhe bien dakord për kushte të kënaqshme për të dyja Palët lidhur me përdorimin e tyre, bazuar në një tarifë të arsyeshme ekonomike.



- 22.4 Të gjitha pagesat e bëra nga KONTRAKTORI për një përdorim të tillë do të mbulohen si Shpenzime Operative, sipas Nenit 7.

NENI 23

E DREJTA E PRONËSISË MBI PASURITË DHE BRAKTISJA

- 23.1 Pas mbarimit të afatit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate sipas Nenit 24, e drejta e pronësisë mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të marra dhe të zotëruara nga KONTRAKTORI për qëllimet e Operacioneve Hidrokarbure i transferohet automatikisht AKBN-së, përveç rasteve kur KONTRAKTORI do t'i përdorë ato për qëllime të Operacioneve Hidrokarbure në zona të tjera në Shqipëri.
- 23.2 E drejta e pronësisë mbi pasuritë që nuk janë objekt i mbulimit të kostove nga KONTRAKTORI apo që janë importuar në Shqipëri nga personeli i huaj i KONTRAKTORIT apo nga nënkontraktorët e KONTRAKTORIT nuk do t'i transferohet AKBN-së dhe artikujt në fjalë, sipas zgjedhjes së zotëruesit të tyre, mund të shiten në Shqipëri sipas Nenit 12.5 ose të eksportohen lirisht.
- 23.3 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo zgjatje të saj, KONTRAKTORI gëzon të drejtën ekskluzive për të përdorur lirisht në Shqipëri të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të siguruara apo të marra për Operacionet Hidrokarbure, pavarësisht nëse është mbuluar apo jo kostoja e tyre nga KONTRAKTORI.
- 23.4 KONTRAKTORI, me kërkesën e AKBN-së, do të heqë çdo instalim apo strukturë të ndërtuar prej tij për qëllime të kësaj Kontrate dhe që janë braktisur apo nuk përdoren më dhe të cilat nuk ka gjasa të përdoren në të ardhmen, gjatë kohëzgjatjes apo pas zgjidhjes së kësaj Kontrate.
- 23.5 Në përputhje me kushtet e saj, detyrimet e lartpërmendura të heqjes dhe të braktisjes do t'i nënshtrohen dhe do të përcaktohen në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
- (i) KONTRAKTORI, në konsultim me AKBN-në, do të përgatisë dhe dorëzojë në kohë të AKBN-ja një plan braktisjeje (në vijim referuar si "Plani i Braktisjes"), duke përfshirë një përshkrim të detajuar teknik dhe inxhinierik të masave për heqjen dhe braktisjen, në përputhje me detyrimet e lartpërmendura, që ai dëshiron të marrë pas kryerjes së Testimit, Vlerësimit apo Prodhimit nga Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit;
 - (ii) Jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë përpara datës së përmendur në pikën (iii) më poshtë, KONTRAKTORI do t'i dorëzojë AKBN-së për miratim një buxhet të detajuar (në vijim referuar si "Buxheti i Braktisjes"), duke detajuar Koston e parashikuar për Planin e Braktisjes.
 - (iii) Dhjetë (10) vjet përpara Datës së parashikuar të përfundimit të Operacioneve të Prodhimit ose në fund të Tremujorit në të cilin prodhimi kumulativ arrin shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të sasisë së Hidrokarbureve të parashikuar për t'u nxjerrë, cilado të ndodhë më parë, në librat e llogarive do të shtohet një vlerë e barasvlershme me Buxhetin e Braktisjes (në vijim referuar si "Llogaria e Kostove të Braktisjes"), e cila do të përdoret për të mbuluar



Kostot e Braktisjes. Kjo shumë do të mbulohet nga KONTRAKTORI në përputhje me Nenin 7, për qëllimet e të cilit shuma do të përpjesëtohet në bazë të njësisë së prodhimit gjatë nxjerrjes së mbetur të parashikuar të Hidrokarbureve nga Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit.

- (iv) Në përvjetorin e parë të datës së përmendur në pikën (iii) më lart, dhe më pas çdo vit, Palët do të takohen për të rivlerësuar Buxhetin e parashikuar të Braktisjes dhe, nëse është e nevojshme, do të rishikojnë këtë Buxhet, rast në të cilin ato do të bien dakord edhe për ndonjë përshtatje të mëpasshme që duhet t'i bëhet shumës që do të përfshihet në Llogarinë e Kostove të Braktisjes.
- (v) Jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë përpara datës së parashikuar të përfundimit të Operacioneve Hidrokarbure në lidhje me të gjitha ose një pjesë të Zonave të Zhvillimit dhe Prodhimit, KONTRAKTORI do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë AKBN-së një Plan përfundimtar për Braktisjen me këto rishikime, në përputhje me detyrimet e lartpërmendura të KONTRAKTORIT. Brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga miratimi i Planit të Braktisjes në fjalë, KONTRAKTORI përgatit dhe i dorëzon AKBN-së Buxhetin përfundimtar për Braktisjen. Nëse gjendja në Llogarinë e Kostove të Braktisjes (në vijim referuar si "Gjendja e Kostove") nuk është e mjaftueshme për të plotësuar Buxhetin e lartpërmendur të Braktisjes, në Llogarinë e Kostove të Braktisjes do të regjistrohet një shumë e nevojshme për të plotësuar Buxhetin e Braktisjes, e cila do të mbulohet nga KONTRAKTORI në përputhje me Nenin 7. AKBN e miraton Planin e Braktisjes dhe Buxhetin e Braktisjes brenda tridhjetë (30) ditëve nga dorëzimi i tyre dhe, në mungesë të një përgjigjeje nga AKBN, Plani i Braktisjes dhe Buxheti i Braktisjes do të konsiderohen të miratuara.
- (vi) KONTRAKTORI do të kryejë me kujdes operacionet e heqjes dhe braktisjes që specifikohen në Planin e Braktisjes dhe këto shpenzime do të reduktojnë Llogarinë e Kostos së Braktisjes. Çdo diferencë e mbetur në Llogarinë e Kostos së Braktisjes pas përfundimit të operacioneve dhe e mbuluar në përputhje me Nenin 7 do t'i paguhet AKBN-së brenda tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i operacioneve në fjalë. Nëse Kostoja e Braktisjes nuk mund të mbulohet plotësisht nga KONTRAKTORI, në përputhje me Nenin 7, deficitin e Kostos së Braktisjes do të ndahet në mënyrë të barabartë midis KONTRAKTORIT dhe AKBN-së.

- 23.6 Pa cenuar dispozitat e Neneve 23.4 dhe 23.5, nëse KONTRAKTORI mendon se ka rrethana që nuk e garantojnë vazhdimësinë e Operacioneve Hidrokarbure dhe në konsultim me AKBN-në, ai mund t'i dërgojë në çdo kohë AKBN-së një njoftim me shkrim nëntëdhjetë (90) Ditë përpara në lidhje me qëllimin e tij për të hequr dorë nga të drejtat dhe detyrimet që ka sipas kësaj Kontrate, përveç të drejtave dhe detyrimeve që kanë lindur në periudhën përpara kësaj heqje dore dhe të drejtave e detyrimeve siç përcaktohet në këtë Kontratë, dhe të braktisë zonën e Kontratës në përputhje me planin e braktisjes të paraqitur dhe të miratuar rregullisht nga AKBN-ja, miratim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.



NENI 24
ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 24.1 KONTRAKTORI mund ta zgjidhë këtë Kontratë duke njoftuar AKBN-në me shkrim jo më pak se tridhjetë (30) Ditë përpara, me kusht që zgjidhja të mos e çlirojë KONTRAKTORIN nga ndonjë angazhim i papërbushur apo detyrim tjetër i lindur para kësaj zgjidhjeje. Nëse ndonjëra nga Palët nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë për arsye të ndryshme nga Forca Madhore (duke përfshirë, por pa u kufizuar në dhënien me dijeni dhe me qëllim të informacionit të pasaktë Palës tjetër), Pala tjetër mund t'i dërgojë Palës në fjalë një njoftim me shkrim për ta informuar mbi mospërmbushjen dhe për qëllimin e saj për të zgjidhur Kontratën në fund të afatit prej gjashtë (6) muajsh, përveç rastit kur mospërmbushja në fjalë korrigjohet brenda këtij afati. Megjithatë, Pala përgjegjëse për mospërputhshmërinë mund t'ia paraqesë çështjen arbitrazhit në përputhje me dispozitat e Nenit 21 të kësaj Kontrate, brenda Periudhës në fjalë prej gjashtë (6) muajsh, dhe Kontrata do të vazhdojë të jetë në Fuqi gjatë kohës që nuk është dhënë apo nuk është arritur zgjidhja përfundimtare nga arbitrat. Zgjidhja e Kontratës sipas dispozitave të këtij Neni përjashtohet nga tatimet mbi të ardhurat, mbi transferimin apo nga detyrime dhe pagesa lidhur me to.
- 24.2 Përveç rastit të Forcës Madhore, kjo Kontratë mund të zgjidhet nga AKBN duke i dërguar KONTRAKTORIT një njoftim me shkrim, jo më pak se njëqind e njëzetë (120) Ditë përpara, në rastet e mëposhtme:
- a) Nëse KONTRAKTORI ka kryer në mënyrë të përsëritur një shkelje materiale të detyrave dhe detyrimeve themelore të tij sipas kësaj Kontrate dhe është njoftuar nga AKBN-ja mbi synimin e saj për të zgjidhur Kontratën në përputhje me këtë dispozitë dhe KONTRAKTORI nuk ka arritur të korrigjojë këtë shkelje brenda një periudhe të arsyeshme; ose
 - b) Nëse KONTRAKTORI nuk i përmbahet ndonjë vendimi përfundimtar që rezulton nga një procedurë arbitrazhi sipas Nenit 21 të kësaj Kontrate; ose
 - c) Nëse KONTRAKTORI është shpallur i falimentuar nga një gjykatë kompetente ose, nëse KONTRAKTORI përbëhet nga më shumë se një subjekt, ndonjë prej tyre është deklaruar i falimentuar nga një gjykatë kompetente dhe enti apo entet e tjera nuk kanë marrë veprimet e duhura për të korrigjuar këtë situatë.
- 24.3 Kontrata do të zgjidhet me efekt të menjëhershëm në rastet e mëposhtme:
- a) KONTRAKTORI nuk merr të gjitha hapat e nevojshëm për të nisur zbatimin e Programit Minimal të Punës për Periudhën e Parë të Kërkimit brenda tre (3) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës e përcaktuar në Nenin 4.1.
 - b) KONTRAKTORI nuk vepron në përputhje me Nenin 29.4
 - c) KONTRAKTORI zgjedh të mos vijojë me Periudhën e Dytë apo Periudhën e Tretë të Kërkimit dhe nuk e ka deklaruar Zbulimin në Zonën e Kontratës.
- 24.3 Me zgjidhjen e kësaj Kontrate, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas Kontratës do të marrin fund plotësisht, duke iu nënshtruar dispozitave të mëposhtme:
- 24.3.1 Të respektohen të drejtat dhe detyrimet e Palëve që lindin nga Kontrata përpara kësaj zgjidhjeje.



- 24.3.2 Në rast mospërmbushjeje dhe detyrimi të lindur përpara zgjidhjes së Kontratës nga cilado prej Palëve, që lidhet me ndonjë detyrim të përcaktuar në Kontratë, mospërmbushja apo detyrimi në fjalë duhet të korrigojohet nga Pala në mospërmbushje.
- 24.4 Në rastin e zgjidhjes përpara afatit, në përputhje me Nenet 24.1 ose 24.2, kjo Kontratë përfundon automatikisht në tërësinë e saj, nëse e gjithë Zona e Kontratës është braktisur ose Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit ose çdo zgjatje e saj ka përfunduar në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

NENI 25 **MBROJTJA E MJEDISIT**

- 25.1 Pa cenuar Nenin 5.6, KONTRAKTORI do të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 8934, Datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 8905, Datë 6.6.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”; Ligjin nr. 8990, Datë 23.1.2003, “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ligjin nr. 9115, Datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr. 9010, Datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe Ligjin nr. 9108, Datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe rregullore të tjera për mjedisin që mund të nxirren në vijim; me kusht që çdo ligj apo rregullore e re e nxjerrë për mjedisin ose çdo ndryshim në interpretimin apo zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese për mjedisin që ndodh pas Datës së Hyrjes në Fuqi t'i nënshtrohet Nenit 18.4. Të gjitha referencat për ligjet dhe vendimet e lartpërmendura i referohen ligjeve dhe vendimeve me ndryshimet dhe zëvendësimet e herëpashershme.

KONTRAKTORI do të miratojë masat e pranuar ndërkombëtarisht për shmangur apo minimizuar ndotjen e mjedisit, në mënyrë që kjo ndotje të mos shkaktojë përkeqësim të cilësisë së jetës apo të shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe burimeve vegjetative.

- 25.2 KONTRAKTORI ka përgjegjësinë ekskluzive që të përdorë programe të pranuar ndërkombëtarisht në përpjekje për të eliminuar apo minimizuar ndotjen e mjedisit. Sa herë që KONTRAKTORI nuk ka qenë në gjendje të shmangë ndotjen e mjedisit, do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e arsyeshëm për të kthyer mjedisin e prekur, në masën që është praktikisht e mundur, në kushtet që ka qenë në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe të korrigojë çdo ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis të shkakuar direkt nga operacionet, në masën e kërkuar nga ligjet dhe rregulloret Shqiptare të zbatueshme për industrinë e naftës dhe të gazit dhe në përputhje me Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure.
- 25.3 AKBN-ja mund të inspektojë regjistrat e KONTRAKTORIT lidhur me përputhshmërinë me këtë Nen 25 në çdo kohë të arsyeshme pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe deri në gjashtë (6) muaj pas zgjidhjes së Kontratës.



NENI 26
TEKSTI NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHOJPE

Versionet në gjuhën angleze dhe shqipe të kësaj Kontrate do të kenë të njëjtën vlerë dhe të duhet të referohen në shpjegimin apo interpretimin e kësaj Kontrate; megjithatë, në rast konflikti në shpjegimin apo interpretimin e saj mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

NENI 27
PAGESAT E BONUSIT TË NËNSHKRIMIT, PRODHIMIT DHE TRAJNIMIT

- 27.1 KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së, vetëm një herë, një bonus nënshkrimi në vlerën totale prej një milionë e pesëqind mijë dollarë amerikanë (1 500 000 USD) brenda tridhjetë (30) ditëve pas publikimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që miraton këtë Kontratë.
- 27.2 KONTRAKTORI do t'i paguajë Bonuset e Prodhimit si më poshtë:
- a) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas Datës së Prodhimit të Parë Tregtar, KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së, vetëm një herë, një Bonus Prodhimi prej dyqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë (250 000 USD).
 - b) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës në të cilën Prodhimi mesatar Ditor i Naftës Bruto nga Zona e Kontratës, gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) Ditësh të njëpasnjëshme, arrin pesëmbëdhjetë mijë (15 000) fuçi naftë në ditë, KONTRAKTORI i paguan AKBN-së, vetëm një herë, një Bonus Prodhimi prej shtatëqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë (750 000 USD).
 - c) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës në të cilën Prodhimi mesatar Ditor i Naftës Bruto nga Zona e Kontratës gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh të njëpasnjëshme arrin tridhjetë mijë (30 000) fuçi naftë në ditë, KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së një Bonus Prodhimi, vetëm një herë, prej një milion e pesëqind mijë dollarë amerikanë (1 500 000 USD).
- 27.3 KONTRAKTORI do t'i paguajë AKBN-së një bonus trajnimi dhe administrativ në shumën treqind mijë dollarë amerikanë (300 000 USD) për çdo vit kontraktual të Periudhës së Kërkimit. Bonusi i trajnimit dhe administrativ do të përdoret për:
- a) Blerjen, për AKBN-në, të literaturës teknike të avancuar, të të dhënave, softuerit, harduerit dhe pajisjeve teknike apo shërbimeve specifike sipas kërkesës së AKBN-së;
 - b) Dërgimin e punonjësve të AKBN-së në kurse të zgjedhura në fushën e shkencave të Hidrokarbureve, inxhinierisë, financave dhe menaxhimit etj.; dhe
 - c) Mbulimin nga AKBN-ja të disa shpenzimeve administrative në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate, si dhe të shpenzimeve të tjera.



- 27.3.1 KONTRAKTORI do ta paguajë bonusin e trajnimit dhe administrativ tridhjetë (30) ditë përpara fillimit të çdo Viti Kontraktual të Periudhës së Kërkimit. Në rast se këto periudha nuk fillojnë që në fillim ose nëse nuk përfundojnë në fund të një Viti Kontraktual të plotë, kjo shumë do të përllogaritet proporcionalisht.

NENI 28
MIRATIMI NGA QEVERIA DHE DATA E HYRJES NË FUQI

Kjo Kontratë do të jetë detyruese për Palët duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi. AKBN-ja do t'i japë KONTRAKTORIT një kopje të dokumentit që vërteton miratimin e kësaj Kontrate nga Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, brenda dhjetë (10) Ditësh Pune nga data e botimit të këtij vendimi në "Fletoren Zyrtare".

NENI 29
TË NDRYSHME

- 29.1 Përveç nga sa parashikohet në Nenin 9, përgjegjësitë dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate të subjekteve që përbëjnë KONTRAKTORIN janë kolektive dhe individuale.
- 29.2 Mosushtrimi nga ndonjë Palë i ndonjë të drejte sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet heqje dorë nga ajo e drejtë.
- 29.3 Sipas Nenit 14.5 dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate, KONTRAKTORI do të kompensojë Qeverinë Shqiptare, Ministrinë dhe AKBN-në, si dhe Punonjësit, zyrtarët, nëpunësit, drejtorët dhe agjentët respektivë të tyre nga të gjitha pretendimet nga palët e treta për lëndim personal apo dëmtim të pronës që rezulton nga kryerja e Operacioneve Hidrokarbure, pavarësisht nëse ato kryhen nga KONTRAKTORI apo për llogari të tij, duke përfshirë pa kufizim, shpenzimet e arsyeshme për tarifën e avokatit dhe kostot e drejtpërdrejta të mbrojtjes, duke marrë në konsideratë gjithësi se KONTRAKTORI nuk do të jetë përgjegjës sipas këtij Neni 29.3 për asnjë humbje, pretendim, lëndim apo dëmtim të tillë të shkaktuar ose që rezulton nga veprime të pakujdesshme të Qeverisë Shqiptare, AKBN-së, si dhe të punonjësve, zyrtarëve, drejtorëve apo agjentëve përkatës të tyre.
- 29.4 Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga Data e Hyrjes në Fuqi, KONTRAKTORI do të bëjë të mundur që të nënshkruhet dhe do t'i dërgojë AKBN-së një Garanci Bankare për kohëzgjatjen e Periudhës përkatëse të Kërkimit, që përmbush Standardet Minimale Financiare, sipas formatit të dokumentit bashkëngjitur, të përfshirë në këtë Kontratë si Aneksi E.
- Në rast se KONTRAKTORI vendos të hyjë në ndonjë nga Periudhat e mëpasshme të Kërkimit, ai do të nënshkruajë dhe do t'i dorëzojë AKBN-së, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë përpara fillimit të Periudhës përkatëse të Kërkimit, një Garanci Bankare për kohëzgjatjen e Periudhës së Kërkimit në fjalë, me kusht që ajo të përmbushë Standardet Minimale Financiare, sipas formatit bashkëngjitur, të përfshirë në këtë Kontratë si Aneksi E.
- 29.5 Në lidhje me Garancinë Bankare të përmendur në Nenin 29.4 më sipër, AKBN-ja, duke filluar nga tre (3) muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi dhe më pas në intervale mujore ose tremujore, siç do të bihet dakord midis Palëve, do t'i japë



KONTRAKTORIT një situacion me shkrim të shpenzimeve të kryera nga KONTRAKTORI gjatë periudhës tremujore të mbuluar nga ky situacion dhe të pranuar nga AKBN-ja si llogaritje përkundrejt realizimit nga KONTRAKTORI të Programit Minimal të Punës për Periudhën e Parë të Kërkimit dhe, sipas rastit, për Periudhën e Dytë dhe të Tretë të Kërkimit.

Me qëllim reduktimin e Garancisë Bankare në rastin e Shpimit të një Pusi, do të llogaritet vlera e detyrimit financiar për një metër shpim dhe çdo muaj Garancia Bankare do të reduktohet me vlerën përkatëse të metrave të shpimit gjatë atij muaji.

NË DËSHMI TË SA MË LART, kjo Kontratë është nënshkruar ligjërisht nga Palët përkatëse të saj në Datën e përcaktuar më sipër.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË E SHQIPËRISË

Nga: _____

Pozicioni: _____

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.

Nga: R. O. Myji

Pozicioni: _____



Aneksi A
Përshkrimi i Zonës së Kontratës

Zona e Kontratës që mbulohet dhe preket nga kjo Kontratë përfshin, në Datën e Hyrjes në Fuqi, zonën e rrethuar nga linjat e mëposhtme, të paraqitur edhe në hartën që përbën Aneksin B.

Të gjitha koordinatat në sistemin koordinativ gjeografik të Shqipërisë 1987 [4191].

KUFIJTË E BLOKUT 4 NË TOKË NË SHOIPËRI

1	40° 20' 00" N	20° 00' 00" E
2	40° 20' 00" N	20° 15' 00" E
3	40° 30' 00" N	20° 15' 00" E
4	40° 30' 00" N	20° 30' 00" E
5	40° 20' 00" N	20° 30' 00" E
6	40° 09' 10" N	20° 41' 25" E

Kufiri midis pikave 6 dhe 7 ndjek kufirin ndërkombëtar.

7	39° 55' 00" N	20° 20' 50" E
8	39° 55' 00" N	20° 15' 00" E
9	40° 05' 00" N	20° 00' 00" E



Aneksi B
Harta e Zonës së Kontratës





Aneksi C Procedura Kontabël

NENI I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

I bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Kontrate midis Palëve.

Kur në këtë Procedurë Kontabël ka referime për KONTRAKTORIN që lidhen me një të drejtë apo detyrim që lind nga kryerja e Operacioneve Hidrokarbure (duke përfshirë pa kufizim në lidhje me ndonjë regjistër kontabël, pasqyrë, kosto apo auditim), këto referime do t'i atribuohen edhe operatorit si subjekti përgjegjës për kryerjen, për llogari të KONTRAKTORIT, e të gjitha Operacioneve Hidrokarbure sipas Kontratës.

1. Regjistrat Kontabël

1.1 KONTRAKTORI do të mbajë regjistrat kontabël në përputhje me Nenin 13 të Kontratës dhe me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

1.2 KONTRAKTORI do të hartojë dhe mbajë më vete regjistra kontabël të identifikueshëm që mund të jenë të nevojshëm për të regjistruar plotësisht dhe në mënyrën e duhur të gjitha kostot që lidhen me Kontratën dhe të gjitha kreditimet e marra nga KONTRAKTORI në lidhje me Operacionet Hidrokarbure.

1.3 Librat kontabël do të mbahen në dollarë amerikanë dhe në lekë, në përputhje me Nenin 13.2 të Kontratës. Çdo humbje apo fitim që rezulton nga këmbimi i monedhës së kërkuar për Operacionet Hidrokarbure të KONTRAKTORIT ose nga konvertimet përkatëse nga një monedhë në tjetrën do t'i ngarkohet apo kreditohet Kostove të Mbulueshme.

1.4 Me qëllim përcaktimin e koeficientit "R", KONTRAKTORI do të mbajë një sistem llogarish për regjistrimin, në dollarë amerikanë, të të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me Operacionet Hidrokarbure të përcaktuara në Nenin 7.6. Ky sistem duhet të përbëhet nga dy llogari kryesore: Llogari të ardhurash të koeficientit "R" dhe llogari shpenzimesh të koeficientit "R".

2. Situacioni i veprimtarive

2.1 KONTRAKTORI do t'i dorëzojë AKBN-së, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Kërkimit sipas Nenit 4.8 të Kontratës. Ky Situacion do të pasqyrojë të gjitha detyrimet dhe kreditimet që lidhen me Shpenzimet e Kërkimit për atë Tremujor Kalendarik, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre, dhe do të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që nga fillimi.

2.2 KONTRAKTORI do të dorëzojë në AKBN, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit sipas Nenit 6.23 të Kontratës, ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik ("**Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative**"), që të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre.



3. Auditimet dhe rregullimet

3.1 Çdo zë i kostove në një Situacion të Veprimtarisë së Kërkimit dhe Vlerësimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas dymbëdhjetë (12) Muajsh nga data që AKBN merr Situacionin, përveç rastit kur AKBN e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë, në përputhje me Nenin 4.8 të Kontratës. Në këtë rast, AKBN dhe KONTRAKTORI do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen që të arrijë një zgjidhje, kohë gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Kundërshtuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga ky auditim.

3.2 Çdo zë i kostove në një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas tridhjetë e gjashtë (36) muajsh nga data që AKBN merr Situacionin, nëse AKBN nuk e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda Periudhës në fjalë tridhjetë e gjashtë (36) mujore, me përjashtim të dyzetë e tetë (48) muajve të parë të Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit, ku çdo zë i kostove në Situacionin e Veprimtarisë së Zhvillimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas dymbëdhjetë (12) muajve nga data e marrjes së atij Situacioni nga AKBN, nëse kjo e fundit nuk e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda po kësaj periudhe dymbëdhjetë (12) mujore. Në rast se AKBN-ja bën kundërshtime të tilla me shkrim, AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje, periudhë gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Kundërshtuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga auditimi në fjalë.

3.3 AKBN-ja do t'i kryejë auditimet në një mënyrë të tillë që të sjellë sa më pak shqetësime për KONTRAKTORIN dhe Operacionet Hidrokarbure të KONTRAKTORIT. KONTRAKTORI do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të bashkëpunuar me AKBN-në dhe, sipas rastit, do të ofrojë të gjithë mbështetjen dhe lehtësirat e arsyeshme.

3.4 Të gjitha rregullimet që rezultojnë nga një auditim i rënë dakord ndërmjet KONTRAKTORIT dhe AKBN-së do të korrigjohen menjëherë nga KONTRAKTORI në Situacionin pasardhës dhe do t'i raportohen AKBN-së. Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me një auditim, ajo do të diskutohet ndërmjet Drejtorisë Ekonomike të AKBN-së dhe KONTRAKTORIT dhe, nëse nuk zgjidhet, zëri apo zërat objekt i mosmarrëveshjes do të zgjidhen me arbitrazh, siç parashikohet në Nenin 21 të Kontratës.

4. Interesi për pagesën me vonesë

Nëse një Palë nuk arrin të kryejë ndonjë pagesë, që rrjedh nga dispozitat e kësaj Kontrate, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e asaj pagese, atëherë kjo Palë, përveç pagesës së prapambetur, do të paguajë edhe interes me normë vjetore dy presje pesë për qind (2,5%) më të lartë se LIBOR-i për depozitat (3) tre mujore të dollarit amerikan, kuotuar nga Zyra e Citibank në Londër (ose ndonjë bankë tjetër që mund të miratohet nga Palët) rreth orës 11:00 paradite me orën e Londrës për Ditën apo Ditët për të cilat do të zbatohet norma e interesit.

NENI II. KOSTOT DHE SHPENZIMET

Sipas dispozitave të Kontratës, KONTRAKTORI do të mbulojë i vetëm dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes Filialeve të Kompanisë, do të paguajë kostot dhe shpenzimet e



mëposhtme, të cilat do të trajtohen dhe mbulohen nga KONTRAKTORI në përputhje me Nenin 7 të Kontratës, me kusht që ato të mos jenë kryer përpara Datës së Hyrjes në Fuqi.

Kostot dhe shpenzimet e mëposhtme do të jenë të Mbulueshme:

1. Pagesat për Qeverinë

Të gjitha tarifat shtetërore, tarifat e qirasë, vlerësimeve, rinovimeve dhe zgjatjes dhe çdo pagesë tjetër e çfarëdo lloji dhe natyre e paguar nga KONTRAKTORI sipas kushteve të Kontratës, përveç bonuseve të paguara sipas Nenit 27 të Kontratës.

2 Kostot për personelin dhe kostot e lidhura me të

2.1. Punonjësit vendas të KONTRAKTORIT me bazë në Shqipëri:

Kostot e të gjithë punonjësve vendas të përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë. Këto kosto do të përfshijnë të gjitha kostot e pagave dhe përfitimeve shtetërore për punonjësit, si dhe tatimet që i ngarkohen KONTRAKTORIT si punonjës dhe kostot e transportit dhe të transferimit të punonjësve brenda për brenda Shqipërisë. Nëse këta punonjës përfshihen edhe në veprimtari të ndryshme nga Operacionet Hidrokarbure, Kostoja e tyre do të shpërndahe në bazë të pasqyrave të orëve të punës, në përputhje me parimet kontabël të njohura e të pranuar.

2.1 Personeli i emëruar:

Kostot e pagave dhe bonuseve të punonjësve të KONTRAKTORIT të përfshirë drejtpërdrejt dhe në mënyrë të domosdoshme në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, qofshin të emëruar përkohësisht apo përgjithmonë, pavarësisht vendndodhjes së tyre, duke nënkuptuar se, në rast se vetëm një pjesë e kohës së personelit në fjalë i kushtohet plotësisht Operacioneve Hidrokarbure sipas Kontratës, do të paguhet vetëm pjesa përpjesëtimore e pagave dhe kostove të zbatueshme të përshkruara në paragrafin 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 më poshtë dhe do të specifikohet baza e kësaj shpërndarjeje përpjesëtimore.

2.3 Shpenzimet e KONTRAKTORIT për lejet vjetore, përfitimet në rast sëmundje dhe përfitimet e invaliditetit. Kostoja e jetesës dhe strehimit do të konsiderohet si Kosto e Mbulueshme vetëm për personelin e huaj.

2.4 Shpenzimet ose kontributet e bëra sipas vlerësimeve apo detyrimeve të parashikuara në ligjet e Republikës së Shqipërisë, që zbatohen për kostot e KONTRAKTORIT në lidhje me pagat, siç parashikohet në paragrafin 2.3.

2.5 Kostot e KONTRAKTORIT për planet e sigurimit të jetës në grup të punonjësve, shtrimin në spital dhe bonusin e zbatueshëm mbi pagat, që u ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure sipas paragrafit 2.3.

2.6 Shpenzimet e arsyeshme të punonjësve të KONTRAKTORIT në lidhje me transportin dhe udhëtimin vajtje-ardhje në Operacionet Hidrokarbure, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe zhvendosjes së punonjësve të huaj, përfshirë të familjarëve dhe sendeve personale të tyre, të emëruar në Shqipëri, pagat e të cilëve do t'u ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure sipas paragrafit 2.2.



Shpenzimet reale të transportit të personelit të huaj të transferuar në Operacionet Hidrokarbure nga dhe drejt vendit të tyre të origjinës do t'i ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure. Shpenzimet e transportit të personelit të transferuar nga Operacionet Hidrokarbure në një vend të ndryshëm nga vendi i tyre i origjinës nuk do t'i ngarkohet Operacioneve Hidrokarbure.

Kostoja e transportit sipas këtij Neni nënkupton koston e transportit të mallrave dhe pasagjerëve, ushqimit, hotelit dhe sigurimit, të miratuara sipas politikave standarde të KONTRAKTORIT për personelin. KONTRAKTORI do të garantojë që të gjitha shpenzimet e lidhura me koston e transportit të alokohen në mënyrë të barabartë për veprimtaritë që kanë përfituar nga personeli në fjalë.

2.7 Shpenzimet e arsyeshme personale të personelit, pagat e të cilëve u ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure sipas paragrafit 2.2 dhe për të cilat shpenzimet e personelit rimbursohen sipas politikave standarde të KONTRAKTORIT për personelin. Në rast se këto shpenzime nuk i atribuohen plotësisht Operacioneve Hidrokarbure, këtyre operacioneve do t'u ngarkohet vetëm pjesa e zbatueshme e tyre, e cila do të përcaktohet mbi baza të barabarta.

3. Materialet

Materialet, pajisjet dhe furnizimet e blera apo të furnizuara nga KONTRAKTORI për përdorim në Operacionet Hidrokarbure, në përputhje me Kontratën, Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe, sipas rastit, politikën, standardin dhe praktikën e prokurimit dhe kontraktimit të operatorit.

3.1 Blerja

Materialet dhe pajisjet e blera do të faturohen me çmimin e paguar nga KONTRAKTORI pasi janë zbritur të gjitha skontot e përfituara realisht nga KONTRAKTORI apo Filialet Kompanisë së tij. Çmimi përfshin, por pa u kufizuar në, tarifën e inspektimit dhe shpërndarjes, tarifën e ndërmjetësve të eksportit, tarifën e transportit, pagesat e sigurimeve, tarifën e ngarkim-shkarkimit, detyrimet e importit dhe tarifën e licencave, si dhe të gjithë zërat e tjerë që zakonisht shoqërohen me prokurimin e materialeve dhe pajisjeve dhe tatimet e zbatueshme.

3.2 Materialet e furnizuara nga KONTRAKTORI

Materialet e nevojshme për Operacionet Hidrokarbure do të blihen drejtpërdrejt, sa herë që kjo të jetë e mundur, përveç rastit kur KONTRAKTORI mund t'i importojë ato nga stoku jashtë Shqipërisë i KONTRAKTORIT apo i Filialeve të Kompanisë së KONTRAKTORIT, sipas kushteve të mëposhtme:

3.2.1 Materialet e reja (kategoria "A")

Materialet e reja të transferuara nga magazinat apo pronat e tjera të Filialeve të Kompanisë së KONTRAKTORIT do të vlerësohen në kosto, minus çdo skonto, me kusht që kostoja e furnizimeve të materialeve të mos jetë më e lartë se çmimet ndërkombëtare për materiale me cilësi të ngjashme, të furnizuara me kushte të ngjashme që janë mbizotëruese në kohën që janë porositur këto materiale.



3.2.2 Materialet e përdorura (Kategoritë "B" dhe "C") që do të përdoren me miratimin e AKBN-së.

3.2.2.1 Materialet që janë në gjendje të mirë dhe funksionale për t'u ripërdorur pa u riparuar do të klasifikohen si materiale të kategorisë "B" dhe do të çmohen me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të çmimit të materialit të ri. Kjo kategori përfshin, por nuk kufizohet në, materialet që i janë nënshtruar një procesi riparimi dhe janë restauruar në gjendje të plotë Pune.

3.2.2.2 Materialet që nuk mund të klasifikohen si materiale të kategorisë "B", por që janë në gjendje Pune për funksionin e tyre fillestar, por jo mjaft të përshtatshme për riparim, do të klasifikohen si materiale të kategorisë "C" dhe çmohen me pesëdhjetë për qind (50%) të çmimit të materialeve të reja.

3.2.2.3 Materialet që nuk mund të klasifikohen si materiale të kategorisë "B" ose "C" do të çmohen me një vlerë proporcionale me përdorimin e tyre.

3.3 Çmimet premium

Kurdoherë që materiali nuk mund të sigurohet në pikat e zakonshme të furnizimit dhe me çmimet e specifikuar në Nenet 3.1 dhe 3.2 të këtij paragrafi 3, për shkak të emergjencave kombëtare, grevave apo për shkaqe të tjera të pazakonta, KONTRAKTORI mund ta faturojë materialin e kërkuar në bazë të kostove e shpenzimeve direkte të kryera nga KONTRAKTORI për prokurimin e këtij materiali, për ta bërë atë të përshtatshëm për përdorim dhe për dërgimin e tij në vendndodhje.

3.4 Garancia e materialeve të blera apo të furnizuara nga KONTRAKTORI

KONTRAKTORI nuk jep garanci për materialin. Garancia e vetme për materialin e blerë apo të furnizuar nga KONTRAKTORI është garancia e shitësit apo prodhuesit; në rast materialit difektoz, kreditimi/vlera do të transferohet siç merret nga ose në përputhje me garancinë e furnizuesit apo prodhuesit, kur rregullimi për KONTRAKTORIN është bërë nga furnizuesi apo prodhuesi.

4. Transporti

Kostot e transportit të punonjësve, pajisjeve, materialeve dhe furnizimeve të ndryshme nga ato të parashikuara në Nenin 2 të kësaj Procedure Kontabël, që janë të nevojshme për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas Kontratës, si dhe kostot e tjera në lidhje me to, duke përfshirë detyrimet, tarifatat doganore, tarifatat e shkarkimit, tarifatat e dokut dhe shpenzimet e transportit tokësor dhe detar.

5. Shërbimet dhe mallrat nga Palë të treta

Kostoja e konsulentëve, shërbimeve të kontraktuara dhe mallrave që KONTRAKTORI i prokuron nga palët e treta për t'i përdorur në Operacionet Hidrokarbure, në përputhje me



Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe, sipas rastit, me rregulloret, standardet dhe praktikat e prokurimit dhe kontraktimit të operatorit.

Kostoja e audituesve të emëruar nga AKBN-ja për dyzet e tetë (48) muajt e parë nga fillimi i Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit, me qëllim miratimin e mbulimit të kostove të KONTRAKTORIT në përputhje me Nenin I, paragrafi 3.2.

6. Shpenzimet administrative dhe kostot e Filialeve

6.1 Shërbimet teknike dhe profesionale

Shërbimet e ofruara nga KONTRAKTORI apo Filialet e tij do të kryhen sipas një Urdhri Pune apo Kontrate shërbimi të lëshuar nga Operatori. Këto shërbime do të kërkohen nga Operatori dhe do t'i ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure në bazë të tarifave për orë, në bazë të çdo tarife tjetër të bazuar në metodën e alokimit sipas parimit "arm's length", në përputhje me Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe me udhëzimet për transferimin e çmimit për ndërmarrjet shumëkombëshe, të nxjerra nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe të garantuara në mënyrë të pavarur nga një firmë e njohur kontabiliteti. KONTRAKTORI t'i japë AKBN-së një deklaratë auditimi të tillë të pavarur mbi baza vjetore.

Shërbimet e Filialeve përfshijnë:

- Shërbimet në lidhje me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen dhe mjedisin (HSSE)
- Studimet dhe interpretimi gjeologjik
- Përpunimi i të dhënave sizmike dhe përpunimi i të dhënave të tjera
- Analiza, korrelacioni dhe interpretimi i testeve dhe diagrameve të pusit
- Shërbimet laboratorike
- Inxhinierinë ekologjike dhe mjedisore
- Çmontimin (braktisjen) dhe riparimin
- Gjeologjinë e sheshit të pusit
- Inxhinierinë dhe menaxhimin e projekteve
- Analizën e shkëmbinjve mëmë
- Analizën petrofizike
- Analizën e fluideve (teknologjitë e vlerësimit të fluideve dhe të marrjes së kampioneve)
- Shërbimet e rievimit dhe të hartëzimit të të dhënave gjeografike
- Analizën gjeokimike
- Menaxhimin e të dhënave
- Mbikëqyrjen e Shpimit
- Vlerësimin e Zhvillimit
- Shërbime kontabiliteti për projektin dhe shërbime profesionale
- Shërbime në lidhje me burimet njerëzore, financat, kontraktimin dhe prokurimin, taksat shërbime ligjore.

6.2 Shpenzimet administrative

KONTRAKTORI do të faturojë mbi baza vjetore dy presje pesë për qind (2,5%) të detyrimeve dhe kreditimeve kumulative, të raportuara në Situacionet e Veprimtarive, siç përmendet në Nenin I, paragrafi 3.



7. Dëmet dhe humbjet

Të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme për rikuperimin apo korigjimin e dëmeve ose humbjeve të shkaktuara nga zjarri, përmytjet, vjedhja, aksidentet apo çdo shkak tjetër që është jashtë kontrollit të KONTRAKTORIT. Për dëmet apo humbjet në vlerë mbi (njëqind mijë) 100 000,00 USD, KONTRAKTORI do t'i dorëzojë AKBN-së një njoftim me shkrim për dëmet ose humbjet e ndodhura sa më shpejt që të mundet pas marrjes së raportit për to nga KONTRAKTORI.

8. Shpenzimet ligjore

Të gjitha kostot apo shpenzimet e shqyrtimit, hetimit, konfirmimit, mbrojtjes dhe zgjidhjes së çdo pretendimi apo veprimi ligjor të nevojshëm për marrjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e zonës së Kontratës dhe për mbrojtjen apo ndjekjen penale të padive që përfshijnë zonën e Kontratës apo të çdo pretendimi që lind nga Operacionet Hidrokarbure ose shumatat e paguara për shërbimet ligjore të nevojshme për mbrojtjen e interesave të përbashkëta të AKBN-së dhe KONTRAKTORIT (përveç kostove dhe shpenzimeve për pretendimet, veprimet ligjore, kërkesë paditë apo mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve). Kostot e shërbimeve ligjore të kryera nga punonjësit nuk duhet të dublikojnë koston e shërbimeve sipas paragrafit 6.1.

9. Tatimet

Të gjitha taksat, detyrimet apo pagesat e çdo lloji e natyre të vlerësuara apo vjela mbi ose në lidhje me operacionet në kuadrin e kësaj Kontrate, përveç atyre të mbuluara nga Neni 9 i Kontratës.

10. Sigurimet dhe pretendimet

10.1 Primet e paguara për çdo detyrim publik, dëmtim prone dhe sigurime të tjera të bëra nga KONTRAKTORI, së bashku me të gjitha shpenzimet e lindura dhe të paguara për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmeve, gjykimeve dhe shpenzimeve të tjera, duke përfshirë shpenzimet për shërbimet ligjore, që nuk mbulohen nga kompania e sigurimit.

10.2 Nëse zëri apo ngjarja nuk mbulohet nga sigurimi, shpenzimet reale të lindura dhe të paguara nga KONTRAKTORI për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmeve, gjykimeve, si dhe të gjitha shpenzimeve të tjera, duke përfshirë shpenzimet për shërbimet ligjore.

10.3 Të gjitha zgjidhjet që lindin nga pretendimet e KONTRAKTORIT kundrejt siguruesve, për siguracionin e bërë në përfitim të Operacioneve Hidrokarbure, do t'u kreditohen Kostove të Mbulueshme në muajin në të cilin janë marrë.

11. Administrata lokale/zyrat në terren

Pagat dhe shpenzimet e drejtuesve dhe punonjësve të tjerë të KONTRAKTORIT, të vendosur në Shqipëri, të cilët shërbejnë në Operacionet Hidrokarbure, koha e të cilëve nuk i ngarkohet direkt Operacioneve Hidrokarbure dhe kostoja e mirëmbajtjes dhe përdorimit të zyrave të Kërkimit dhe/ose Prodhimit dhe nën-zyrave të nevojshme (duke përfshirë objektet e strehimit për punonjësit, nëse kërkohet) të përdorura gjatë kryerjes së këtyre Operacioneve



Hidrokarbure. Këto pagesa do të jenë në proporcion të barabartë për gjitha zonat e Kontratës, nëse është e zbatueshme.

12. Pagesat e trajtimit në magazinë

Në rast se për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure nevojiten objekte magazinimi, të gjitha kostot që nevojiten për të ngritur dhe mirëmbajtur magazinën dhe të gjitha kostot e kryera për trajtimin e materialeve në magazinë.

13. Shpenzime të tjera

Të gjitha shpenzimet e tjera që nuk mbulohen apo parashikohen në dispozitat e mësipërme, të cilat janë kryer nga Operatori për realizimin e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me Kontratën dhe Praktikën e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe të kryera nga KONTRAKTORI sipas Programit të Punës dhe Buxhetit, të tilla si shpenzimet e braktisjes dhe shpenzimet për zgjidhjen e situatave emergjente.

14. Kreditimet

Përveç kreditimeve të tjera të bëra llogarive në përputhje me Kontratën dhe këtë Procedurë Kontabël, të ardhurat neto, kur merren, që lindin nga sa më poshtë, do t'u kreditohen Kostove të Mbulueshme në atë masë që kostot i debitoreshin fillimisht Kostove të Mbulueshme:

14.1 Të ardhurat e marra nga palët e treta për përdorimin e pronës së KONTRAKTORIT të përdorur ekskluzivisht në Operacionet Hidrokarbure; dhe

14.2 Qiratë, rimbursimet dhe kreditimet e tjera të marra nga KONTRAKTORI, të zbatueshme ndaj çdo pagese që i është faturuar Kostove të Mbulueshme;

14.3 Çdo pagesë e marrë nga KONTRAKTORI për furnizuesit/prodhuesit apo agjentët e tyre në lidhje me pajisjet apo materialet me defekt, kostoja e të cilave ka qenë faturuar më parë nga KONTRAKTORI sipas Kontratës;

14.4 Kostot e mbuluara në kohën e eksportit sipas Nenit 12.4 të kësaj Kontrate.

14.5 Të ardhurat nga të gjitha shitjet e tepicës së materialeve që i janë ngarkuar shumë sipas Kontratës, në përputhje me Nenin 12.7.

14.6 Të ardhurat nga siguracionet

15. Nuk duhet të ketë dublikim të detyrimeve dhe kreditimeve

Pavarësisht çdo dispozite që bien ndesh me këtë Procedurë Kontabël, synohet që të shmangët dublikimi i detyrimeve apo kreditimeve në llogaritë sipas kësaj Kontrate.

NENI III. MBULIMI I KOSTOVE

1. Pasqyra e mbulimit të kostove



KONTRAKTORI do t'i japë AKBN-së, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë pas çdo Tremujori Kalendarik, një Pasqyrë të Mbulimit të Kostove për atë Tremujor. Për qëllimet e kësaj Procedure Kontabël dhe të Kontratës, Pasqyra e Mbulimit të Kostove nënkupton një dokument të dorëzuar AKBN-së nga KONTRAKTORI, në të cilin përshkruhen zërat sipas kontabilitetit mbi bazë monetare, për çdo Tremujor Kalendarik dhe i cili përfshin totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet e kreditimet kumulative që prej fillimit.

Në pritje të përfundimit të çdo auditimi dhe çdo zgjidhjeje apo arbitrazhi në përputhje me Kontratën, KONTRAKTORI do të përgatisë drejtpërdrejt nga çdo Situacion i Veprimtarisë së Kërkimit dhe Veprimtarisë së Zhvillimit, për çdo Tremujor Kalendarik, Pasqyrën e Mbulimit të Kostove për atë Tremujor. Të gjitha rregullimet e nevojshme që rezultojnë pas përfundimit të auditimeve dhe zgjidhjeve (me çfarëdolloj mënyre) të kundërshtimeve në bazë të kontrollit/auditimit do të llogariten siç lindin dhe në përputhje me Kontratën, duke i përfshirë si debit apo kreditim (sipas rastit) në Pasqyrën e radhës të Mbulimit të Kostove që duhet të përgatitet; megjithatë, në këtë Pasqyrë nuk duhet të përfshihet asnjë Kosto e Kundërshtuar.

Në Pasqyrën e Mbulimit të Kostove do të paraqitet sa më poshtë:

1.1 Seksioni 1 - Kostot totale

1.1.1 Kostot totale të mbartura nga Tremujorët Kalendarikë të mëparshëm.

1.1.2 Rishikimet e reja (Kostot e Kundërshtuara dhe Kostot e Miratuara) të Situacioneve të mëparshme të Veprimtarisë së Kërkimit dhe Zhvillimit, që do aplikohen në këtë Situacion.

1.1.3 Shpenzimet e reja të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative për Tremujorin Kalendarik (që i nënshtrohet auditimit) nga Situacionet e Veprimtarisë së Kërkimit dhe Zhvillimit.

1.1.4 Kostot totale, duke përfshirë ato që i nënshtrohen auditimit.

1.2 Seksioni 2 - Vlera e Hidrokarbureve për Mbulimin e Kostos

(duke marrë në konsideratë çdo marrje të mëparshme të hidrokarbureve përkundrejt të drejtës)

1.2.1 Vlera e Naftës Bruto për Mbulim Kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga KONTRAKTORI për Tremujorin Kalendarik, duke përfshirë totalin për vitin, si dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit.

1.2.2 Vlera e Gazit për Mbulim Kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga KONTRAKTORI për Tremujorin Kalendarik, duke përfshirë totalin për vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit.

1.2.3 Vlera totale e Hidrokarbureve për mbulimin e kostos (1.2.1 plus 1.2.2).

1.3 Seksioni 3 - Mbulimi i kostove

1.3.1 Kostot sipas seksionit 1 që mbulohen nga vlera e Hidrokarbureve për mbulimin e kostos.



1.3.2 Mbartja e Kostove të Pambuluara, nëse ka.

1.4 Seksioni 4 - Hidrokarbure Fitim

1.4.1 Vlera e Naftës Bruto Fitim, nëse ka.

1.4.2 Vlera e Gazit Fitim, nëse ka.

1.5 Seksioni 5 - Llogaria e Kostove të Pezulluara

1.5.1 Totali i Kostove të Pezulluara, të mbartura nga Tremujorët e mëparshëm Kalendarikë.

1.5.2 Kostot Neto të Pezulluara, të zgjidhura rishtazi ose të identifikuara rishtas nga auditimi, gjatë Tremujorit Kalendarik.

1.5.3 Totali i Kostove të Pezulluara, të mbartura në Tremujorin tjetër Kalendarik (1.5.1 plus 1.5.2).

1.6 Seksioni 6 -Kostot e Konstatuara/Përlllogaritura

Një seksion që mbulon Situacionin e Kostove dhe të Ardhurave të Përlllogaritura për Tremujorin Kalendarik përkatës dhe që duhet t'i mundësojë AKBN-së një vështrim të përgjithshëm të kostove për të cilat KONTRAKTORI është angazhuar, por të cilat nuk janë paguar ende ndaj furnitorëve përkatës. Për shmangien e çdo dyshimi, kostot e përfshira në Situacionin e Kostove dhe të Ardhurave të Përlllogaritura mund të përfshihen në Situacionin e Mbulimit të Kostove për qëllime të mbulimit të këtyre kostove në çdo kohë përgjatë kohëzgjatjes së Kontratës, pavarësisht se kur angazhimet, blerja/prokurimi apo shërbimet që i atribuohen këtyre kostove janë ndërmarrë, pranuar apo kryer, për sa kohë zërat e prezantuar nga KONTRAKTORI për mbulimin e kostove në Situacionin e Mbulimit të Kostove janë kryer dhe kanë ndodhur sipas Nenit 4.8 të Kontratës.”

2. Pagesat

Nëse një pasqyrë e mbulimit të Kostove paraqet një shumë që i duhet paguar AKBN-së, kjo shumë duhet të paguhet në dollarë brenda tridhjetë (30) Ditësh nga paraqitja e Pasqyrës në fjalë.

3. E drejta e auditimit

Në përputhje me paragrafin 3 të Nenit I të kësaj Procedure Kontabël, AKBN ka një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh ose tridhjetë e gjashtë (36) muajsh, sipas rastit, nga marrja e çdo Pasqyre të Mbulimit të Kostove që përmban kostot e Veprimtarive të Kërkimit dhe Veprimtarive të Zhvillimit, për të audituar apo kundërshtuar këtë Pasqyrë. AKBN-ja dhe KONTRAKTORI bien dakord për çdo rregullim të duhur që rezulton nga auditimi në fjalë. Gjatë kësaj Periudhe, dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të vihen në dispozicion të AKBN-së.

4. Llogaria e Kontrollit të Mbulimit të Kostove

KONTRAKTORI do të mbajë një Llogari për Kontrollin e Mbulimit të Kostove dhe një kundër-llogari shlyerjeje për të kontrolluar në të shumtën e kostove që mbeten për t'u mbuluar, nëse ka, shumën e kostove të mbuluara dhe vlerën e Hidrokarbureve Fitim, nëse ka. Këto llogari do të përgatiten mbi bazën e (dhe të jenë në konsistencë me) Situacioneve të Mbulimit të Kostove të Tremujorëve Kalendarikë.

**Aneksi D****Procedura për përcaktimin e BOE të Gazit dhe për vendosjen e çmimit të Gazit**

1. Përkufizimet në Nenin 1 të Kontratës janë miratuar për t'u përdorur në këtë aneks dhe përfshihen këtu nëpërmjet referimit.
2. Në rast se AKBN dhe KONTRAKTORI lidhin Kontrata për shitjen e Gazit, me qëllim përdorimin e Gazit të prodhuar sipas Kontratës për shitje tek konsumatorët jashtë Shqipërisë, këto Kontrata për shitjen e Gazit duhet të përmbajnë dispozitat e përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare Hidrokarbure. Çmimet që do të marrë AKBN-ja dhe KONTRAKTORI për gazin në fjalë do të specifikohen në kontratat e shitjes së gazit.
3. Në rast se AKBN dhe KONTRAKTORI lidhin një Kontratë për shitjen e Gazit, me qëllim përdorimin në Shqipëri të sasisë së Gazit të KONTRAKTORIT të prodhuar sipas kontratës së shitjes, kjo kontratë shitjeje duhet të përmbajë dispozita të përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare Hidrokarbure, duke përfshirë një angazhim për blerje afatgjatë nga AKBN-ja dhe lëvrimit nga KONTRAKTORI të minimumit të vëllimit ditor të rënë dakord në përputhje me kufizimet teknike.

Palët do të negociojnë dhe do të përpiqen të lidhin një kontratë për shitjen e Gazit, që të mbulojë Gazin (siç përkufizohet këtu) për shitje në tregun e brendshëm Shqiptar. Palët do të bien dakord mbi përqindjen e Gazit që është e disponueshme për shitje të menjëhershme në tregun e brendshëm shqiptar, me kusht gjithsesi që i gjithë Gazi që do të shitet në tregun e brendshëm shqiptar sipas një kontrate të tillë për shitjen e Gazit, të shitet sipas kushteve jo më pak të favorshme se ato që janë të disponueshme për KONTRAKTORIN në tregun ndërkombëtar, duke përfshirë kushtet e mëposhtme:

- (a) një kusht që kërkon datën fillestare të lëvrimit për Gazin që do të shitet në tregun e brendshëm shqiptar, e cila do të jetë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas datës fillestare të lëvrimit të parashikuar për lëvrimin e Gazit në tregun ndërkombëtar;
- (b) një dispozitë që përcakton çmimin, i cili nuk është më i vogël se çmimi që mund të merret KONTRAKTORI në tregun ndërkombëtar (të llogaritur mbi baza të barasvlershme BTU); dhe
- (c) një kusht që i kërkon blerësit/ve të Gazit të jenë përgjegjës për të gjitha kostot, shpenzimet dhe detyrimet që lidhen me projektimin, ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e një tubacioni të gazit natyror dhe të objekteve në lidhje me të që janë të nevojshme për të vendosur Gazin në dispozicion për lëvrim në tregun e brendshëm shqiptar.

Megjithatë, lidhja e një kontrate për shitjen e gazit, me qëllim shitjen apo përdorimin e Gazit në tregun e brendshëm shqiptar, në asnjë rast nuk duhet të rrezikojë apo të pengojë aftësinë e KONTRAKTORIT për të lidhur një kontratë për shitjen e Gazit për ndonjë pjesë të Gazit të KONTRAKTORIT në tregun ndërkombëtar. Në rast se kontratat e propozuara apo të ofruara për shitjen e gazit në tregun e brendshëm shqiptar nuk përmbushin apo plotësojnë të gjitha kushtet e



mësipërme, KONTRAKTORI gëzon të drejtën të lidhë një Kontratë për shitjen e të gjithë sasisë së Gazit të zotëruar prej tij në tregun ndërkombëtar.

KONTRAKTORI ruan të drejtën e aksesit në të gjitha tregjet e disponueshme (në tregjet e brendshme dhe në ato ndërkombëtare) për të garantuar sigurimin e vlerës maksimale për KONTRAKTORIN dhe për shtetin Shqiptar.

- 3.1 Çmimi fillestar i gazit që AKBN-ja do t'i paguajë KONTRAKTORIT do të jetë mesatarja e çmimeve të paguara për Gazin e lëvruar në Itali gjatë gjashtë (6) muajve kalendarikë përpara datës së Prodhimit Fillestar Komercial të Gazit, siç citohet në tabelën me titull "European Border Prices" në botimin e mirënjohur dhe të cituar ndërkombëtarisht "WORLD GAS INTELLIGENCE", botuar nga Petroleum & Energy Intelligence Weekly, Inc. në lidhje me vlerën kalorifike bruto.
 - 3.2 Çmimi fillestar i Gazit do të jetë efektiv për Muajin e parë Kalendarik të prodhimit pas Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar dhe për një pjesë të muajit që paraprin këtë Muaj të parë Kalendarik, nëse Data e Prodhimit Fillestar Tregtar nuk përkon me ditën e parë të një Muaji Kalendarik.
 - 3.3 Çmimi që AKBN-ja apo blerësi i caktuar prej saj do t'i paguajë KONTRAKTORIT për pjesën e tij të këtij Gazi për çdo muaji lëvrimi pas Muajit të parë Kalendarik të prodhimit pas Datës së Prodhimit Fillestar Tregtar do të jetë mesatarja e çmimeve të paguara për Gazin e lëvruar në Itali gjatë gjashtë (6) Muajve Kalendarikë përpara Muajit të lëvrimin, siç përmendet në tabelën me titull "European Border Prices" në botimin e mirënjohur dhe të cituar ndërkombëtarisht "WORLD GAS INTELLIGENCE", botuar nga Petroleum & Energy Intelligence Weekly, Inc. në lidhje me vlerën kalorifike bruto.
 - 3.4 Çmimi që AKBN-ja apo blerësi i caktuar prej saj do t'i paguajë KONTRAKTORIT për pjesën e tij të këtij Gazi do të paguhet në Dollarë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i një Muaji Kalendarik, për Gazin e lëvruar nga KONTRAKTORI në Muajin Kalendarik pararendës.
4. Zbulimi Tregtar i Gazit nga KONTRAKTORI, siç parashikohet në Kontratë dhe lidhja e një Kontrate për shitjen e Gazit me AKBN-në mund të çojë, nëse nevojitet për shkak të kushteve të tregut, në hapjen e diskutimeve mbi zbatimin e një projekti të gazit të lëngët (LPG). Çdo diskutim i tillë dhe çdo plan që do të rezultojë duhet të përmbushë kushtet e Kontratës.



Aneksi E
Forma e Garancisë Bankare

GARANCIA BANKARE

Drejtuar

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE, TIRANË

Jemi informuar se [●] ("**Principali**") është bërë titullari i vetëm i një Kontratë me Ndarje Prodhimi për Bllokun 4 në tokë në Shqipëri me **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë** së Shqipërisë, e cila ka hyrë në Fuqi më [●] (në vijim referuar si "**PSC**") dhe e kuptojmë se sipas dispozitave të PSC-së kërkohet një garanci performance.

Jemi informuar gjithashtu se, sipas kushteve të PSC, [●] ka marrë përsipër që gjatë Periudhës së Kërkimit [●] të zbatojë Programin e Punës në Zonën e Kontratës (të gjitha sipas përshkrimit në PSC) dhe për këtë qëllim të shpenzojë shumën [●] dollarë amerikanë ([●] USD).

Me kërkesë të [●], ne [●], të përfaqësuar nga [●], me vendndodhje në [●], përmes kësaj garancie garantojmë dhe marrim përsipër t'ju paguajmë çdo shumë që nuk e kalon shumën [●] dollarë amerikanë ([●] USD), sipas rastit, pasi të kemi marrë kërkesën e parë të bërë nga ju në përputhje me procedurën për paraqiten e kërkesës që detajohet më poshtë ("**Garancia**").

Kërkesa duhet të bëhet në formë shkresore dhe duhet të shoqërohet nga:

- Deklarata ku të deklarohet se Principali është në shkelje të detyrimeve të tij sipas Kontratës dhe në ç'drejtimit Principali është në shkelje;
- Kopjen e njoftimit drejtuar [●] (që daton të paktën (30) ditë përpara datës së kërkesës), ku të informohet [●] për shkeljen e detyrimeve që ka sipas Programit të Punës, për natyrën dhe masën e shkeljes, si dhe mbi qëllimin tuaj për të kërkuar pagesën sipas kësaj garancie, në rast se shkelja nuk korrigjohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit të bërë nga ana juaj; dhe
- Një deklaratë të nënshkruar, ku të deklarohet se [●] nuk e ka korrigjuar shkeljen e përcaktuar në njoftim brenda datës së specifikuar.

Çdo kërkesë sipas kësaj Kontrate dhe dokumentet e specifikuara më lart duhet të na i dërgoni në adresën e lartpërmendur, në përputhje me procedurën e sipërpërmendur për bërjen e kërkesës deri në datën e përfundimit të kësaj garancie, siç përshkruhet më poshtë, datë pas së cilës kjo garanci nuk do të ketë më asnjë efekt.

Nuk do të pranohet kërkesa e dërguar me faks.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi jo më vonë se [●] dhe do të mbetet e vlefshme deri në (a) gjashtë (6) muaj pas përfundimit të Periudhës së Kërkimit [●] (b) datën në të cilën shuma totale e kësaj garancie të jetë tërhequr apo reduktuar siç përcaktohet në paragrafin vijues. Shumës së kësaj garancie do t'i zbritet çdo muaj ose çdo tre muaj, siç mund të bihet dakord mes AKBN-së dhe [●], gjatë Periudhës së [●] të Kërkimit, një shumë e barabartë me shumën e shpenzuar nga [●] në lidhje me detyrimet e tij sipas Programit të Punës gjatë muajit apo tremujorit në fjalë, dhe këto zbritje do të kryhen në përputhje me deklaratat mujore ose tremujore me shkrim të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore drejtuar [●], një kopje e të cilave na përcillet neve dhe ne i pranojmë si dëshmi përfundimtare për reduktimet e angazhimit tonë sipas kësaj garancie.

Kjo Garanci është personale dhe nuk mund t'i transferohet apo caktohet një personi tjetër (përveçse me miratimin tonë paraprak me shkrim, i cili nuk do të refuzohet pa arsye).

Kjo garanci i nënshtrohet Rregullave Uniforme të Garancive Bankare, botimi i ICC nr. 458, dhe në masën që nuk bie ndesh me to, do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin [zvicëran], me juridiksion në [Zyrih, Zvicër].